ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor
BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 12 SHKURT 2022. NUMËR 168 VITI V I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

VIZITA E VIKTOR EFTIMIUT NË SHQIPËRI

Prof. Cristian Preda, Bukuresht

Vizatim nga Theodore Pallady

IN MEMORIAM

KADRIJE KADARE DHE DY DASHURITË E SAJ

nga Bujar Hudhri

(fq. 9)

Një letër drejtuar mikut të tij Nikolla Naco, kryetar i shoqërisë "Drita" të Bukureshtit, ku derdh gjithë mllefin e grumbulluar për grabitjen e 400 florinjve të mbledhur për botimin e fjalorit, me pasojë për kryeveprën e tij, por edhe për trashëgiminë e gjuhës kombëtare.

ZEMËRIMI I KRISTOFORIDHIT

me hyrje nga Taulant Ceka (fq. 8)

Në studime kritike, në përcjellje të përkthimeve, në manuale e në histori të ndryshme të letërsive, Kavafis është vlerësuar si poeti *zëpërveçëm* i shekullit.

KAVAFIS, POETI I SFIDAVE ESTETIKE

nga Ymer Çiraku (fq. 15)

SHËNIME PËR LIBRAT

Vepra e Baba Ali Tomorrit

DRITË PËR ATË QË DRITËSOI BEKTASHIZMIN

Nga Bashkim Koçi (fq. 16)

MBI UDHËTIMIN EUROPIAN TË NJË ROMANI BASHKËKOHOR SHQIPTAR "SECILI PËRKTHEHET SIMBAS MËNYRËS SË VET"

Nga Andreas Dushi (fq. 17)

INDIVIDUALITETI I ROMANCIERIT BASHKIM HOXHA

(fq. 6)

Nga Floresha Dado

Në dendësinë e romaneve, botuar në dy dhjetëvjeçarët e fundit, ka krijues që mbeten mënjanë, larg vemendjes së kritikës letrare, ndërkohë që, nëse futesh në korpusin e krijimtarisë së tyre, zbulon se ka diçka të veçantë, origjinale, se ka një sy të mprehtë që sheh dhe guxon të protestojë artistikisht, ka, sidomos, një dhimbje! Mbas një vetëdieje individuale mbarten shqetësime të shoqërisë së sotme. E tillë është krijimtaria romaneske e Bashkim Hoxhës...

Një vështrim mbi letrat e Imzot Pal Skiroit drejtuar Mid'hat Frashërit

Nga Uran Butka

PASOJAT E LUFTËS e Rubens, artistit diplomat dhe agjent

Nga Dr. Bledar Kurti (fq. 22)

BIBLIOTEKË

Poezi nga poetesha të mëdha (fq. 10)
Ka një pjerrësi të çuditshme drita
Virion Graçi (fq. 12)
Pas perdes
Ramadan M. Pasmaçiu (fq. 13)
Kush rron duke shpresuar...
Enver Kushi (fq. 19)
Vallet e ngrira

DASHURIA DHE FILOZOFIA

nga Feride Papleka (fq. 18)

Në ditët tona njeriu është i etur për dashuri, edhe pse bie shpesh në krahët e dyshimit dhe pasigurisë. Filozofët thonë se adhurimi për dashurinë nuk ka qenë kurrë më parë një « kredo kaq e fortë ». Me gjithë se jetojmë në epokën e mosbesimit dhe të ndarjeve në masë, magjia e dashurisë është e pavdekshme.

Paolo Fabbri

(fq. 20)

Zadig dhe Ujku ose semiotizimi i gjurmëve

VIZITA E VIKTOR EFTIMIUT NË SHQIPËRI

Prof. Cristian Preda, Bukuresht

Një vit përpara se të vdiste, kur udhëtoi drejt vendlindjes së tij, Eftimiu e kuptoi se çfarë interes të madh politik zgjonte ai në Shqipëri. Të dhënat më të shumta për vizitën e tij ndodhen në arkivin e Ministrisë së Jashtme. Autoritetet rumune e marrin vesh jo në Bukuresht, por nga Tirana informacionin se shkrimtari ishte ftuar në Shqipëri, dërguar më 19 Prill 1971 bashkëpunëtorit të parë të ambasadorit Manole Bodnarash nga sekretari i Komitetit Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore dhe Miqësore me Jashtë. Shërbimi ynë diplomatik në Tiranë hezitonte, duke njoftuar se ekzistojnë "aspekte delikate që duhet të mbahen parasysh", ndërsa M.Bondarash theksonte se vizita do përdorej si një përpjekje politike e Enver Hoxhës sepse "regjimi ka nevojë për një akt moral, veçanërisht lidhur me problemin e minoriteteve"... Ai shtonte se e dinte "nga burime të denja për t'u besuar"se regjimi i Tiranës, lidhur me këtë temë, shfrytëzonte për propagandë qytetarë me origjinë shqiptare nga vende të tjera, si Jugosllavia, Italia dhe Turqia, dhe se Hoxha donte ta shfrytëzonte edhe Eftimiun për të zbukuruar situatën e minoriteteve... Ai rekomandonte që nëse aprovohej, vizita të ketë një karakter "thjesht privat, pa deklarata".

Udhëheqja e lartë e Ministrisë së Punëve të Jashtme aprovoi vizitën e Eftimiut. Diplomatët rumunë mendonin se përgatitjet kishin përparuar aq sa nuk mund të ktheheshin pas. Ata shtonin se ftesa e ardhur nga Tirana ishte zyrtare dhe rikujtonin se personalitete si akademiku rumun çelnin rrugën e ftesave të ngjashme,"që vinin nga vende të tjera, duke përfshirë edhe ato kapitaliste". Në fund, punonjësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme vlerësonin se vëmendja e treguar për Eftimiun, në fund të fundit, "do jetë një homazh për vendin tonë". Një nga argumentet e përfshijnë dhe vëllain e ambasadorit në Tiranë, më të njohur se ai, Emil Bodnarash. Këtij anëtari të rëndësishëm të Komitetit Ekzekutiv dhe të Presidiumit të Përhershëm të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Rumune, rreth ftesës për Eftimiun i foli ambasadori i Shqipërisë në Bukuresht. Biseda u zhvillua në Nëntor të vitit 1970, në pritjen e ofruar nga shqiptarët me rastin e ditës së tyre kombëtare, ndërsa, sipas njoftimit që i bënte drejtoria e parë e Ministrisë vëllait të tij Manole Bodnarash, Emil Bodnarash e kishte "vlerësuar pozitivisht idenë".

Vizita në tokën shqiptare ishte menduar si pjesë e projektit për realizimin e një filmi homagjial për shkrimtarin rumun, i cili do të përmbante dhe fragmente të filmuara në fshatin e tij të lindjes, në Shqipëri.

Ky film, në fakt, u realizua para se Eftimiu të shkonte në Shqipëri... Kur aprovoi udhëtimin, ministri Corneliu Manescu kërkoi të mbahen parasysh rezervat e shprehura nga i dërguari rumun në Tiranë, të cilit i kërkohej që ambasada të përfshihej me kujdes, duke ofruar edhe një kokteijl.

Për shkak se shqiptarët planifikonin



që gjatë vizitës ti akordojnë një medalje Eftimiut dhe pikërisht dekoratën e tyre më të lartë, Urdhërin Naim Frashëri, diplomatët dhe aktivistët e të dy kryeqyteteve gjatë muajit Maj shkëmbenin informata dhe në fillim të Qershorit nga Tirana vjen shpjegimi se parashikohej shpërblimi i shkrimtarit për "kontributin e dhënë prej tij në zhvillimin e marrëdhënieve mes popullit shqiptar dhe atij rumun dhe luftës së tij për pavarësinë e Shqipërisë", por edhe për "interesin e treguar për progreset e realizuara në vitet e ndërtimit të socializmit në Shqipëri". Ndërsa nga Bukureshti u dërgua pëlqimi i Këshillit të Shtetit. Ndoshta duke marrë vesh hezitimet e shprehura nga ambasadori Bodnarash, shqiptarët këmbëngulnin mbi karakterin kulturor të dekoratës dhe në përgjithësi të vizitës.

Rastësia e solli që përpara se të udhëtonte për në Shqipëri, Eftimiu u dekorua edhe nga autoritetet e Bukureshtit. Me që në vitin 1971 festohej 50 vjetori i krijimit të Partisë Komuniste Rumune, dramaturgu merr titullin *Hero i punës socialiste* dhe medaljen *Drapër dhe çekan*, së bashku me 140 shtetas të tjerë rumunë, prej të cilëve 75 ishin aktivistë partie të rangut të lartë, qoftë në funksion si Manea Manescu apo Elena Çaushesku, qoftë të tërhequr në pension si Constanta Craciun ose Tatiana Bulan.12 persona hynin në kategorinë "merita të shquara në fushën e shkencës, artit dhe kulturës", këtu përfshihej edhe Eftimiu, përkrah aktorit Calboreanu ose doktoreshës Ana Aslan, 28 ishin punëtorë,11 kryetarë kooperativash bujqësore dhe 14 gjeneralë.

E parashikuar në fillim të zhvillohet në fund të muajit Prill dhe në fillim të Majit, vizita në Shqipëri u zhvillua nga 23 Qershori deri në 12 Korrik.Eftimiu shoqërohej nga vëllai i tij Stelian, nga dy miq që kishin lindur edhe ata në Boboshticë, aktori Chiril Economu dhe juristi Stavri Kuneshka dhe nga Ankuca Chendi, për të cilën diplomatët rumunë në Tiranë besonin se ishte "kushërirë dhe sekretare" e shkrimtarit. Udhëtimi nga Bukureshti në Beograd u bë me tren dhe më tej me makinën që u ndal gjatë rrugës në Pogradec. Economu ka treguar për pritjen që u bë në Shqipëri, pasi kaluan kufirin me Jugosllavinë. Eftimiu dhe shoqëruesit e tij u pritën nga

një grup nxënësish dhe nga tre ministra. Në darkë ministri i informacionit dhe propagandës ngriti një gotë "për shkrimtarin më madh shqiptar". Një profesor dhe kyetari i bashkisë e përshëndetën mikun duke përdorur po atë formulë, shënjë se kjo ishte "linja zyrtare" e vendosur nga regjimi i Hoxhës. Sipas të thënave të Economu-t, Eftimiu reagoi duke saktësuar se "nuk konsiderohej një shkrimtar shqiptar, por rumun.Sepse në Rumani, ku arrita që në moshën e fëmijërisë (isha pesë vjeç) u formova nga çdo pikpamje. Atje kam studjuar, atje jam inkurajuar të shkruaj, atje kam njohur suksesin, atje më janë njohur meritat" . Pasi shtoi se nuk e ka harruar atdheun ku lindi dhe se e ka admiruar heroizmin, sidomos në luftën antifashiste, Eftimiu e mbaroi fjalën e tij duke thënë në gjuhën shqipe: "Rroftë Shqipëria, rroftë Enver Hoxha".

Në gati tre javë që kaloi në vendin e tij të origjinës, regjimi i ofroi shkrimtarit rumun, përveç një pushimi në kryeqytet dhe në Durrës, disa takime me përgjegjës të kulturës si zvëndësrektori i Universitetit të Tiranës apo kryetari i Komitetit Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore dhe Miqësore me Jashtë, zgjedhja anëtar nderi i Lidhjes të shkrimtarëve dhe të artistëve, një ceremoni dekorimi të drejtuar nga Haxhi Lleshi, kryetari i Kuvendit Populllor, një udhëtim në Elbasan, për të marrë pjesë në prezantimin e veprës së tij *Njeriu që pa vdekjen me sy*, një tjetër në Korçë, ku vendosi një kurorë në vorrezat e dëshmorëve dhe ku u luajtën skena nga pjesë të tij të ndryshme dhe më në fund, rigjetja e Boboshticës, ku u prit nga bashkëfshatarët.

Informacioni nga telegrami i Ministrisë së Punëve të Jashtme për ato që ndodhën në Boboshticë është plotësuar nga dëshmi me vlerë për vizitën dhe i përket Dionis Bubanit, një shkrimtar shqiptar i lindur në Bukuresht dhe i vendosur më vonë në Tiranë. Ky i shërbeu Eftimiut si përkthyes në udhëtimin e vitit 1971 dhe ka botuar disa artikuj prezantues për të në shtypin shqiptar.Ai tregon se në Boboshticë janë pritur me bukë dhe kripë, por edhe me qershi, mollë dhe raki mani. Një stërmbesë i dhuroi një grusht dhé nga obori i shtëpisë së tij, e cila ishte shkatërruar në kohën e luftës, ndërsa Eftimiu plot emocion, i heshtur meditoi para varrit të gjyshit të tij, pastaj dëgjoi këngë popullore. Gjithë nga Bubani marrim vesh se shkrimtari rumun, në hotelin ku ishte vendosur, pati disa ditë rrjesht takime me shqiptarë që kishin jetuar në Rumani, të cilët deshin ta rishihnin dhe se mbeti i pakënaqur kur e kuptoi se po e përgjonin, duke folur i çuditur me një ton të lartë: "Si është e mundur të më përgjojnë pikërisht mua, që kam ardhur këtu të shoh vendin ku kam lindur ?".

Nuk është për tu habitur që disa nga telegramet e diplomatëve rumunë të akreditуar në Tiranë ishin të paqarta, ata nuk ishin ftuar askund gjatë vizitës dhe kanë marrë vesh çfarë ka bërë Eftimiu nga shtypi ose nga ai, apo nga improvizimet e shoqëruesve të tij. Ambasadori Bodnarash konkludonte në përfundim të vizitës në një "informacion" dërguar zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme se "shqiptarët e kanë konceptuar këtë vizitë jo si një veprim në kuadër të marrëdhënieve bilaterale, por si një manifestim thjesht shqiptar, me karakter privat".

Momenti më i rëndësishëm i vizitës ishte takimi me Enver Hoxhën. Duke mos qënë e ftuar as në pritjen e shkrimtarit rumun nga udhëheqësi i Shqipërisë, ambasada ka mundur të ketë vetëm informacione të pjesëshme dhe ka raportuar në Bukuresht gjëra të përgjithshme, pra faktin se Hoxha "nuk foli për probleme politike të brëndshme apo të jashtme ose për marrëdhëniet dypalëshe rumuno-shqiptare" dhe se lajmi i pritjes të Eftimiut u dha, i shoqëruar nga një fotografi, në faqen

e parë të gazetave ditën e dytë. Për fat, stenogrami i takimit i 2 Korrikut 1971 mund të shihet në arkivat e shtetit shqiptar, ku është regjistruar me emrin: "Diskutimi i shokut Enver Hoxha në takimin me shkrimtarin rumun me origjinë shqiptare Viktor Eftimiu". Të them të drejtën 11faqet e stenogramit përmbajnë pak gjëra interesante. Sekretari i parë zgjatet, përdor klishe të panumurta, ndërsa Eftimiu nuk ka mundësi të flasë shpesh. Janë shkëmbyer shumë lavdërime. Hoxha i thotë bashkëbiseduesit se është një "njeri me vlera të mëdha dhe i njohur nga të gjithë", që "ka sjellë një kontribut me rëndësi në kulturën e popullit rumun", me një "përgatitje universale", "një njeri shumë i përparuar dhe i kulturuar"etj. Eftimiu nuk bie më poshtë dhe i thotë diktatorit të Tiranës se ishte në atë çast një nga njerëzit e mëdhenj të Europës", se "fjalët i ka të mënçura" etj.Takimi ishte një rast për të kujtuar rininë kur Hoxha kreu liceun në Korçë dhe shkonte në fshatrat përreth, duke përfshirë edhe fshatin ku u lind Eftimiu dhe i kujtonte bashkëbiseduesit manat nga kopështet e fshatarëve.

Eftimiu përfiton nga një moment kur fjalamani Hoxha ndalon pasazhet mbi mirësinë e popullit të cilin ai e udhëhiqte drejt socializmit dhe evokon një takim me Stalinin, për të cilin thotë se "ka qënë një njeri i madh", duke e renditur kështu veten në kategorinë ku e kishte vendosur edhe udhëheqësin shqiptar, një stalinist i palëkundur. Ndërhyrja e Eftimiut për vizitën në Bashkimin Sovjetik e nxit Hoxhën të tregojë për vizitën e tij të parë në Rumaninë e Dezhit.Sekretari i përgjithshëm i Partisë së Punës të Rumanisë e kishte marrë nga aeroporti dhe e kishte shpënë në një shtëpi të fshehtë pranë Bukureshtit, pastaj e akomodoi në ish pallatin mbretëror, pasi diskutoi në Komitetin Qëndror, në një "sallë e cila ishte plot me kartëmonedha, sepse vetëm atje mund ti kishin të sigurta".

Shkrimtari rumun dëgjonte lëvdatat që mikpritësi bënte për partinë që drejtonte dhe lidhjet e tij me popullin, u bombardua me detaje për planin pesëvjeçar, për rininë dhe fabrikat e trikotazhit, hidroçentralet dhe prodhimet e verërave, kooperativat bujqësore etj. Hoxha i uroi jetë të gjatë "të rroni sa malet tona" dhe e ftoi të vijë përsëri në Shqipëri,"si bir i këtij populli", duke nënvizuar në fund përmasën politike të ftesës: "vizita juaj do ndihmojë në ndërtimin e mëtejshëm të socializmit në vendin tonë".

Nuk e dimë sa i besueshëm është stenogrami.Nuk është e pamundur që në të të jenë mbajtur vetëm ato që donte Hoxha. Chiril Economu thoshte se gjatë bisedës, diktatori shqiptar kishte cituar aforizma për pleqërinë dhe për diplomacinë. Për të parën kishte thënë se është "rinia e fundit", ndërsa për diplomacinë kishte thënë,me nëntekst,

(Vijon në faqen 5)

NJË VËSHTRIM MBI LETRAT E IMZOT PAL SKIRO" DREJTUAR MID"HAT FRASHËRIT

Nga Uran Butka

Imzot Pal Skiro (Paolo Schiro'-1866 -1941) peshkop katolik i etnisë arbëreshe të Siçilisë, dekan i Seminarit arbëresh të Palermos, një nga themeluesit e albanologjisë shqiptare, hulumtues, zbulues dhe studiues i literaturës së vjetër shqipe, ka pasur letërkëmbim me Mid'hat Frashërin (Lumo Skëndo) në vitet '30-'40 të shekullit XX. Letrat që Mid'hat Frashëri i ka dërguar Pal Skiro-it nuk i kemi gjetur, (Albanologu Matteo Mandala bën fjalë edhe për një letër (zarf) të Midhat Frashërit të vitit 1922, dhënë nga studiuesi Aurel Plasari), ndërsa kemi në dorë tri letra në dorëshkrim të Pal Skiro-it, drejtuar Mid'hatit, mendoj, të panjohura dhe të pabatuara më parë: Letra e datës 2.VI. 1927, letra e 30 t'dimbrorst 1930 dhe ajo e 10.6. 1938, cilat po i botojmë në origjinal në gazetën ExLibris për lexuesit, më së shumti për studiuesit e gjuhës dhe të literaturës së vjetër shqipe.

Imzot Pal Skiroi rizbuloi në vitin 1909 në Bibliotekën e Vatikanit veprën e parë në gjuhën shqipe "Meshari"(1555) të Gjon Buzukut (zbuluar më parë në Kolegjin e Propaganda Fide-s, më 1743, nga Imzot Gjon Kazazi (1702-1752) gjakovar, peshkop i Shkupit).

"Imzot Skiroit i takon merita e "rizbulimit" të librit të Buzukut, e bashkë me të edhe të një morie dokumentesh të tjera gjuhësore me rëndësi të jashtëzakonshme, mes të cilave përmendim kopjen e shtypur të veprës së Matrangës "E mbsuame e krështerë" që u gjet në Bibliotekën e Vatikanit.[1]

Lajmi i rizbulimit u dha nga Faik Konica në revistën "Dielli" të Vatrës, të datës 18 mars 1910.

Pas rizbulimit të Mesharit, imzot Pal Skiroi nisi studimin e tij, duke përgatitur një ribotim të tij, të cilin ua njoftoi miqve të tij dhe botuesve. Por, për arsye të ndryshme, studimi "I testi biblici in lingua albanese di dom. Gjon Buzuku, messi in ordine, con traduzione italiana e note", vepër fryt i "një pune dhjetëravjeçare", që përmbledh përpjekjet për të dhënë një interpretim fonetik të gjuhës së Buzukut përmes një krahasimi të imët me të dhënat gjuhësore të nxjerra nga veprat e Matrangës, Budit, Bardhit e Bogdanit, mbeti i pabatuar dhe i panjohur, studim që, sipas Matteos, shënon filologjinë moderne shqiptare.[2]

Paolo Schirò qe jo vetëm një apostull i zellshëm i fesë të krishtene, por edhe një albanolog, që la punime të rëndësishme gjuhësore. Më 25 shkurt 1912 nisi botimin në Palermo të Sicilisë të fletëpalosjes e përvajshme "Fiala e T'in' Zoti" (1912-1915), një revistë e vogël, por tejet e rëndësishme, për t'i ndihmuar besimtarët e krishterë arbëreshë të marrnin pjesë në kremtimet e ndryshme liturgjike. Kryeredaktori i fletëpalosjes ishte Imzot Pal Schirò me bashkëpunëtorët e ngushtë papas Gaetano Petrottën e papas Gjergj Dorangrikjen.

"Fiala e T'in'Zoti" nuk qe vetëm një revistë fetare e së dielës, por edhe e sidomos një shkollë gjuhësie dhe një vatër patriotizmi. Përmes saj, në Kishat arbëreshe të Sicilisë jehonte përsëri gjuha e paharruar shqipe. Fiala e T'in' Zoti" ishte edhe një nxitje, një ndihmë e një mënyrë për përtëritjen dhe përforcimin e përdorimit të gjuhës së lashtë e të bukur shqipe, për rizbulimin e përforcimin e identitetit kombëtar.

Albanologët më të mëdhenj të kohës, qenë të parët që e pritën me interes shkencor botimin e "Fiala e T'in'Zoti", si Nobert Jokl, Geitle, Holger Pedersen. Imzot Pal Skirò pati një letërkëmbim të vlefshëm me studiuesit dhe atdhetarët e kohës, F.Konica, Kristo Luarasi, Lumo Skëndo, Lef Nosi, atë Shtjefën Gjeçovi, at Gjergj Fishta, dom Lazër Mjeda e shumë të tjerë.

Letërkëmbimi me Mid'hat Frashërin shfaq bashkëpunimin mes dy albanologëve në fushë të shqipes.

Në letrën e dates 2.VI.1927, Pal Skiro i kumton Mid'hatit se po i dërgonte koleksionin e revistës "Fjala e T'in'Zoti", që M.Frashëri ia kishte kërkuar. "i dërgonj Zotëris sate koleksionin e Fjalës t'im Zoti qi më lyp", si edhe dy numra të Fjalorit "I dërgonj edhe di numere t'fialorit zënë fill bashk me Fialën". Skiro-I I shpreh Mid'hatit keqardhjen per botimin e munguar të studimeve te tij dhe të veprës së Buzukut. "Buzuku pret njerimt'e vënjë në shesh"[3]

Dijetari arbëresh lexonte e vlerësonte studimet mbi autorët e Vjeter të letërsisë shqipe, që botonte Lumo Skëndo tek revistat kulturore-shkencore "Diturija" dhe "Kalendari Kombiar", veçanërisht punimet linguistike të Lumo Skëndos mbi Frangun e Bardhë (Kalendari Kombiar , viti 1903, Pjetër Budin (Kalendari Kombiar 1905), Pjetër Bogdanin (Diturija, 1927), Fjalorin e Marko Boçarit (1926), Kristoforidhin etj, sidomos artikujt "mbi Dhiatën e re të Korfuzit e Bogdanin", për të cilët bën fjalë Pal Skiroi në letrën e tij.

Në revistën "Diturija"nr.7 të motit 1927 Lumoja botonte të transkriptuar tekste të Dhjatës së Re të përkthyër nga Kristoforidhi, "duke mbetur besnik në fonetikë dhe orthografinë gramatikore të tekstit" [4]

Po ashtu, në këtë numër të Diturisë, Lumo Skëndo boton""Do copë nga libri Bogdanit", që ka tërhequr vëmendjen e Skiro-it. "Si nga vjetërsia, si nga korrektësia e gjuhës, libri Bogdanit shikohet prej shqiptarëve si një vepër klasike. Shpesh në bisedimet gramatikore format e gjuhës që përdor Bogdani, sillen si dëshmi të një teze..."

Letra tjetër e Pal Skiroit për Midhat Frashërin, që mban datën: Palermo, 30 t'Dimbrorst 1930, konfirmon edhe një herë punën e tij të pandërprerë në fushë të shqipes, si edhe shqetërimin për mungesëm e mjeteve monetare për botim. "Më pyet Zotëria kji punë dot kem në dorë? Kam, kam, por të hollat na mënjen e nuk dim si t'i botoje shkresat tona".[5]

Ndërkohë atdhetari Pal Skiro thekson nevojën e bashkimit të të gjitha përpjekjeve të studiuesve shqiptarë, që gjuha jonë të përparonte. "E prashtu kush e njef (veç Buzukut) Budin? Kemi nevojë të bashkohemi sa gjuha jonë e moçmë të njihet, të shtillet e të përparonjë, të lulzonjë. Kur ndonjëherë të përzihemi gjith-nji-bashku ndë kuvend e të ligjerojem vërteta kje a më bam me randësi? Kemi shkollë, kemi botime, por kje janë përpara dies së vërtetë, përpara të huajit kje na shkelien gjuhën të bukur?"[6]

1 Mandala, Matteo, "Pal Skiroi dhe studimi i parë filologjik i "Mesharit" të Gjon Buzukut", 2020, Exlibris.al

2 Mandala, Matteo, po aty

3 Letra e Pal Skiro, Palermo, 2.VI.1927

4 Lumo Skendo Një qindvjetor që ka rëndësi për ne, Diturija, 1927

5 Letër e Pal Skiro , Palermo, 30 t'Dimbrorst 1930

6 Letra e 30 dimbërorst 1930











Në këtë kuadër, ai interesohet për botimin e Justin Rrotës lidhur me Mesharin. "Janë kenakjur te Ministria prei botimit e prof. Rotas? Kjish thot Zotëria?"

At Justin Rrota, klerik katolik, dijetar, studiues i kulturës dhe gjuhës shqipe, në vitin 1929 kishte sjellë në Shqipëri nga Biblioteka e Vatikanit tri kopje të Mesharit të Gjon Buzukut, zbuluar nga peshkopi Pal Skiroi. J.Rrota studioi dhe botoi pjesë të zgjedhura e të komentuara nga "Meshari" për shkollat e mesme tek revista "Hylli i Dritës" VI. Për këtë botim e ka fjalën Pal Skiro në letrën e mësipëme, dërguar Lumo Skëndos.

Po ashtu dijetari Skiro kërkon bashkëpunimin e Midhatit, Fishtës e të tjerëve me nipin e tij, Dr. Gjiusepee Schiro , poet, shkrimtar, linguist, publicist arbëresh, profesor dhe drejtor i Katedrës së gjuhës shqipe në Institutin Oriental të Napolit, që kishte ardhur Shqipëri me ftesën e të ndriturit Gjergj Fishta.

Letra e tretë, Palermo, 10.IV.1938, mban dy mesazhe të rëndësishëm të Pal Skiro-it: Vlerësimin për punën diturake e studimore "të lavdëruashme" të Mid'hat Frashërit: "Me gëzim marr laime nga "Përpiekia", punën e lavdëruashme t'Z. suaj mbi Institutin Albanologjik të themeluar. Jam i kënakjur fort psa Znia juaj vetë tue e goditur dita me ditën… Të pakë janë edhe shkjyptarët kji din mirë gjuhën e vet: të pakë janë kji shkruajën me orthografin e duhur: mbi gjithë se të shumë kanë dishir të dzen, të din." shkruan ai në këtë letër.

Njoftimi tjetër rëndësishëm i kësaj letre është se botimi i Mesharit i Gjon Buzukut i përgatitur nga albanologu Pal Skiro, "ësht gati për të shtypur e të botuar. Kam shpëresë se shpejt dot vinjë në dritë".

Së fundi duam të theksojmë letërkëmbimin dhe bashkëpunimin e Mid'hat Frashërit me mjaft albanologë të shquar si N.Jokli, H.Pedersen, Weigand, Petrotta, Shuflai, M.Rroques, Kordinjiano, Gj.Pekmezi, E.Çabej etj. Le të përmendim këtu vetëm letrën e Gaetano Petrottës, klerik, shkrimtar, studiues, bashkëpunëtor i ngushtë Pal Skiroit dhe botues i Mesharit të Gjon Buzukut, drejtuar Mid'hat Frashërit më 23 shkurt 1932, ku, i shkruan ndër të tjera: "Ju falënderoj prej zëmërës për artikullin, i cili më ka dhënë një kënaqësi të madhe për fjalët e bukura që kini shkruar mbi veprën time: janë pak fjalë po thonë më shumë se dhjetë faqe shkrimi. Për mua fjalët e miqve në këtë rast të botimit të librit kamë qenë një shpërblim moral i madh e më kanë paguar punën e rëndë më mirë se çdo shpërblim material: po shumë nder më kanë prurë fjalët e veteranëve të patriotizmit, gazetarizmit e të shtudimevet shqype. Kemi dërguar dy pacco-postal recommande me tër copat që kini lypur të Kamardës e me një copë t'Budit , si i kemi, me kartë të zverdhur".[7]

7 Letra e Gaetano Petrottës drejtuar Mid'hat Frashërit, 23 shkurt 1932





(Vijon nga faqja 3)

se "është më mirë të lindesh diplomat shqiptar se sa francez (sepse) si shqiptar arrin në Paris, ndërsa si francez në Tiranë", ku Eftimiu kishte reaguar duke sugjeruar se kjo mund të thuhej vetëm në kohën e mbretit Zog. Asgjë e tillë nuk del në dokumentat e arkivit. Ajo që është e qartë është se diskutimi Hoxha-Eftimiu u paraqit në faqen e parë të gazetave, ashtu si ndodhi edhe me dekorimin, ndërsa "shkrimtari i njohur rumun me origjinë shqiptare", siç ishte përkufizuar shprehu fjalë lavdëruese edhe në një konferencë shtypi të organizuar pas pritjes në nivelin më të lartë.

Nga ana tjetër, kjo ishte praktika e vendosur nga komunistët e Tiranës, ashtu siç theksonte ambasadori Manole Bodnarash në një telegram që i referohej dhe rumunëve të tjerë, jo aq të njohur si Eftimiu, por të cilët ishin të gatshëm në atë epokë të mbështetnin propagandën e Hoxhës.

Rumunëve të ftuar iu kërkoheshin" deklarata lavdëruese(…) .Një pjesë nuk i bënin, edhe pse dhe ata ishin pritur nga Enver Hoxha, si Cezar Ivanescu, por të tjerët nuk përmbaheshin ti bënin si akademiku Al.Rosetti, i cili në verën e vitit 1972 konstatonte se "ky popull me njerëz të guximshëm" ka ripyllëzuar gjithë Shqipërinë dhe, më shumë se kaq,"kjo punë entusiaste e gjithë popullit, për zhvillimin e vendit" duket në arritje të shumta të regjimit,"hekurudhat janë shtuar, rrugët janë zgjeruar dhe asfaltuar, janë ngritur fabrika në të gjitha zonat, gjithë vendi është elektrifikuar, ndërsa popullsia është rritur me një milion". Gjuhëtari i madh e shihte gjithçka në ngjyrë rozë "grupe fëmijësh" në rrugë,"të cilët i japin një dimension të ri hapësirës lokale dhe e bëjnë të gëzueshme atmosferën" dhe në përgjithësi,"një atdhe i ri ".

Ky është toni i përdorur edhe nga Viktor Eftimiu në vjeshtën e vitit 1971, në një arikull në *Luceafarul*. Teksti i tij është një përmbledhje e historisë së Shqipërisë, nga ilirët tek Enver Hoxha, duke kaluar nga Skënderbeu dhe pavarësia e vitit 1912, por edhe një rimarrje e tezave të pandryshuara të propagandës të Tiranës. Eftimiu krahësonte vendin "e varfër,të munduar,të ngrysur" prej të cilit kishte ikur 65 vjet më parë me vendin e lulëzuar "në sajë të proletariatit të udhë- hequr nga Partia e Punës me sekretarin e parë Enver Hoxha në ballë, një udhë –heqës i dashur dhe i respektuar nga të gjithë shqiptarët". Ai numëronte pastaj sukseset e Shqipërisë duke përdorur fjalorin komunist: puna vullnetare e rinisë, lulëzimi dhe shkëlqimi i atdheut, lidhja e fortë njeri-popull-udhëheqës, teza e proletariatit, i cili ka marrë armët dhe ka zbuar pushtuesit fashistë etj. Disa fraza janë të papritura dhe rimarrin shabllone që përdoreshin edhe në Bukuresht, "gjëja më interesante, të cilën e kemi admiruar në udhëtimin tonë ishte krijimi i njeriut të ri" ose "çdo njeri është vendosur në vendin e vet, me vullnetin e parties e cila ia njeh meritat dhe e vlerëson". Artikulli prek tërthorazi edhe disa debate që zhvilloheshin në Rumaninë e asaj kohe, siç është, për shembull, qortimi i të rinjve që mbanin flokë të gjata ose mjekër. Viktor Eftimiu thotë se në Shqipëri "nuk pa njerëz të veshur keq të mbetur rrugëve dhe as mjekroshë të padenjë".

Për vizitën që bëri në shtëpi jep pak detaje.Ai shënon vetëm se ka marrë nga mjeshtrat e punimit të qelqit të zonës një vazo me "dhé nga rrënojat e shtëpisë së tij në Boboshticë". Ka, po ashtu fjalë admirimi për Tiranën, të cilën e përshkruan si qytet të shkëlqyer modern, me pallate prej mermeri, gjelbërim të shumtë, ajër të pastër, ujë të ftohtë dhe të shijshëm.

Shënim : Ky fragment bën pjesë në vëllimin *Robi i suksesit*, i cili do botohet së shpejti nga editura Humanitas, në Bukuresht.

Përktheu nga rumanishtja:
Pandi Bello

INDIVIDUALITETI I ROMANCIERIT BASHKIM HOXHA

Nga Floresha Dado

Në dendësinë e romaneve, botuar në dy dhjetëvjeçarët e fundit, ka krijues që mbeten mënjanë, larg vemendjes së kritikës letrare, ndërkohë që, nëse futesh në korpusin e krijimtarisë së tyre, zbulon se ka diçka të veçantë, origjinale, se ka një sy të mprehtë që sheh dhe guxon të protestojë artistikisht, ka, sidomos, një dhimbje! Mbas një vetëdieje individuale mbarten shqetësime të shoqërisë së sotme. E tillë është krijimtaria romaneske e Bashkim Hoxhës, romanet e të cilit dëshmojnë se procesi ynë letrar është më i gjerë, më i pasur se sa e njohim në mënyrë të përgjithshme. E parë në kompleksitetin e vet proza e tij dëshmon përparësinë e filozofisë që përshkon letërsinë, rolin që vepra letrare luan në turbullimin e shpirtit njerëzor, guximin në përballjen me fenomene që ne bëjmë sikur i kalojmë pa vemendje e interes. Është e pamundur të zbërthehet plotësisht sistemi artistik i gjithë veprave të B.Hoxhës, megjithatë, disa boshte themelore të procesit të tij krijuese, ku mund të ndaleshim, do të ishin :

Filozofia e degradimit moral, që përshkon gjithë sistemin

Vdekja e dashurisë njerëzore dhe ndëshkimi i pashmangshëm i vrasjes së saj, dashuria që nuk ka kufijë kohorë, dashuria që është bërë pis, filozofia drithëruese 'të jetosh nga urrejtja', kompleksiteti dhe absurdi i jetës së njeriut, përballja e ligjërimeve korba/pëllumb, bisedat imagjinare me korbat, efektet alegorike të lidhjes me pikturën e Van Gogut, ndërtimi i kapitujve sipas një fjalori shpjegues (alegorik), që thekson filozofinë e mprehtë të dhunimit të dashurisë në botën e 'pisët' etj., vlojnë në gjithë sistemin e tij krijues. (*Mot i keq për dashuri,* 2002; *Romancë ditën e krimit,* 2007). Ideja e ikjes së njeriut të dëshpëruar, sillet përmes ndërfutjes së vargjeve poetike, për të theksuar më fort dramën njerëzore:

Vrapoja
me dëshirën për të ikur. S'di se ku.
Vrapoja, , sa më larg për të ikur.
Ikja larg, aq larg
sa mbërrija në të njëjtën pikë nga ku isha
nisur... (Lakuriq, 2003)

Zhgënjimi ka sjellë te romancieri humbjen e besimit, të shpresës (kjo është drama më e madhe e shkrimtarit që përjeton shpirtërisht problematikën e kohës). Metafora e dëshirës për të shqiptuar fjalë të pista... është pikërisht dhimbja e brendshme. Filozofia "këtu është tretur mirësia", disa absurditete të jetës sonë, shqetësimet ekzistenciale, etj. e çojnë autorin te pyetja e postmodernizmit : sa ekziston e vërteta ? Në letërsi gjithnjë ka zënë vend arësyetimi mbi dashurinë, qasur në aspekte të ndryshme. Te Bashkim Hoxha ndodh që dashuria zbulohet edhe me fjalë të ndyra, sepse ajo është bërë pis. I gjithë romani është metaforë e dhimbshme. Rapori alegorik me puritanët, që thekson përballjen me vesin, raporti midis lakuriqësisë dhe pastërtisë së shpirtit, apo degradimi moral i shoqërisë përmes ironisë, që kalon edhe në sarkazëm, vjen dërrmues në paralelizmin me amfiteatrin ku njerëzit duartrokasin sepse gladiatori u vra! (*Mbreti i vesës,* 2003; *Duartrokitësit*, 2020)

Kapërximet nga aspektet morale, në kuptimin e gjerë, tek probleme të filozofisë njerëzore, që lidhen me fatin, me mëkatin dhe dashurinë, me raportin njeri/kafshë, ëndrrën e vazhdueshme për një jetë tjetër dhe arratisja nga qyteti, dëshira për zgjatjen e jetës, (po a ja vlen kjo lloj jete ?), ironia ndaj banalitetit njerëzor, besimet tragjike në absurditete... Sa marrëzi besojmë në këtë jetën tonë ! Sa është njeriu i sotëm gjysmëgjallëgjysmëvdekur? këto janë thelbi i shqetësimit të B.Hoxhës. (*Heronjtë e viagrës*, 2009, *Lakuriq*, 2003, *Kronikat e Mjegullës,* 2019, *Një shaka e vogël me vdekjen*, 2021). Dhe në fund pyetja provokuese: a mund të jetë liria një dënim ?

Raporti alucinativ midis reales dhe situatave jo normale (gjithë komunikimi me korbat që dalin nga piktura e Van Gogut) mbart një ngarkesë kuptimore të jashtëzakonshme. Jetohet nga urrejtja apo nga dashuria ? Kjo është pyetja filozofike që përshkon gjithë veprën e B.Hoxhës. Nëse nocionin kyç do ta gjenim shpesh te fjala 'vdekja', ky është raporti me dashurinë e vrarë, me mëkatin e dhunës dhe braktisjes, me tradhëtitë që një shoqëri e tërë ka bërë me sy të mbyllur...Mund ta quajmë veprën një metaforë mbi metaforën. Meritë e autorit është ndërtimi i një personazhi në komunikim jo të zakonshëm, që humbet në ankthin e ndërgjegjes së vrarë, që e ndjen më në fund thellë sa shumë e ka vrarë dashurinë ! Prandaj, aty ku dhunohet dashuria, vdekja është farë pranë.

Hipokrizi tronditëse

Shumica e romaneve të B.Hoxhës janë sarkazëm ndaj hipokrizisë së sjelljes njerëzore, ndaj 'idealeve' mashtruese, ndaj ngjarjeve që në thelb cënojnë inteligjencën dhe besimin njerëzor. Vepra *Heronjtë e Viagrës*, (2009), është ndër rastet e rralla në letërsinë e sotme që trondit dhe zhgënjen dhimbshëm për një hipokrizi të madhe; ajo, njëkohësisht, cënon vlerën e misionit të ushtarëve shqiptarë në Irak, Afganistan- (nuk ka rëndësi se ku). Vetë fjala 'hero' zhvleftësohet në mënyrë të dhimbshme. Përballja e dy mentaliteteve : do bëjmë sikur besojmë ! dhe e vërteta e guximshme e personazhit Kristinë, shprehin përballjen dashuri/mashtrim. Pse ky deheroizim ? Pyetja do të kishte përballë disa shpjegime, po aq sa edhe shqetësime të diskutueshme, lidhur me botëperceptimin e romancierit. Raporti: e veçanta me të përgjithshmen, padyshim është tepër delikat, për të shpëtuar nga cënimi flagrant i së përgjithshmes. Megjithatë, mendoj se vepra tjetër më interesante dhe e guximshme, përballë hipokrizisë së shoqërisë së sotme, është edhe *Duartrokitësit,* (2020), në të cilat sarkazma shfaqet në përmasa sa origjinale, aq edhe drithëruese. Ka revoltë të romancierit përballë një mekanizmi që përpunon, drejton dhe realizon një 'teatër' të madh mashtrues. Lexuesi, sigurisht, do të ndjehej i fyer, i tallur, i shvleftësuar ndaj skenarit të fshehtë të organizimit të kësaj shfaqjeje hipokrizie. Ironia e hartimit të teksteve të vajtimit, (kush i duhet botës, poezia apo tekstet e sajuara të vajtimitn ?) apo rregjistrimi i të qeshurave fallco, trajnimi për duartrokitje, dirigjimi i fshehtë i duartrokitjeve. etj... janë momente që trondisin dhe krijojnë zhgënjim për shumë manifestime skenike: "Kështu mashtrojmë të gjithë - duartrokasim mashtrimin ! ".

Po aq guximshëm shfaqet denoncimi i mashtrimit mbi disa personazhe dhe ngjarje historike, ku humori i zi duket sikur do të zbusë paksa sarkazmën ndaj skenave... Në mënyrë metaforike autori shpërthen : "*Njeriu vjen në jetë i bardhë si dëbora. Por dhe dëborën e shkelin me këmbë, vijnë njerëzit dhe ia prishin bardhësinë. Nuk flas pastaj se si e dhjesin qentë atë bardhësi.*" (*Kronikat e Mjegullës,* 2019).

Kontrasti moral

Sigurisht është vazhdim i filozofisë që përmbush gjithë sistemin krijues të autorit, por dhe mjeti themelor i poetikës së brendshme së tij. Në thelbin e vet kontrasti është përballje !. Përballen personazhe, situata emocionale, raporte njerëzore dhe të stisura, lakuriqësi e jashtme dhe pastërti e shpirtit (*Lakuriq,* 2006); apo dy situata halucinative, (biseda me korbat dhe biseda, halucinante, jo reale në telefon); kontrasti shpesh prish kufijtë emocionalë me përqasjen metaforike në vargje të stilit të legjendës popullore, të lidhjes së pikturës me situatën emocionale; të ngjyrës së pikturës me shpirtin mëkatar ; shpesh herë kalon vrullshëm te paradoksi, duke e bërë lexuesin të mendojë nëse është komunikim real apo i nënvetëdijës së tronditur që ka mbetur brenda shpirtrave të plagosur ? Është takim njerëzor apo i hijeve ? (*Romancë ditën e krimit,* 2007), etj. Kontrasti bëhet ndonjëherë edhe më provokues: *njeriukuturu* sot dhe *njeriu i ri* dje ! janë të ndryshëm apo kanë diçka të përbashkët që e kanë humbur ? A është bërë njeriu një aktor, në kuptimin e rolit që luan në jetë ?. Kontrasti më tronditës është midis të vdesësh në luftë/të vdesësh nga dashuria, apo përqafimi njerëzor dhe shpërthimi i eksplozivit...Apo kontrasti midis artit/ndjenjës, mendimit dhe mediokritetit, tallavasë (*Gruaja e shiut,* 2016)...

Alegoria, simbolet, paradoksi, sarkazma

Ka një raport interesant midis rrethanave 'reale' dhe metaforës së madhe, apo dhe alegorisë, ku duket sikur ato shfaqen vetëm herë pas here, për t'ja lënë vendin episodeve reale të jetës së shoqërisë sonë. Romanet e B.Hoxhës, ndonëse ruajnë 'qartësinë' e përfytyrimit artistik, kanë një strukturë të përbashkët, që buron nga filozofia e përjetimeve të tij krijuese. Është ironia, që shkon deri në sarkazëm të fuqishme, është paradoksi për atë çka rrethon jetën tonë, është një sistem i tërë simbolesh artistike që provokojnë qëndrimin e lexuesit ndaj realiteteve të sotme. Metafora e mjegullës (*Kronikat e Mjegullës,* 2019) ndër më të fuqishmet në korpusin e tij romanesk, merr peshë të veçantë, duke rrokur historinë e shqiptarëve ... 'Njerëz turbull', 'Mjegull ngado', Mjegulla vazhdon në rrjedhën historike, ajo mbulon të vërtetën, mashtrimin dhe shtrembërimin e fakteve... Metafora e humbjes së virgjërisë katër ditë para shpalljes së pavarësisë, mashtrimi historik... Mjegulla edhe sot, në kuptimin e historisë apo dhe të dukurive reale të sotme... Dhe fundi i romanit sfidon në stilin e vargjeve poetike., për sot dhe për gjithnjë:

"Edhe njerëzit duken ndryshe në mjegull.
Pjesë – pjesë duken njerëzit. Herë shfaqen, herë treten.
Kush është ai që mund të vizatojë njerëzit në mjegull ?

Forca e marrëzisë! Sa shumë besohet tek ajo ! Paradoksi tronditës midis 'vdekjes së bardhë' dhe 'jetës së zezë' shpërthen si një ndër klithmat më tronditëse të zhgënjimit njerëzor (*Një shaka e vogël me vdekjen*, 2021). Në raste të tilla fshihen kufijtë midis reales dhe imagjinares... Përmasa të veçanta merr metafora e korbave në romanin *Romancë ditën e krimit* (2007), bisedat halucinantë të personazhit me to, dialogjet rrënqethëse të korbave, pohimi vrastar se dashuria dhe e vërteta kanë vdekur.....janë ndër momentet më të fuqishme të metaforës së madhe të romanit. Raporti *jetë/dashuri/dhunim* ndërtohet me tonet më dramatike, me një ritëm ligjërimor jo të zakonshëm, duke e spostuar vemendjen e lexuesit nga realja tek ndjeshmëria e përjetimit të dramës shoqërore. Kalohet, ndonjëherë, në ngjyra të realizmit magjik, te komunikimi ireal midis pikturës dhe botës shpirtërore të tronditur të personazhit. Metaforat dhe simbolet, që krijon romancieri, janë sa origjinalet aq edhe të ngarkuara me shqetësime të fuqishme. Kështu, metafora e shpjegimit të dukurive njerëzore përmes notave muzikore, simboli i vesës (*Mbreti i vesës*, 2003), metafora e protestës së prostitutave në kontrastin me qytetin e veseve, raporti midis reales dhe fantazisë, etj. i jep rëndësi idesë se fenomenit dhe jo aq vendit ku shfaqet ky fenomen. Metafora e gazetarëve, e kameramanëve, që rendin si kope për të zbuluar 'të vërtetën', ironia ndaj vajtojcave e poetëve... (*Herojtë e viagrës* 2009) sarkazma për rrjetet sociale, ku mashtrime, gënjeshtra, kotësia zvjerdhin komunikimin e vërtetë njerëzor, ironia për këngën tallavà, transformimi i vajzave në parukeri,

etj...(*Duartrokitësit* 2020). Ironia në këtë roman, që shkon deri në sarkazëm, merr përmasa të jashtëzakonshme, ku 'gjithshka është kodifikuar në imazh: jeta e përditshme, ekonomia, politika. 'Ne jemi banorë të republikës së videos, televizionit. Na sundojnë imazhet". Dhe kjo e bën aq banale kohën tonë, mendon personazhi. Mendoj se ky roman është ndër realizimet më tronditëse të rebelimit të shkrimtarit ndaj hipokrizisë dhe degradimit moral të një shoqërie. Po aq e ngarkuar është sarkazma në romanin *Lakuriq* (2006), që ngrihet mbi kundërvënien që ekziston brenda moralit të prishur... të një qyteti që gëlon nga fjalë të ndyra (metaforë e fuqishme).. Lakuriqësia fizike e monumenteve të shquar artistikë, përballë degjenerimit moral të kohës, krijon një kontrast tronditës për lexuesin. Veshja e statujave mbart një filozofi aktuale.

Teknika strukturore

Letërsia gjithnjë ka qenë shqetësim, përplasje e shpirtit të shkrimtarëve me realitetin njerëzor, ndaj të cilit ndjeshmëria e tyre është e thellë. Dallimi i përket ndërtimit kësaj marrëdhënieje përmes strukturës artistike. Nëse thamë se bota shpirtërore e intelektuale e Bashkim Hoxhës ka brenda saj shumë revoltë ndaj hipokrizisë, mashtrimit dhe degradimit moral të shoqërisë së sotme, ajo që i jep ngarkesë emocionale janë kërkimet në strukturën e romaneve. Mbas çdo gjetjeje të re lind pyetja: janë ato thjesht skema të huazuara apo ndërtime që kanë logjikë brenda vetes ? Ky është problemi themelor i diskutimeve, në përgjithësi, mbi vepra të autorëve të rinj, shkruar këto tre dekada të fundit. Në stilin kompozicional të Bashkim Hoxhës kombinimi i rrjedhës rrëfimtare me vargje poetike, apo me arsyetime mbi dukuri të caktuara, citatet në fillim të kapitujve apo komentet e shkurtra që paralajmërojnë lexuesin për përmbajtjen e kapitujve, paratekstet e çdo kapitulli, titujt ndonjëherë të çuditshëm..., zgjedhja e frazës së fundit të një kapitulli për të nisur kapitullin pasardhës, apo që vjen si parathënie e këtij të fundit, etj. sigurisht nuk janë gjetje thjesht interesante, por që lidhen alegorikisht mes tyre, në sfondin e megastrukturës kuptimore të romanit. Tek *Kronikat e Mjegullës* (2019), ku nënkapitujt bëhen emërtim dhe pikëvështrim ndaj personazheve, midis tyre ze një peshë të veçantë metafora e mjegullës, që ka peshën e një personazhi të fuqishëm, duke i dhënë një mbulesë gjithë **strukturës kuptimore** të romanit. Poezitë, që prezantohen si 'lavdërime të mjegullës', krijojnë një nënshtresë kuptimore, mbi të cilën ngrihen skenat, personazhet... Thelbi është pikërisht te kjo metaforë, me të cilën autori luan, organizon, provokon apo befason lexuesin. Paqartësia që krijon mjegulla, fshehja e së vërtetës, është ndër gjetjet më interesante në filozofinë alegorike të këtij romani, ku ndërfutja e vargut poetik nxjerr më drejtpërdrejtë raportin që kërkon autori me të vërtetën...

Mjegull, hapu pak !

Hapu pak, ashtu siç hapet perdja e një skene për të zbuluar çfarë ka ngjarë

Më zbulo peisazhe, histori, njerëz.

Mos i fshih !

Funksioni ligjërimor realizohet si përmes kuptimit thelbësor të përmbajtjes së tij, ashtu edhe në vendin që ze në strukturën e kapitujve të veçantë, si edhe mbishtresat, kur përsëritja e së njejtës fjalë (p.sh. 'e fundit') mbart një ngarkesë të veçantë kuptimore...Struktura e disa romaneve të B.Hoxhës duket, herë-herë, si montazh skenash, episodesh, apo imagjinatave befasuese, që shkrihet ndonjëherë edhe me personazhin. Tek *Romancë ditën* e krimit (2007) krijohet paralelizëm midis pikturës, ngjyrave dhe situatave emocionale, vinë dialogje të pakonkretizuar, krijohet përfytyrimi i një skene në dramë tragjike, ku korbat komentojnë.... Nënkapituj të shkurtër, alternimi i dialogut, paralelizmi midis vdekjes së korbave dhe vdekjes së dashurisë, vargje të stilit të legjendës popullore, apo ndërtimi i një kapitulli vetëm me 10 vargje, dialog imagjinar që vjen papritur në strukturën e rrërfimit, etj janë disa nga teknikat e ndërtimit strukturor të veprës.

Tipar i romanit postmodernist është prishja e kufijve gjinorë, përzierja e rrëfimit romanor me aspekte të poetikës së gjinisë poetike apo dramatike... Në romanin e B.Hoxhës kjo prishje kufijsh gjinorë nuk vjen si kërkim thjesht teknik, por ndërton gjithë *skenën kuptimore* të filozofisë së veprës. Jeta është teatër ! Në funksion të kësaj filozofie struktura e romanit *Heronjtë e viagrës* ka tiparet edhe të një vepre dramtike, me 4 Akte, të ndarë në kapituj, me lidhje me spektatorin si në teatrin brehtian, me sqarimet paraprake të autorit mbi skenën në fillim të çdo akti apo peisazhi ku do të lëvizin personazhet (siç ndodh në dramë)... Shkrihen rrjedhshëm tipare themelore të narracionit prozaik dhe dramës. Kjo ndërthurje e poetikave nuk është vetëm një trill krijues, por strukturë

e boshtit ideor të romanit, e kuptimit mbi hipokrizinë e rendit dhe shoqërisë së kohës së sotme, është një sarkazëm ndaj 'teatrit' që luhet në jetën tonë...10 maksimat, që autori i quan 'pjesë të dekalogut', kapërxejnë fabulën e veprës, për të sintetizuar, sipas B.Hoxhës, të këqijat që 'bëjnë pis çdo gjë'. Fundi i romanit është shpërthimi i sarkazmës! Këtë bashkim poetikash, sipas modelit postmodernist, e hasim edhe te romani *Duartrokitësit,* ku bashkohen njëherazi rrëfimi, shpjegimet e autorit për përmbajtjen e kapitullit pasardhës, ku shtohen shënime për trishtimin etj., ku vargje të autorit ndërfuten në rrjedhën rrëfimtare, (siç ndodh edhe te *Mbreti i vesës,* 2003) ndërfutje Intermexo në vargje, ndonjëherë skemë rrëfimtare që të kujton strukturën e një skenari për film artistik (këtë tipar të një skenari filmi të parealizuar, apo modelin e një fjalori ku jepen shpjegime për jetën, fatin, dëshirën e hasim edhe te *Gruaja e shiut)* ...Fundi i romanit "Shtojca për një fund tjetër" fikson idenë se mashtrimet mund të jenë të shumta dhe të ndryshme...Ndërsa te romani *Mbreti i vesës* (2003) struktura formësohet përmes numurash, që e sjellin te lexuesi personazhin në vargje, te *Mot i keq për dashuri* (2002) nënkapitujt janë konceptuar sipas filozofisë së një fjalori shpjegues. Gjithsesi, është për t'u vlerësuar fakti se B.Hoxha *krijon duke menduar*, për t'u thelluar në filozofinë që e shqetëson si qytetar dhe si krijues.

Trajtat rrëfimtare

Duke qenë elementi themelor i gjinisë epike, trajtat rrëfimtare në roman venë në kandar, në mënyrën më të

dukshme, intuitën krijuese të një shkrimtari, rrjedhën origjinale dhe të natyrshme të mënyrës së lidhjes së tij me lexuesin. Prandaj narratologjia ka mbetur, sipas meje, trajtimi më i rëndësishëm në poetikën romanore, me variante të pafund të procesit krijues. Bashkim Hoxha është rrëfimtar që përpiqet të depërtojë në teknikat narrative, duke njohur skemat, por edhe duke shkuar përtej tyre. Tek *Hotel Ballkan*, (2002) në aspektin rrëfimtar mpleksen dy plane, që lidhen me të shkuarën,... plani i parë është në kohën foljore të tashme dhe plani i dytë në të kryerën, ndonjëherë plani i parë rrëfimtar bën që e shkuara, ajo ç'ka ndodhur, të shihet si nën vëzhgimin e një kamera që ndjek lëvizjet... Ndërthurja e dy kohëve rrëfimtare i jep romanit një ritëm herë të shpejtë, herë të qetë, në vartësi të situatave të personazhit. Tek romani *Lakuriq* (2006) rrëfimtari 'luan' me lexuesin : herë i drejtohet drejtpërdrejtë, herë prezanton veten dhe qëllimin, herë shkon në trajtat e rrëfimit të zakonshëm, herë shkrihet me atë që përjeton personazhi, herë largohet prej tij për të t'u dhënë pas vargjesh me karakter filozofik, psikologjik, herë kombinon rrëfimin mbi personazhin me vetërrëfimin e rrëfimtarit.. Tek *Duartrokitësit,* rrëfimtari tregon si do jetë e ardhmja, si do lëvizë personazhi, herë vijnë breshëri pyetjesh nga të paidentifikuar, herë rrëfim i dialogjizuar. Rrëfimtari, madje, merr përsipër të parashikojë se çfarë do të thonin apo çfarë nuk do të thonin personazhet, gjë që e zhvendos theksin nga personazhi tek synimi i rrëfimtarit. Kjo theksohet më fort në rastin e rrefimit-monolog-sarkastik të komunikimit me kryeministrin, live në emision. Tek *Gruaja e shiut* (2016) rrëfimi konceptohet si një proces xhirimi, ku ndizen e fiken kamerat, ndërsa ndodh edhe që ndonëse flet personazhi, rrëfimi reflekton haptazi vetë autorin. Në krahasim me romanet e tjera, ku idetë dalin vrullshëm, në këtë vepër ato janë të padukshme, janë brenda, rrëfimi është më i shtruar dhe duket sikur ka më shumë rëndësi ngjarja se sa metafora e brendshme. Tek *Mot i keq për dashuri* (2002) shfaqet një rrjedhë tjetër rrëfimi, ndërtuar sipas germave të alfabetit, me pjesë shumë të shkurtra, që vlejnë vetëm për të hedhur nje ide, një pikëpamje filozofike. Secila shkronjë mbart pikënisjen e një rrëfimi që pritet të zhvillohet më pas. Përzierja e rrëfimit me një lloj fjalori shpjegues për terma të caktuar, në të vërtetë ka lidhje të brendshme kuptimore me gjendjen e personazhit. Ndodh të shfaqet një episod, në dukje pa lidhje, por është personazhi-rrëfimtar në kohën e tashme, që kryen bashkimin. Personazhi-rrëfimtar arrin të ndërtojë biseda të imagjinuara të personazheve të tjerë, që lidhin idenë e tij, ose të paraqesë një rrëfim të imagjinuar.

Gjatë rrjedhës rrëfimtare te *Herojtë e viagrës* (2009) papritur rrëfimtari e paraqet veten si një personazh që futet në veprim..., apo kujtohet të japë shpjegime për teatrin... Tek *Romancë ditën e krimit* (2007) rrëfimi shpërthen në formën e pyetjeve; është një ligjërim që paraprin tragjedinë, situatën, që mbart erën e vdekjes. Apo ndonjëherë rrëfimi nis me dialog, i cili shpesh është imagjinar midis personazhit dhe korbave-metaforë. Në trajtat rrëfimtare që vërtiten rreth personazhit shfaqet, te *Lakuriq,* edhe mënyra e karakterizimit përmes numërimit të disa karakteristikave, apo edhe karakterizimet në vargje, që në të vërtetë janë përjetime të vetë rrëfimtarit....Lind pyetja : këto tipare, dhe të tjera, janë thjesht trille të poetikës, apo vinë natyrshëm dhe të menduara sipas një logjike të brendshme ? Po dhe jo ! Kjo pyetje përmban sfidën e vërtetë në zbërthimin e funksionit të narracioni romanor të çdo shkrimtari.

& & &

Sigurisht, është tepër e vështirë të analizohet në pak faqe krijimtaria romanore e një shkrimtari. Gjithashtu, pa dyshim, si për çdo krijues, mund të ndaleshim në aspekte të ndryshme të diskutueshme të krijimtarisë së tij...(Çdo kritik ka pikëvështrimin e vet). Kjo do ishte qasja më normale, por, ajo çka u përpoqa të skicoj është krijimi i një përfytyrimi mbi tipologjinë e filozofisë dhe poetikës së një romancieri, sa interesant, aq edhe të pa vëzhguar sa duhet në kritikën tonë letrare. Bashkim Hoxha është modeli i krijuesit që nxjerr pa bujë, por në mënyrë tronditëse, problematikat e dhimbshme të shoqërisë së sotme dhe, në këtë proces, sikur synon të shpëtojë nga emocionet që e shqetësojnë së brendshmi. I hedh ato në vepra për t'ja përplasur lexuesit. Sikur do t'i thotë: ja ku janë problemet tona! Prandaj ndodh që thelbi ideor i gjithë korpusit të tij romanor përforcohet edhe me vargje, ku alegoria i afrohet haptazi kuptimit të drejtpërdrejtë :

Mjegull në natyrë. Mjegull brenda teje.
Kujdes: jo për çdo gjë e ka fajin mjegulla.
Shko një herë nga okulisti të të shikojë sytë
mos të kanë zënë perde.

ZEMËRIMI I KRISTOFORIDHIT

Hyrje nga Taulant Ceka

Edhe engjëjt zemërohen. Kjo i ka ndodhur engjëllit të Rilindjes Kombëtare, babait të Gjuhës Shqipe, Kostandin Kristoforidhit.

Pas 20 vjet rropatje ndër fshatrat e qytetet e Shqipërisë për hartimin e fjalorit të gjuhës shqipe, pasi arriti të mbledhë 400 napolona flori në emër të tij në kolonitë shqiptare të Vllahisë dhe të Misirit,"vëllezërit" shqiptarë të këtyre kolonive, ndërhyjnë në Bankën e Bukureshtit, i marrin 400 florinjtë e mbledhur në emër të tij për botimin e fjalorit në Rumani dhe i harxhojnë në gosti e gëzime me sebepin e themelimit të shoqërive atdhetare.

Është një letër drejtuar mikut të tij Nikolla Naco, kryetar i shoqërisë "Drita" të Bukureshtit, ku derdh gjithë mllefin e grumbulluar për këtë grabitje, me pasojë për kryeveprën e tij, por edhe për trashëgiminë e gjuhës kombëtare. Ashtu si shprehet në letër, fjalori në dorëshkrim ishte një vepër, që do të përbënte themelet e gjuhës shqipe, që po rilindte nga thellësitë e shekujve. "Ishte 40 mijë fjalë, i tipit Larousse", shkruan prof. Simon Shuteriqi, botuesi i letrës së tij në kapitullin për Kristoforidhin në historinë e letërsisë shqipe, përgatitur nga studiuesi Namik Resuli.

Pas vdekjes së Kristoforidhit, dorëshkrimi i mbetur i pabotuar iu shit nga pasardhësit e Kristoforidhit një botuesi grek, i cili e botoi me 1/4 e vëllimit të tij, në vetëm 11 mijë fjalë në formën e një fjalori shqip - greqisht. Edhe aq, edhe i tillë, ishte i pari fjalor shkencor i gjuhës shqipe hartuar nga një shqiptar.

Ky fjalor, më shumë se shqiptarëve u shërbeu autoriteteve të njohur të indoeuropianistikës Krecmer, Waigand, Jokli, Pedersen etj. Veç këtij fjalori, sipas dëshmisë së Simon Shuteriqit, Kristoforidhi kishte mbledhur lëndë leksikore, faqe të tëra me fjalë në gjuhët sanskrite, greke, latine, sllave, turke, që kanë hyrë në gjuhën tonë, me qëllim hartimin e një fjalori etimologjik të gjuhës shqipe. Këto dorëshkrime, deri në vitin 1945 kanë qenë pjesë e trashëgimisë arkivore të Lef Nosit.

Kostandin Kristoforidhi

Drejtuem Nikolla Nacos, kryetarit të shoqënisë "Drita", në Bukuresht.

Zoti i nderçëmë Nikolla Naco, në Bukuresht!

Kartën e Zotërisë sate shkruarë mbë 16 të vjeshtës së tretë e prita me gaz të madh; bashkë me atë mora edhe tetë kora (Ikona, harta T. C.) të Shqipërisë për t`i përndarë, po ato dhjet` abetare që më shkruan se po t`i dërgonj, s`më kanë rënë në dorë ngjer mbë sot, as kanë për të më rënë, sepse mirretë vesh se i ka ndaluarë gjymryku (dogana, turq. T. C.) i Stambollit, a gjymryku i Selanikut. Zotëria jote, kur do të më shkruajsh, a të më dërgosh ndonjë vivle (libër, T. C), a tjetërë gjë, të m`i dërgojsh me anë të Trieshtesë nga Austria me udhë të hekurit, që të dalenë në Durrës të Shqipërisë pas adresësë që po ta mbyll brenda në kartet t`ime.

Sot shtatë tetë vjet, kur qeshë unë sëmurë në Stamboll, dërgova Jano Vretonë në Vllahit e në Misir për të kërkuarë ndihmë mb`emërit t`im, që të shtypetë leksikoja (fjalori, gr. T. C.) e gjuhësë shqipesë, që jam munduarë 20 vjet për atë punë edhe kam mbëledhurë 40 000 fjalë shqip; edhe u mbëlothnë katërëqind napoleona t`arte mb`emërit t`im; edhe u vunë në Bankët të Bukureshtit, sepse nuk dilin aqë para për të shtypurë leksikone; atëherë pa pyeturë mua, pa shkruarë mua, pa dhënë zë mua, vëllezërit` t`anë Shqipëtarëtë që gjendenë në Misir bashkë me vëllezëritë t`anë që gjendenë në Vllahi, ngrehnë shoqërin` e shqipesë në Bukuresht edhe bënë dasmë e gosti e gëzim të math, dhe thërritnë bij e bija, vëllezër e motëra, nipër e mbesa, kushërinj e kushërira, miq e miqësi, por kryet e punesë tanë, e gjuhësë shqipesë nuk e ftuanë, po ç`bënë ata? Muarnë ato para që qenë mbledhurë mb`emërit tim, për të shtypurë leksikone, edhe shtypnë ca vivlia shqip, ato që kanë shtypurë ngjer mbë sot; zunë të bëninë mur, pa vënë themeli më përpara. Nuk menduan` ata vëllezër të bekuarë, se muri pa themeli nukë qëndron, por rëzonet`e shembet e bie përdhe? Nuk` e zunë kalinë nga freri, po nga bishti, që shpëton e ikën.

Shqipëria ka shumë njerës të diturë, që kanë kënduarë në Elladhë e në Evropë edhe duanë të shkruajnë vivlia Shqip, po nuk` e dinë Shqipenë mirë, sepse Shqipeja është më e gjerë edhe më e thellë së Gërqishteja, që flitetë sot; këta njerës të diturë presënë të shtypëtë leksikoja e Shqipesë, që të mësojenë mirë gjuhën` e Shqipesë, edhe të zen` e të shkruajnë gjithëçefarë vivliash Shqip, përandaj thashë përpara, se zunë të ngrehenë shtëpi pa vënë më përpara themeli'.

Desha t`u flas juve shumë fjalë, edhe t`u shkruanj juve për shumë punëra, sepse unë jam i rrahur` e i djegur` e i pjekur` e fort i stërviturë në punët të Shqipesë, edhe kam 20 vjet që po shkruanj gjithënjë gjuhën e Shqipesë, edhe kam shtypurë përmbi njëzet copë vivlia Shqip gegërisht e toskërisht, po s`janë fjalë që të shkruhenë të gjitha në kartë, ne paça fat të vinj në Bukuresht, atëherë dot`ua them gojë më gojë.

Përmbi gjithë këto, sido të jetë puna, ashtu qoftë, neve këtu në Shqipërit kemi dëgjuar`e kemi marrë vesh se Shoqëria e Shqipesë që që ngrehurë në Bukuresht, sot gjendet ndarë dyshe, edhe çe kanë gjajtur` e çe kanë koditur` e çe kanë bërë ndër vëllezërit, se si e se qysh, të tëra i kemi kupëtuar` e i kemi dëgjuar` e i kemi marë vesh, edhe e dimë se janë ngrehurë dy shoqëri në Bukuresht, njëra quhetë Dritë e tjetëra Dituri, edhe e dimë se njëra shoqëri vete kundër shoqërisë tjaterë, edhe e dimë se Dituria do të shkruhenë vivlia me Alfavitën e Jano Vretosë që janë gjysëmat` e shkronjavet Gërqisht e gjysëmate Llatinisht, edhe duanë që të hapenë skolira ndëpër gjithë Shqipërinë nga shqipëtarëtë vetëmë, e të mos përzihetë tjetërë komb mb`ato; po shoqëria e Dritësë do të shkruhenë vivlia shqip me Alfavitenë Llatinisht, edhe duanë që të hapenë skolira shqip në Shqipërit me anë të Rumunëvet e me ndihmë të Vllehëvet. Ndë më pyetshi mua, unë pëlqej më fort Alfavitenë llatinisht, sepse me atë Alfavitë mund të shtypenë vivlia shqip kudo, sepse gjendenë mbë çedo vent që të kërkojsh, edhe është një Alfavitë i kuptuar` e i njohurë nga të tërë kombet` e Evropësë, po ndë dashtë njeri të shtypë ndonjë vivle shqip me Alfaviten` e Jano Vretosë, nuk i gjen ato shkronja as mbe ndonjë vënt, po gjan të derthnjë shkronja të ra e të prishnje dy tre qind lira t`arta; edhe ajo që do Shoqëria e Dritësë të hapenë skolira në Shqipërit me anë të Rumunëvet e me ndihmë të Vllehëvet, nuk më duketë se është keq për Shqipëtarëtë, sepse Shqipëtaretë vetëmë s`mund të hapenë skolira, përveç kësaj Vllehetë s`kanë ndonjë sy të lik, a ndonjë mendje të keqe për Shqipëtarëtë, sikundër kanë Grekëtë që duan të pushtojn` e të urdhërojënë Shqipërinë, po edhe ndë pacinë Vllehetë një të tillë mendie s`mund ta nxjerrinë në krye, as s`mund ta bënjënë dot, sepse kanë ndë mest Bullgarin` e Maqedhoninë, që ndan Rumaninë nga Shqipëria, përandaj s`kam ndonjë frikë nga Rumunëtë, sa kam nga Grekëtë që janë fëqinjë me Shqipërinë, edhe po përpiqenë me nat` e me ditë qysh t`i bënjënë për vete.

Po e mbyll brenda në kartët adresënë t`ime qysh të më shkruani, edhe të ma dërgoni kartënë me anë të Trieshtesë nga Austria me udhë të hekurit edhe m`u përgjigj pa menuarë kohënë që poqe për t`ardhurë ndë Bukuresht, të bënem gati e të vinj e ndë mos, të më shkruani shpejt, që të vështronj punën time.

Të falem me shëndet e të përqafonj vëllazërisht. U falem me shëndet gjithë vëllezërët që gjendenë në Bukuresht

Un` i dashuri miku juaj
Kostandin Kristoforidhi
Elbasanasi

IN MEMORIAM

KADRIJE KADARE DHE DY DASHURITË E SAJ

nga Bujar Hudhri

Ishte prill i vitit 1996. Kisha shkuar në aeroport me tim vëlla Feridin për të pritur Kadarenë dhe zonjën e tij, Helenën. Nga takimi i parë nuk kishin kaluar as gjashtë muaj, ndaj prania e Feridit më jepte njëfarë sigurie. Si hipëm në makinë, në pasqyrëzën e brendshme shihja portretin e qeshur të Kadaresë, çka më jepte disi prehje. Po kujtonin ngjarje dhe njerëz kur ishin në Lidhjen e Shkrimtarëve. Aq e shkurtër m'u duk rruga deri në shtëpinë e tij, sa më erdhi keq se do të ndaheshim, kur ai, në vend që të përshëndetej, tha prerazi:

- Ngjituni lart të dy. Por nuk po ju ftoj për drekë, ta keni të qartë, - na siguroi duke qeshur.

Pasi parkuam makinën te Hotel Tirana, nuk vonuam dhe drejt e tek apartamenti i tij. Derën na e hapi gjithë bezdi një grua që s'e kisha parë ndonjëherë. Është Kakuja, e motra, më tha Feridi, ndërsa u ulëm në kolltukët e dhomës së pritjes. Hera e dytë që ndodhesha në atë vend. Nxora nga çanta nja pesë kopje të librit të "Dialog me Alain Bosquet", që sapo e kisha shtypur në Itali. Po prisnim të vinte Kadareja, kur dëgjoj nga dera gjysmë e hapur zërin e Kakusë:

- Po këta, me vrap erdhën, nuk u pritej deri nesër!

Ka kaluar mbi çerek shekulli dhe nuk e harroj kurrë se si u ndjeva në ato çaste. Më duket sikur më djegin faqet edhe sot e kësaj dite nga turpi. Por do të kalonin shumë vite ta kuptoja domethënien e sjelljes së Kakusë.

Takimet me Kakunë ishin të rralla (ajo punonte në redaksinë e gazetës "Shekulli"), vetëm në promovime apo panairi libri. Por e solli rasti që të bënim një udhëtim të gjatë deri në Gjirokastër. Ishte janar i vitit 2001. Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, zoti Ylli Asllani, na kishte ftuar në një ceremoni me rastin e 65-vjetorit të lindjes së Kadaresë. E lamë me Kakunë të niseshim herët në mëngjes, sepse na priste një rrugë e gjatë dhe e vështirë. Kur iu afruam Lushnjës, ndalova makinën pranë një restoranti dhe i thashë Kakusë që të zbriste. Ndërkohë ajo hapi një qese me byreçka, djathë, ëmbëlsira dhe e vuri në prehër.

- Uh, çfarë restoranti! - foli gati me zemërim. -Vetëm për të harxhuar paratë janë e prapë të merr uria, - vazhdoi. -Shko ti, po të pres këtu.

U ula i vetëm në restorant, por po më dukej sikur po i fshihesha Kakusë. (Që nga ky rast, me shaka u them të tjerëve se si mund ta përfytyronim një restorant sipas Kakusë. Ti hyn brenda, ndërsa ti ulesh, të rrethojnë kamerierët gjithë gëzim, të ofrojnë çfarë të duash dhe në fund, bakshishin nuk e jep ti, por ata, madje, të luten se ndryshe do ta ndienin veten keq. Ia thosha herë pas here këtë kur uleshim në bar apo restorante dhe fytyrës së saj nuk i lëvizte sikur një muskul.)

Kur po i afroheshim Gjirokastrës, m'u lut të ndalonim. Zbriti, hipi në ndenjësen prapa dhe më tha me të qeshur:

- Tani shiko drejt, mos kthe kokën mbrapa, se do të bëj striptizë!

Kur ndaluam pranë sheshit të Çerçizit, shikoj një Kaku tjetër. Një zonjë e vërtetë! Dhe në ndenjësen pranë një pirg me triko, bluza, xhaketa, shall. Ngaqë mëngjesi kishte qenë i ftohtë, ishte veshur e ngjeshur mirë.

Ishte një ditë e bukur, ndaj iu luta të më tregonte shtëpinë ku kishte lindur. Morëm rrugën të heshtur, por nën vështrimin e shumë kalimtarëve apo shitësve që rrinin në dyert e shitoreve. Po u afroheshim shtëpisë së Kadarenjve. Megjithëse e dëmtuar nga zjarri që kishte rënë kohë më parë, dukej madhështore nga larg. S'mbahet mend që kur s'kam ardhur këtu, më tha kur e pyeta se kur ka qenë hera e fundit. Befas fytyrës i kishte rënë një tis mallëngjimi. Gati përballë shtëpisë ishte një portë e madhe ku në dy gurë të mëdhenj anash ishin ulur dy gra. Njëra po thoshte: moj, si Kadrija më duket. Kurse Kakuja kokën drejt, as majtas as djathtas, nuk u hodhi sytë. Njëra prej tyre mori guximin, nxitoi të na priste rrugën dhe i doli përpara me një fytyrë ku mund të shihej qartë gëzimi:

- Moj, mos je Kakuja ti?

- Jo, - i tha Kakuja ftohtë. - Kush je ti?

- Po ti moj, Kakuja, je. Nuk më mban mend? Mamaja jote na jepte gjithnjë bukë kur dilnim e luanim në oborr.

- A, ashtu? Mirë jeni?

Nuk po u besoja veshëve. Asnjë shenjë mallëngjimi. Tronditjeje. Çfarë vetëpërmbajtje! Tmerr! U ndamë pa folur, tani ishim te porta e shtëpisë.

- E shikon atë shtyllë elektriku? Me llambën e rrugës lexoja libra natën. Na e fiknin dritën prindërit, mos harxhonim!

(Kur vite më vonë, në prani të Kakusë, ia tregova një herë Kadaresë, ai me një ton tallës i tha: "Po kur të duket edhe ty vetja e rëndësishme. Pika!" Ndërsa Kakuja, gjithë duke u vetëmbrojtur, me sy gati do t'ia shkrepte të qarit, ia ktheu: "Po ç'bëra, mo?")

Pasdite u zhvillua një ceremoni për dhënien e titullit "Nderi i Gjirokastrës" Kadaresë, Musine Kokalarit dhe Eqrem Çabejt. Sa herë na afroheshin kamerat, Kakuja ia niste gjithë: bobo, ja do të më shohë Ismaili! Do të më bërtasë! (Tani që po i shkruaj këto radhë, e ndiej se sa dashuri kishte për vëllain e saj të shquar, por që për të tjerë kjo është së prapthi po t'i lexosh fjalët normalisht.)

Se sa dashuri kishte ajo për Kadarenë arrita ta kuptoja mirë, sidomos kur Kakuja filloi punën në redaksinë e "Onufrit". Pas një bashkëpunimi të çmuar në botimin e veprës së plotë të Kadaresë, m'u duk fare e natyrshme ta kishim në staf. Aq më tepër kur kishte një përvojë të gjatë si redaktore, por, kryesorja, ishte një grua e kulturuar dhe kishte një dashuri dhe adhurim të çmendur për librat. Recitonte vargje të tëra nga "Onjegini", vargje të Eseninit, Kadaresë, Agollit. Dinte të fliste bukur për çdo libër, për çdo personazh romani. Sepse jeta e saj kishte qenë vetëm libra. Ndaj ishte fat për një redaksi të kishte një punonjëse të tillë. Përveç kësaj, duke gjykuar moshën dhe shëndetin e saj, më dukej se për të ishte një prehja pas kaq vitesh punë sfilitëse nëpër redaksitë e gazetave qendrore. Por Kakuja nuk mund të ndahej dot nga gazetat. Kurioziteti i saj dhe dëshira për të qenë në këto mjedise ku ajo të sfidonte me aftësitë e saj kolegët ishte shumë e qartë për mua. Sidomos kur mora vesh se ndërkohë që punonte te ne ishte korrektore edhe në dy gazeta të tjera. Nuk e besova në fillim dhe gjithë dyshim i thashë: po si ia del të punosh pa pushim? Nuk pranoi asgjë. Kurrë nuk mund ta kuptoje se po thoshte ose jo të vërtetën. Aq vetëpërmbajtje kishte. Të nesërmen kishte lënë një letër, ku më kërkonte ndjesë dhe jepte dorëheqjen. O Zot, sa m'u dhimbs! I thashë të vinte në zyrë dhe me një ton dashamirës iu drejtova:

- Ç'më çan kokën, o Kaku? Pse kërkon të më mbushësh mendjen? Ti je e lirë pas pune të shkosh e të punosh ku ti dëshiron. Madje, si të mbarosh punën, mund të shkosh edhe të bësh striptizë! - shtova për ta zhdramatizuar situatën.

Por, sikundër e kuptova më vonë, ajo e bënte këtë për të marrë vesh se ç'thuhej, ç'do të shkruhej për Kadarenë. Kanë qenë kohë kur shtypi merrej shumë me jetën e Kadaresë dhe Kakuja e vuante shumë. Vetëm për këtë jetonte dhe kishte aq energji dhe shpirt luftarak sa nuk ia dilje dot ta frenoje. Kam pasur rastin ta shoh këtë që shkruaj kur në zyrë erdhi një zonjë, vajza e një përkthyesi të madh, dhe nënshkruam kontratë botimi. Për ta festuar, e ftova edhe Kakunë në restorantin përballë zyrave. Sapo Kakuja dëgjoi mbiemrin e zonjës, u sigurua se ç'lidhje kishte me një person që shkruante kundër Kadaresë vazhdimisht veç kur filloi e s'dinte të mbaronte. U krijua një situatë e rëndë. I lutesha të ndalonte, por kjo sikur e përndizte më keq. Zonja përballë vetëm buzëqeshte me atë fytyrën e saj të bukur dhe e shihte në sy Kakunë. Nuk e ndaloja dot. Si një lodër që bën zhurmë të tmerrshme, por nuk e ndalon dot po nuk i hoqe bateritë.

Ishte dashuria e saj për vëllain e famshëm! Jetonte vetëm për ta dëshmuar në çdo rast. Kaq e thjeshtë është.

E kam kuptuar me kohë këtë ndjenjë të bukur dashuri motre për vëllain, gjithë këto vite. Po sa e mezidukshme për të tjerët mund të ishte kjo. Dhe vërtet, si mund ta kuptosh në këto dy raste:

Ai sapo ka mbërritur pas gjashtë muajsh nga Franca dhe ajo si e trembur para tij.

- Hë, ç'kemi? (E pyet ai, as dorë, as përqafim.)

- Hiç, - përgjigjja e saj si një zog i trembur.

Apo kur nisej Kadareja për në Paris. Makina ka ndaluar përballë Sky Tower ku ka apartamentin. Sigurohem që dyert janë mbyllur dhe ndërsa hap derën për të ngarë makinën, pak më tutje shoh portretin e trishtuar, të dhembshur, të motrës. Nuk mundem t'i harroj këto çaste që përsëriteshin dy apo tri herë, çdo vit.

Ndërsa vendoseshin kurorat mbi varrin e Kakusë, s'di pse befas në kokë erdhi një mendim që e kisha pasur mbase brenda vetes përherë. Jetoi në këtë botë vetëm për dy dashuri të mëdha, të padyshimta, të përjetshme: për vëllain e saj të famshëm dhe për librat!

KA NJË PJERRËSI TË ÇUDITSHME DRITA

cikël me poezi nga poetesha të mëdha

Përktheu Roland Gjoza

Gwendolyn Brooks

NËNA

Nuk mund t'i harroj dështimet
Kujtoj foshnjat që erdhën në jetë, po në të vërtetë nuk erdhën
Ato mishra imcak, të qullur, tullac ose me pak flokë
Kengetarë apo punëtorë që nuk provuan kurrë të thithnin ajër
Nuk mund t'i le rrugëve, apo t'i rrah
Ose të hesht, ose t'iu blej një ëmbëlsirë
Nuk mund të ul gishtin e madh para tyre
Ose të zhduk fantazmat kur iu shfaqen
S'kam si t'i le të përgjojnë psherëtimat e mia të mëdha
Ose të ha diçka me ta me syrin e nënës llupëse

Kam dëgjuar në zërat e erës zerat e fëmijëve të mi të vrarë
Kam folur me ta. Dhe jam lehtësuar.
Kolopuçët e mi të zbehtë nuk mund të pinin më gji,
Iu kam thënë; shpirtrat e mi, nëse kam mëkatuar, nëse kam penguar fatin tuaj
Nëse kam vjedhur lindjet, emrat tuaj
Lotët aq të dëlirë të foshnjës, lojërat tuaja
Pasionet e zjarrta, dashuritë romantike, tërbimet e papritura, dhembjet,
vdekjet tuaja,
Nëse kam helmuar frymëmarrjen tuaj
Besomëni, edhe në qëllimin tim kam qenë e paqëllimshme.
Edhe pse duhet të ankohem, të akuzoj
Kuptojeni këtë, se krimi ishte i tjetërkujt, jo imi
Megjithatë ju keni vdekur.
Ose më qartë, mund të them, se ju nuk u bëtë,
Kurrë, kurrë dhe për këtë kam shumë frikë.
Është krim! Oh, ç›farë të them tjetër, si duhet thënë e vërteta?

Ju keni lindur, keni patur trup, keni vdekur.
Thjeshtë nuk keni qeshur, nuk keni bëlbëzuar, nuk keni qarë.

Më besoni, të gjithëve ju kam dashur
Më besoni, edhe pse ju kam njohur fare pak, ju kam dashur, ju kam dashur
Të gjithëve

Emily Dickinson

KA NJË PJERRËSI TË ÇUDITSHME DRITA

Ka një pjerrësi të çuditshme drita
Pasditeve dimërore
Të shtypin në shpirt katedralet
Tingujt në kumbanore

Dhembje qiellore sjellin për ne
Por ato s'lënë shenja askund
Dallimi është i brendshëm, i thellë
Aty ku rrinë kuptimet, në fund

Askush s'mund ta thotë aq qartë
Se si e zë trishtimi, vaji
Se si kjo vuajtje perandorake
Vjen nga lart, nga ajri

Dhe kur vjen, natyra mban vesh
Shtang, s'merr frymë as hija
Kur ikën, si vdekja e zbehtë
Ka pamjen largësia

Mary Oliver

SINGAPOR

Në Singapor, në aeroport
Një skenë të trishte panë sytë e mi
Në banjën e grave, një derë wc-je ishte e hapur
Një grua e përkulur po lante diçka në gropën prej porcelani të bardhë

M'u përzje në stomak
Ndieva në xhep biletën e udhëtimit.

Në një poezi duhet të ketë gjithmonë zogj
Fajkoj, bie fjala, me sy të guximshëm dhe krahë të fuqishëm.
Lumenj magjepsës dhe pemë gjithashtu
Një ujëvarë, dhe nëse kjo s'është e mundur, një shatërvan me ujin që ngrihet lart dhe bie me fiskajë
Sepse gjithmonë dikush dëshiron të qëndrojë në një vend të lumtur, në një poezi.
Kur gruaja u kthye nga unë, nuk mund t'i përgjigjesha shprehjes së fytyrës së saj
Bukuria dhe turpi ishin përzierë bashkë në një mimikë të ngrirë
Dhe të dyja binin shumë në sy, pa bërë dallim.
Ajo buzëqeshi dhe unë buzëqesha. S'kishte gjë më absurde!
Natyrisht të gjithë përpiqen të gjejnë një punë.

Ndërsa dikush dëshiron të qëndrojë gjithmonë në një vend të lumtur, në një poezi
Kjo grua i kushtohet me mish e me shpirt një pune të rëndomtë, që është tejet e mërzitshme
Tani po pastron hirnoret e cigareve, tavllat e mëdha si disqe makinash
Me një leckë blu
Duart e saj të vogla kthejnë kapakët përmbys, i lajnë dhe i fshijnë
Ajo nuk punon ngadalë, po as shpejt, si një lumë
Flokët e saj të zinj janë si krahë zogu

Nuk dyshoj për asnjë çast nëse ajo e do jetën e saj
Unë dëshiroj që ajo të ngrihet mbi zhulin dhe llumin dhe të fluturojë tutje mbi lumë
Kjo s'mund të ndodhë
Por edhe mund!
Nëse bota do të ishte vetëm dhembje dhe arsyetim, kush do ta donte atë kaq shumë?

Sigurisht s'ka si të jetë kështu
Jo, as që dua të besoj te mrekullitë, por mund të them se
Dhe nga një jetë mund të shkrepëtijë drita. Dhe këtë e shikoj
Te ato dy duar, te mënyra se si e shpalosin dhe e palosin atë leckë blu,
Te mënyra se si buzëqeshja e saj ndriçoi për shkakun tim
Te mënyra se si kjo poezi u mbush me pemë dhe zogj





Edna St. Vincent Millay

MË KUJTOHET

Ishim shumë të lodhur, ishim shumë të gëzuar
Kishim lundruar gjithë natën me traget
Ai ishte i zbrazët dhe plot dritë, por mbante erë stallë
Pamë një zjarr diku, u mbështetëm në një tryezë
U shtrimë në majë të një kodre nën dritën e hënës
Dhe bilbilat këndonin dhe agsholi erdhi shpejt

Ishim shumë të lodhur, ishim shumë të gëzuar
Kishim lundruar gjithë natën me traget
Dhe ti hëngre një mollë dhe unë hëngra një dardhë
Nga një dyzinë që kishim blerë të dy
Dhe qielli u zbeh dhe era u bë e ftohtë
Dhe dielli u ngrit duke derdhur një kovë flori

Ishim shumë të lodhur, ishim shumë të gëzuar
Kishim lundruar gjithë natën me traget
I thamë; "Mirëmëngjes, nënë!"një koke të mbuluar me shall të zi
Dhe i bleva gazetën e mëngjesit, po nuk e lexuam as unë, as ti
Dhe ajo qau; "Zoti ju bekoftë!" për dardhat dhe mollët
Dhe për gjithe paratë që i dhamë, madje dhe qindarkat e fundit
Që i ruanim për biletat e metrosë

Nelly Suchs

VDEKJE, UNË JAM E BARDHË NGA MALLI PËR TY

Vdekje, unë jam e bardhë nga malli për ty
përtej dritës tënde të fundit që vdes
duke derdhur çdo pikë gjaku në çastin e hiçit tënd
këtej e tutje zbulimi i mungesës së jetës tek ty-
Ringjallja

Elizabeth Bishop

ARTI I HUMBJES

Arti i humbjes nuk është i vështirë per t'u mësuar
shumë gjëra të menduara me një qëllim të caktuar
mund të humbasin dhe humbja e tyre nuk është një fatkeqësi

Humb diçka çdo ditë. Tronditshëm prano
humbjen e çelësave të deres, orën e harxhuar për dreq
Arti i humbjes nuk është i vështirë për t'u mësuar

Pastaj praktiko humbjen që do vijë, humbjen më të shpejtë
vendet dhe emrat, atje ku ke ndërmend
për të udhëtuar. Arti i humbjes nuk është i vështirë për t'u mësuar

Kam humbur orën e nënës. Dhe ç›ndodhi? Veç kësaj
dhe disa humbje pas saj; tri shtëpitë e dashura që shkuan
Arti i humbjes nuk është i vështirë për t'u mësuar.

Kam humbur dy qytete, o, ç›dashuri që shkoi! Po dhe të tjera,
disa perandori që unë i zotëroja, dy lumenj, një kontinent
kam humbur, por kjo nuk është një fatkeqësi.

Edhe duke të humbur ty, (shakatë, gjestet e tua,
Të dua!) kurrë s'të kam gënjyer. Është e qartë gjithsesi
Arti i humbjes nuk është i vështirë për t'u mësuar
Megjithëse duket (mos e harro këtë!) si një fatkeqësi

Amy Lowell

DHURATË

E ndjen? Jam jotja përgjithmonë, i dashur!
Fjalët e mia janë si poçe të vogla
Që ti mund t'i marrësh dhe t'i vendosësh nëpër rafte.
Format e tyre janë të çuditshme dhe te bukura
Me shume ngjyra te kendshme dhe reflekse magjike
Je i lutur që me kujdes t'i ruash.
Aroma e tyre do ta mbushë dhomën
Me ëmbëlsinë e luleve dhe të barishteve të shtypura.
Kur unë do të jap poçen e fundit
Ti do të më kesh mua të plotë e të pacënuar
Por unë ndërkaq do të kem vdekur

Alda Merini

FLUTURA TË LIRA

Oh, gra të varfëra dhe të vetmuara
të dhunuara nga ata
që nuk ju njohën.
gra me duar
në foshnjëri.
Sekrete të ëmbla
dashurish mbani mend
me të cilat
babëzia juaj natyrale
nuk do të ngopej kurrë.
Do të hani dhe pluhur
do të përpiqeni të çmendeni
por nuk do t'ia arrini,
do ruani fillin e arsyes
që do t'ju ndajë
më dysh.
Nga këto thellësi
plagësh
do të çliroheni
flutura të lira.



PAS PERDES

poezi nga Virion Graçi

DY NJERËZ

Vazhdova rrugën pa të dashurën.
Pemët më binin mbi supe
Gurët kilometrikë
Më bënin shenjë të vazhdoja .

Vazhdova. Diku pashë një urë
E hedhur tejpërtej mbi greminë
Aty poshtë, në fundin e saj të frikshëm
Midis gurëve të mbushur myshk e hije
E dashura ime mbillte trëndafila.

U hodha. Ngeca në ajër. I lodhur.

KTHESA

Fytyra jote shfaqet përkohësisht
Në pastërtinë e përkohëshme të xhamave.

Pastaj tretet në ngjyrat e errëta të perdeve
Dhe në tingujt e gëzuar të muzikës.

Fytyra jote e përkohëshme shfaqet përjetësisht
Në pastërtinë e përkohëshme të xhamave.

ORA

E shtrirë më zgjat e bindur
Gjuhët e tua të zjarrta.
Dhe ngelem pa dashuri
Dhe ngelem pa të ardhme.

Naive përgjunjesh, zbulohesh
Pastaj marr gërshërët e ndryshkura
Trurit tim të lodhur
Flokët e shumtë i'a qeth.

PAMJE NGA AFËR

Mundohu të flesh
Asnjë fill ironie mos kërko
Në zërin tim. Pa provoje një herë.

Një gjysmë hëne
Ose diçka e përafërt me qiellin
Një bari i lagur
Ose diçka e përafërt me diellin
Një krah i prerë
Ose diçka e ngjashme me kolltukun.
Një njeri
Ose diçka e ngjashme me njeriun.

Mundohu të pushtohesh
Nga diçka e përafërt me gjumin polar.

GRAVITET
Si tretet dalëngadalë njeriu
Vëllai im nga gjaku
Motra ime nga shpirti
Si tretet dalëngadalë, si humbet nën tokë
Në ulluqe të sajuar me gjethe të kruspullosura
Nga shterpësia dhe padurimi
Tani mbi tokë ndërroi moti
Ndryshuan modelet e veshjeve.

Si tretet me pa të keq imazhi yt
Planimetria e një krijese tepër e hijshme
Planimetria e një krijese të mbështetur
Mbi dy këmbë të bardha, të plota, të bukura
Si tretet ngadalë kujtimi yt
aroma e një trupi cicërues
Lëkura e pastër prej glukoze dhe zjarri.
Imazhi i një trupi të kredhur pambarim
Në një tretësirë me formulë të padeshifrueshme.

TROTUAR

Përfytyroje pa kuaj karrocierin
Pa karrocën me stoli antike
Pa veshjen e tendës mbuluese
Tendosur nga shufra të harkuara.

Përfytyroje pa burinë karrocierin
Pa karrocën me stoli antike
Pa veshjen e tendës mbuluese
Tendosur nga shufra të harkuara.

Përfytyroje pa ndenjësen, pa kamzhikun fshikullues
Pa çiftin e lumtur mbrapa karrocierit
Pa femrën veshur në të bardha
Pa burrin që qesh si klloun.

Përfytyroje pa korteun e përzishëm
Pa të afërmit me kostume të errësuara
Pa shpirtërat e braktisur nga shpresa
Që kalërojnë në heshtje mbas kuajve.

Përfytyrimin çoje në shekullin e nesërm
Dhe jepja të drejtat e autorit
Rapsodit të verbër me harpë.

HEROI

Prangat prej bronxi dikur
Të folën aq bukur për lirinë

Liria ishte atëherë
Send prej zjarri
Që i mungonte dhomës tënde prej druri.

Kur të folën sërish për të
ishe ndarë me dhimbje bronxi
Nga prangat e ngrohta prej nervi e mishi.

Dhe t'u duk liria një send prej druri
Që i mungonte dhomës tënde prej zjarri.

PAS PERDES

Mungon ngjyra në kurmin e saj.
Nuancat mungojnë. Transparencë e padurueshme.
Ftohtë. Shumë ftohtë. E kap-dhe mjetet kapëse
Dukshëm fillojnë ta humbasin ngjyrën. E pushton
Dhe mjetet pushtuese fitojnë transparencë.
Përzihesh keqas me të dhe bëhesh i padukshëm.
Derdhet vetiu në bronx
Vjedhësi i ngjyrës dhe i flakës.

PAMJE NGA LARG

Dalë-ngadalë
Në oborr do të bien gjethet e pemës
Do të dalë një mace në faqen e çatisë
Një karrocë e vjetër do të shkasë në kalldrëm
Pijanecët prapë do të grinden nën strehë
Një kockë e thyer do të zbardhë diku
Dy prindër do të qortojnë fëmijën e tyre.
Një qivur do të dalë prej portës më tej
Dielli do të shkojë drejt perëndimit
kokën tënde të kaltër, të këputur
Do ta mbash në prehër.

Diçka do të kujtosh
Dalë-ngadalë do të shuhesh edhe ti
Ndofta prej gëzimit.

DRITAT

Nuk të harroj dot
Më tha një grua e panjohur
Në shitoren gjigande të perimeve
E kam seriozisht
Kurrë, kurrën e kurrës
Nuk do të kem fuqi të të harroj
Vazhdoi gruaja e panjohur

Si i shurdhët u zhvendosa më tej
Në këndin e lakrave mesdhetare
Duke zgjedhur me ankth amvise
Barishte të njoma.

Me një aromë të mirë, pa emër e ngjyrë
Duke thithur sirena autoambulancash
Më shkoi fundjava e jetës.

PËRSHËNDETJE

Në cilën anë të lumit
Të të pres?

Kur do ta përsërisësh saktësisht
Hijen time mbi tokë?

Po zërin tim? Po qeshjen time?

Flas për ty vazhdimisht
Dhe harroj të firmos
Emrin tim sipër epitafit.

KREMTIME

Fëmijët e varfër kërcejnë
Lozin e qeshin me njëri-tjetrin

Dalin zbathur nëpër dëborë
Kurrë nuk i thyejnë degët e bredhave
As për zbukurime festash.

Me pak baltë mbulohen
Kur vdesin papritur fëmijët e varfër
Nëpër zgavrat e tokës humbasin të tretur
Bashkë me shkëlqimin e përkohshëm të krishtlindjeve

TAKIMI

Pasi doli nga kulla i hypi kalit
Pasi i hypi kalit u largua nga kulla
Pasi u largua nga kulla i'u afrua lumit
Pasi u takua me lumin ajo i mbajti frerin kalit
Pasi i mbajti frerin kalit zbriti në zallin e nxehtë
Pasi zbriti në zallin e nxehtë
Kërkoi me sy një vend të fshehtë
Pasi e gjeti vendin e fshehtë
Filloi të zhvishej
Pasi u zhvesh plotësisht
Ajo kërkoi rrobat e banjos
Pasi kërki rrobat e banjos
U kujtua se nuk i kish marrë me vete
Pasi u kujtua se nuk i kish marrë me vete
Nxitoi të fshihej në kallamishtë
Pasi u fsheh në kallamishtë
Lumi ngriti valë e shkumë
Pasi lumi ngriti valë e shkumë
S'u dukëm më as kallamat, as ime zonjë
Pasi s'u duk më ime zonjë në kallamat e përmbytur
Unë u ktheva pa hingëllima për në kullë.

LULE TË VERDHA

Kam përpara pesë filozofë
Prej nga do zgjedh katër libra
T'ia dërgoj një vajze.

Kam përpara gotën me çaj
Ku do ta tres sheqerin për tre sekonda
E ta rrufis për dy minuta

Kam përpara një dimër
Zero netë polare
Dhe minus
Një ditë të zakonshme vere.

URA

Do të vish e dashur, do të vish
Prandaj sonte s'dëgjohen të lehura
Shiu bie butësisht mbi statujat
Rrëketë e ujit lagin të vdekurit
Prandaj dremisin raftet e kuzhinës
Palosen përgjithmonë fletët e librave
Dridhet përvajshëm pema e Krishtlindjeve
Rrëketë e ujit lagin të vdekurit
Prandaj kuisin uqërit nëpër pyje
Zemërohen ortekët në rrugën e tyre
Vetvaren lypsarët në gardhin e kishës
Rrëketë e ujit lagin të vdekurit
Prandaj përgjaken uniformat e ushtarëve
lulëzojnë gjithandej sfilatat e veshjeve
Përcillet ngado një heshtje zhurmuese
Rrëketë e ujit lagin të vdekurit
Shiu bie butësisht mbi trupat tanë.
Do të vish, e dashur, do të vish.

LUMI PA BRIGJE

Dëbora sivjet vonoi.
U lodhën fëmijët së prituri në oborr
U lodh zemra ime së prituri në gjoks
Dridhej, sëmbonte, lëngonte.E gjora.

Ja më në fund, filloi
Flutura të bardha binin si pudër
Në profilet e hirta të maleve
Në sallatën jeshile, mbi bukën e gjellën
Servirur në bujtinën e varfër.

Pak trimëri
Pak mirësjellje
Pak aspirinë. Pak melankoli
O miq. Vonoi tej mase
Rënia e dëborës sivjet
Dhe ju gjeti juve anës xhadeve
Në shtylla elektriku-izolatorë të ndershëm
Më gjeti mua pa zemrën time
Kur po prisja me gërshërë
Thonjtë e ariut fotograf.

AI DHE AJO

Me mëkataren anonime për dore
Për çudinë time sidomos
Gjetëm plot hije të freskëta
Stola druri të stolisur
Shatërvanë të qarkuar
Me dafina, mimoza, zambakë.

Me mëkataren e panjohur përkrah
Për çudinë e saj sidomos
Gjetëm mjaft mjete udhëtimi
Anije, trena, karroca.

Për çudinë tonë të përbashkët-atje tej
Një djalë i hollë, i trishtë e i gjatë
Pjek në furrë çupëza prej balte të zgjedhur

KËNGË E HARRUAR

Kujton se është një fshat piktoresk
Atje ku korrin bar, ku mbjellin pemë frutore
Atje ku qajnë me zë për të vdekurit e tyre
Atje ku i këndohet me hare dashurisë.

Dyshoj se ka ironi
Midis pikave të të njëjtit ujë
Midis kanatave të së njëjtës derë
Midis syve të të njëjtit njeri.

(1990-1991)

"KUSH RRON DUKE SHPRESUAR..."

Tregim nga Ramadan M. Pasmaçiu

Atë e prunë në spital natën. Me autoambulancën e urgjencës. Gjetën një krevat të lirë pranë meje dhe e shtruan aty. Ishte me temperaturë dhe rënkonte lehtë. Gjer në mëngjes nuk mbylla sy as unë. U ngrita dhe nisa t'i sillesha rrotull, pa ditur si t'i vija në ndihmë. Dy herë shkova dhe thirra infermieren.

Herën e parë ajo m'u përgjigj me të qeshur:

- Uh, hahahaaa! Mos kij merak, se ia lexova anamnezën! As ndonjë gjë që të dhemb fort s'ka, e as ndonjë gjë me rrezik! Por, duket, qenka tip zevzek! Do e bën gurgulenë! Shko e këputja gjumit ti! Atë bëj!

Herën e dytë infermierja m'u përgjigj e nxehur:

- E di që po më mërzit shumë? Nuk dëgjove ç'të thashë qëparë!? Hajt, shko e fli tani dhe lëmë edhe mua t'i pulit pak qepallat!

Kur zbardhi dita, i sëmuri i ardhur rishtas sikur u qetësua.

Kishte ballë të gjerë anëve dhe flokë të thinjur me onde. Fytyra e tregonte të mbajtur. E lëmuar, thuajse pa asnjë rrudhë. Sytë - të mëdhenj, të kaltër. Ishte i afrueshëm, i sinqertë. Fliste me një zë të butë, të urtë.

- Ju lashë pa gjumë edhe juve, të thuash të vërtetën! - më tha me keqardhje. - Më falni shumë!

- Ç'është ajo! - ia ktheva buzagaz. - Nga qejfi s'rënkon njeriu!

Më tregoi si me turp shqetësimin e tij.

I paskësh dalë qysh dy - tri javë më parë një si puçër e kuqe, e vockël, tepër e vockël, poshtë, te testikula e majtë, po nuk i kishte dhënë rëndësi. Më tej, ditë pas dite, ajo i qenkësh zmadhuar, i digjte e i përvëlonte. I jepte dhimbje, që i ngërthenin tërë pjesën e fundit të barkut. Pati provuar lloj - lloj melhemrash, por më kot! E kish lyer me jodio, alkool, pudër, të verdhë veze të skuqur, rifocinë, gjer edhe i kishte vënë sipër qepë e sapun, me shpresë se mos i shërohej, por përsëri kot!

Tunda kokën. "Ç'bën injoranca! - thashë me vete. - E kërkon ndihmën e mjekësisë, kur e sheh që nuk ka nga t'ia mbajë! Dhe jo si njerëzit me shkollë, që sulen te mjeku me shqetësimin e parë!" Po ç'faj kish i ziu, në ishte njeri i pashkolluar! Nga t'ia dije rrethanat jetësore, që e kishin lënë të atillë!

Në këto e sipër më erdhi keq për të dhe kërkova të merrja me mend se cili ish profesioni i tij. Herë më ngjante si berber, herë si kamerier, si banakier... Por, nga berberi anonte më shumë, gjersa ishte gjithnjë i rruar dhe fliste me mirësjellje. Kush e ka mirësjelljen e berberëve! A nuk të lodhin, kur të rruajnë a të qethin, me njëqind pyetje! Si i keni nga shtëpia? Si shkoni me punë? Si ashtu e si kështu? Dhe s'e reshtin atë buzëqeshjen e shpëlarë fillim e mbarim!

- Si nuk shkove menjëherë te doktori, or burrë i dheut!? - e pyeta serioz.

Ai, përsëri si inferior para meje, se sigurisht e ndiente se kishte të bënte me një djalë të arsimuar e jo me një si veten, m'u përgjigj ëmbël - ëmbël:

- Më vinte edhe një çikë zor, të thuash të vërtetën, se është në vend ters puçra e uruar!

- Gabim! - i dhashë mend unë. - Burra jemi, s'jemi gra! Edhe gratë, tek e fundit, kur kanë sikletet e tyre, pa doktorë s'bëjnë dot!

- Po, po! Ashtu është! Ndaj shkova në ambulancën e lagjes, të thuash të vërtetën, veç para katër - pesë ditësh, ama, si m'u mblodh keq.

- Aaaa! Vonë! Shumë vonë!

- Vërtet, djalë! Eee, ku e pata fjalën? Më dhanë ca gjilpëra atje, po hiç, një vërë në ujë, të thuash të vërtetën! Kësisoj, u katandisa të thërrisja në shtëpi urgjencën. Dhe ja, tek më sollën këtu, në kirurgji! Tani të shohim! Vëntë dorë natyra, se, të thuash të vërtetën, frikë të madhe kam! Ja, kështu, djalë!

- Shtyje frikën tutje, - i thashë, - se s'ka sëmundje pa ilaç! Tani je në duar të doktorëve! Apo s'janë shpuzë këta të kirurgjisë! Artistë fare janë! Atë që ke ti s'e kanë për gjë! Ta dish prej meje! Çrëk - frëk do të të shërojnë! Dëgjon? Dhe kij besim më shumë! Po më bëjnë njeri mua, që erdha në spital me një këmbë në varr! - Desha t'i tregoja diçka për vete, që ta qetësoja mirë, t'i jepja zemër, po s'arrita. Hyri papritur mjeku i dhomës, një kirurg djalosh, i gjatë e trupngjeshur, që ta mbushte syrin.

- Mirëmëngjesi! - na tha të dyve dhe iu drejtua atij: - Hë, profesor, si u gdhitë?

- Ja, mo, Berti djali, të thuash të vërtetën, - iu përgjigj ai, - s'kam fjetur gjithë natën! Ç'qe kjo që më zuri!?

- Oooo, ju lutem! - buzëqeshi kirurgu. - Ju të flisni kështu!? Kaq me pesimizëm!? Ju që na keni mësuar!? E përse? Për ca punë çikërrimash!

Dhe vazhdoi t'i thoshte se së shpejti do të bindej që gjithçka do të kalonte për bukuri. Qysh atë mëngjes do t'i bënin ca analiza, por do t'i fillonin paraprakisht edhe njëfarë mjekimi. Ai pa orën.

- Ja, pas pak, do të jemi këtu për konsultë tërë mjekët e pavionit.

Kur mbetëm vetëm, si mora vesh i befasuar se pranë meje ishte profesori e jo i pashkolluari, berberi, kamerieri a banakieri, që të mos dukesha i pagdhendur, e ndryshova menjëherë formën e komunikimit. I tregova emrin e mbiemrin. Nisa t'i flisja me "ju". I tregova ç'punë bëja e nga se vuaja. Dhe ai më tha se e quanin Sotiraq, se ishte pedagog në Shkencat e Natyrës, e të tjera, e të tjera.

- E keni titullin profesor, besoj!

- E kam, e çë! Ç'peshë ngre titulli! Puçra, kur do, të del atje tek s'thuhet, qofsh makar president i Amerikës!

Unë nuk qesha. E vështrova i heshtur, i menduar. Profesori shtoi se merrte vesh nga ato soje puçrash, s'ishte profan, ndaj qe i shqetësuar. Ca më tepër, që s'i kishin bërë efekt turli mjekimesh në shtëpi!

- Ja, kjo është! Së paku, gjer tani s'më ka dhënë të kuptoj gjëra të mira. Për më pas nuk di ç'të them! S'dal dot mbi natyrën, të thuash të vërtetën!

Këtë shprehje e përdorte shpesh, veç si rrjedhë logjike të atyre që thoshte. Ndaj ajo nuk m'i vriste veshët dhe ai nuk bëhej i rëndë në bisedë. Përkundrazi! Mbetej tërheqës.

Mjekët i morën dy - tri herë gjak për analizë, i morën urinën në orë të ndryshme të ditës dhe kampion për biopsi. I regjistronin temperaturën rregullisht si çdo të sëmuri, por edhe kurat ia nisën menjëherë. Antibiotikë në formë gjilpërash e hapash dhe barna të tjera. Megjithatë, ditët kalonin dhe gjendja ngelej përsëri e errët. Aty - këtu vërehej ndonjë përmirësim i vogël, po që shuhej shpejt. Dhe më e keqja ish se po fillonte enjtja, një enjtje me ngjyrë të frikshme, mavi në kàfe, që, siç ma shpjegonte profesori, po shtrihej nga e majta në të djathtë, duke përfshirë edhe testikulën tjetër e duke ia shtuar dhimbjet.

Tashmë ai nuk fliste shumë, madjé rrinte orë të tëra me kokën nën batanie. Shtirej sikur flinte. Por, isha i bindur se me atë mbyllje në vetvete, u dorëzohej mendimeve të tij të kobshme. Hidhej e pritej prej tyre si një gogël, duke u përplasur nga një çast në tjetrin nëpër paretet e ftohta metalike të fundit tragjik.

Erdhi me një shiring në dorë infermierja, së cilës i kisha kërkuar ndihmë qysh natën e parë të ardhjes së tij.

- Ç'bën profesori, vetëm fle!? - më pyeti mua si e habitur dhe ia tërhoqi batanien ngadalë. - Kthehuni përmbys, profesor! Do t'ju bëj gjilpërën! - Po, tek vërejti se fytyra e tij ishte tjetërsuar nga tmerri, mbaroi punë duke psherëtirë dhe i tha: - Asgjë s'keni! Asgjë fare! Kot bëheni merak! Sa kam parë unë këtu! Por, është më keq me ju që jeni me kulturë shumë e me shkollë të madhe, se kujtoni që i dini të gjitha dhe vetëm tek e keqja ju vete mendja. Kurse ata që janë me tri - katër klasë, e stakojnë trurin që séfte, s'e vrasin kokën fort, dhe e shtyjnë në qetësi e me shpresë. - Pastaj ajo qeshi, por lehtë dhe ëmbël.

Profesori ia ktheu:

- Të thuash të vërtetën, kanë një proverb italianët: "*Chi vive speranto, lui more cacando*!" - Dhe çuditërisht, ia dha gazit së pari herë.

Infermierja m'u afrua dhe unë ia përktheva në vesh. U shqye së qeshuri edhe ajo pas profesorit, njësoj si asaj nate, me hahaha-ra të zgjatura. Tek largohej, u ndal te pragu i derës dhe shtoi duke tundur gishtin:

- Ne i kemi proverbat tona shumë më të mira, profesor! "*As guri nga thika, as burri nga frika*!" - Dhe doli.

Profesori i thirri nga pas:

- Eja prapë, eja prapë, se qenke ilaç! - Dhe nuk e mbuloi më kokën. Ndenji për pak si i menduar e m'u kthye mua:

- E zgjuar, grua e zgjuar, të thuash të vërtetën! Neve, që, demek, kemi ca gramë, ku nuk na shkon mendja dhe bëhemi një dorë. E unë, jo se kam frikë nga vdekja, se njeri jam e njeriu një herë vdes, po doja që më parë t'i kisha mbyllur ca halle. Një vajzë të vetme që kam, për shembull, është ende e pafejuar. S'dua t'ia nxij zemrën, pa e çuar në rehatinë e saj. Po ime shoqe? Në moshën që ka, vetëm të mbetet?... Janë edhe gjëra të tjera, të thuash të vërtetën, plot gjëra të tjera janë, që...

Ai s'vazhdoi dot. Zëri iu pre e iu mbushën sytë. Pra, e paskësh ndarë mendjen se ishte me... S'ma bën goja ta them!

Dhe ja, u duk në mesditë mjeku i dhomës, Berti. Ai vinte shpesh aty. Ulej pranë profesorit dhe bisedonte me të miqësisht. Jo veç për sëmundjen, por për tema të ndryshme. Vinte jo vetëm si mjek, po edhe si mik e vizitor, t'i largonte shqetësimin, ta ushqente me humor. Kurse këtë radhë atij vetë i mungonte humori. Erdhi pak si me druajtje. U kuptua edhe

nga hapat që bëri tek hyri. Të ngadalëshme, si në majë të gishtave.

- Hë, profesor, si shkojnë punët? - e pyeti duke iu ulur pranë e duke ia fërkuar dorën.

- Di unë! Ju, mjekët, ç'thoni?

- Po ju, si ndjeheni?

- Ç'të ndjehem! *Gur në rrokullimë*, të thuash të vërtetën!

- Aaaa, ju lutem, ç'është kjo fjalë! S'keni aspak të drejtë! A nuk ju kam thënë qysh në fillim se gjithçka do të shkojë mirë!?

- Po ku është e mira, ku është!? Unë, Berti djali, çdo ditë bëj tatëpjetë, të thuash të vërtetën! *Siç duken bathët e priftit, s'ka pashkë sivjet!*

- Ka, ka! Si s'ka! - ia ktheu kirurgu. U përkul mbi të dhe tundi kokën si me qortim. Pastaj u prapësua dhe mblodhi buzët. Sikur pengohej të thoshte diçka. Më në fund, i tregoi profesorit se të gjithë mjekët në konsultë kishin menduar që ekziston një mënyrë e shpejtë për shërimin e tij, një mënyrë fare e shpejtë. Dhe ajo do të ishte rruga më e mirë, më oportune, e jo duke pritur gjatë efektin e mjekimit.

- Po, hë, more, Berti djali! Ta marrim vesh, të thuash të vërtetën!

Mjeku iu përgjigj se ishte fjala për një operacion të thjeshtë.

- Përse, mo, përse the!?

- Duhet t'jua heqim testikulën e majtë, profesor, duhet patjetër t'jua heqim!

Profesorit iu ndal fryma.

- Vetëm të majtën?

- Po, po! Vetëm të majtën!

Profesori piu një gllenjkë ujë dhe pastaj prapë e pyeti kirurgun me gjysmë zëri:

- Je i bindur, biri im?

- Qind për qind!

- Dhe më pas ç'ngjet me mua?

- Kurrgjë e keqe! Dy ditë, tri, le të themi katër, do të rrini këtu në observacion pas operacionit. Pastaj do të jeni i aftë të ktheheni shëndoshë e mirë në shtëpi, si kokrra e mollës, për të vazhduar jetën dhe punën normalisht.

- Të të besoj, Berti djali?

Kirurgu qeshi paksa.

- Si jo!

Profesor Sotiraqit nuk po i vinte fytyra në vend. Ai heshti për disa çaste, u mbush me frymë dhe iu afrua kirurgut disi më shumë.

- A t'ju them diçka në vesh? Se, të thuash të vërtetën, s'dua të më dëgjojë ky i riu!

- Jo, jo! Asgjë s'keni ç'të më thoni! Ju kuptoj fare mirë. Funksioni i organit do të vazhdojë të jetë, si gjithmonë, i rregullt.

- Edhe për këtë të të besoj, Berti djali?

- Patjetër!

- Mos duhet konsultuar edhe me ndonjë mjek të këtij specialiteti?

- Aspak!

- U bëftë, de! Të thuash të vërtetën, për operacionin e kam fjalën!

Kirurgu e përqafoi profesorin, i shtrëngoi dorën dhe e porositi që, ndonëse ai i tij nuk qe operacion plot goja, rregulli e kërkonte të mos hante ushqim në darkë. Pra, të pinte vetëm çaj. Dhe u largua.

Bashkë me mbrëmjen, si ta dërgonte dreqi vetë, erdhi në dhomë infermierja tashmë e njohur. Ajo iu qas edhe më atij dhe i foli si e gëzuar:

- A ju thashë që s'keni gjë? Ja, një bisturi nesër dhe do të shkoni prapë te plaka!

Profesori, edhe pse nënqeshi, ia ktheu i prekur:

- Aaaa, ju lutem! Mos flisni ashtu! E kam të re gruan! Po edhe vetë plak s'jam, të thuash të vërtetën!

Infermieren sikur ta kishe shpuar befas nga pas me ndonjë majë gjilpëre! Ajo u vërvit përpjetë dhe i tha përmes një të qeshure të papërmbajtur:

- Uh, hahahaaa! Do të shohësh tani, që do t'jua heqin! Uh, hahahaaa! - Dhe doli duke rrahur gjunjët me pëllëmbë.

Profesorit sa s'i ra të fikët.

- Moj shoqe, moj motër, moj zonjë, ju lutem, kthehuni pak! - nisi të thërriste me zë të mekur. - Kthehuni pak, se, të thuash të vërtetën, vetëm një pyetje kam, vetëm një pyetje!

Po infermierja tashmë ishte larguar dhe as që e dëgjonte. Atëherë ai m'u drejtua mua dyllë i verdhë:

- Ç'tha ajo ashtu, mor djalë? Se, të thuash të vërtetën, ma bëri gjakun ujë!

- Më vjen keq, profesor, që i besoni asaj! - u përpoqa ta qetësoja. - Nuk e shihni ç'llafazane është!?

Po ai nuk u qetësua.

- Këtu diç los, se, të thuash të vërtetën... - S'po dinte ç'të shtonte. Mezi merrte frymë. Pas pak, m'u lut: - Bertin desha, vetëm Bertin! Ai e shkoqit këtë punë! Ai! A ma gjeni dot? Hë? Si?

Dola, e kërkova nëpër pavion. S'dukej kurrkund. Pyeta mjekun e rojes. Më tha se ishte në shtëpi. Iu luta t'i telefononte e të më lidhte me të, se kisha një problem të ngutshëm. I telefonoi pa ma zgjatur dhe më dorëzoi receptorin. I thashë Bertit se e priste profesori të vinte sa më parë. E tillë ishte puna. Po të mos vinte, zor ta gdhinte natën pa ndonjë pasojë të rëndë!

Ai ia mbërriti qull në djersë, jo më vonë se pas njëzet minutash. E kishte bërë rrugën me biçikletë. Vrapoi drejt profesorit, i preku pulsin dhe e pyeti:

- Ç'është!?

Dhe ky i tregoi duke iu mbajtur goja gjithë ç'kish ndodhur. Berti u nervozua.

- Po pse, ju lutem, me shakatë e infermieres shkoni ju, profesor!? Hajt, pa di unë ç'i bëj! - U nis të delte, por profesori e ndali. Atëherë kirurgu i përsëriti, duke theksuar mirë çdo fjalë, tërë çfarë i pati thënë atë mesditë.

- Pra, Berti djali, vetëm të majtën, hë?

- Po, po, po! Dhe asnjë pasojë s'do të ketë për vitalitetin tuaj! Më lejoni t'jua them më hapur?

- Ashtu, ashtu! Më hapur, më hapur!

- Do të jeni si më parë në marrëdhëniet intime me bashkëshorten!

Profesorit iu mbush fytyra me gjak.

- Të mundova, bir! - i tha dhe e puthi në ballë. - Po, të thuash të vërtetën, ajo e marrosura më luajti mendsh!

- Lëreni atë! Apo të shkoj ta marr e ta sjell t'ju kërkojë të falur?

- Bah! Ç'më duhet pendesa e saj! Mua, të thuash të vërtetën, vetëm këto që më the ti më duheshin. Kthehu në shtëpi tani, kthehu e çlodhu!

Kirurgu e përqafoi profesorin dhe u largua, duke na tundur dorën nga pragu i derës.

... Operacioni i profesor Sotiraqit shkoi mirë. Orëve të para ai nuk ankohej më për dhimbje e as për temperaturë, veçse ndjente ca djegie atje poshtë, po ato qenkëshin të lehta e s'u jepte rëndësi. Ishte i kënaqur dhe gjithë besim. Gruan, vajzën dhe tërë të afërmit i largoi shpejt, se, sipas tij, *të thoshje të vërtetën*, nuk kishin përse bëheshin merak.

Të pasnesërmen, kur erdhi kryeinfermieri dhe po e mjekonte, ai i shkeli syrin dhe e pyeti si me shaka:

- Rakip, ju lutem, sa shikoni aty, një apo asnjë?

- Është njëra, profesor, është! Ja, t'jua prek!

- Oooo, ç'bëni ashtu, mor i uruar! Më dhembka ca, të thuash të vërtetën! Shumë e shtrënguat!

Qeshi bashkë me kryeinfermierin. Dhe ishte i lumtur. Sa s'fluturonte! I pëlqente të fliste pareshtur, të tregonte gjëra gazmore, të shkrihej gazit vetë, po edhe të tjerët të qeshnin. Atë humor tashmë ia kisha zili.

- Të thuash të vërtetën, shtatë më vanë kësaj radhe!

Më vuri te komodina nja dy pako llokume, biskota, ca mollë Korçe të kuqe flakë, e ku di tjetër çfarë...

- Profesor, mjaft!

- Hajt, hajt, se të thuash të vërtetën, ju kam pasur djalë, shok e vëlla në orë të vështira! Por, më njohët keq këtu! Nuk e dini ju se ç'është Sotiraqka! Ka një zemër floriri, të thuash të vërtetën, dhe do që të gjithë njerëzit e botës të jenë pa halle! Pooosi!

Prej operacionit patën kaluar gjashtë ditë. Profesori ndihej si jo më mirë. Shkonte vetë në banjë, shëtiste nëpër korridor, u afrohej të sëmurëve të tjerë, i pyeste, u jepte forcë. Dhe kur përpiqte me ndonjë, që nuk ishte me familje në Tiranë, shkarkonte në komodinën e tij të gjitha ç'i kishin sjellë. Një çast më tha:

- Mo, po, atë Bertin s'na e zunë sytë fare sot! Ç'është kjo punë!

- Ka qenë gjithë ditën në kirurgji! - ia ktheva. - Do të jetë lodhur shumë dhe do të ketë shkuar në shtëpi të shtrihet.

- Ashtu thoni?

Të nesërmen, sa erdhi, profesori e pyeti:

- Edhe sot nuk do të dal!? Të thuash të vërtetën, jam mirë, bre, fare mirë! Ç'më mbani më këtu!?

- Të shohim nga dreka, profesor! Mund edhe të dilni!

Por *Berti djali* u kthye më herët te ne, pa vajtur ora dhjetë. Ishte tym. Me një fytyrë - sterrë. Ballin - të rrudhur dhe buzët - të mbërthyera. U ul pranë profesorit si me përtim.

- Ah, mor profesor! - tha befas. - Kam një lajm... kam një lajm... Po, s'e them dot!

- Çfarë lajmi, mo Berti djali!? Thuaje shpejt, se të thuash të vërtetën, po më bie pika!

- Thashë që s'e them dot, se s'është lajm i mirë!

- Është i keq!? - pyeti profesori syshqyer.

- Po! Siurdhëron! I keq! Veç mos u shqetësoni! S'ka asgjë për t'u shqetësuar, po për t'u nervozuar, për të protestuar, për të thirrur e sharë!

- Aaaa, tani më shushate! S'po të marr vesh, të thuash të vërtetën!

Po kirurgu s'e la më gjatë në agoni. Ai i shpjegoi se sapo kishin dalë përfundimet e biopsisë. Dhe ato tregonin që...

- Unë s'mund t'jua fsheh, se jeni shok i tim eti, po edhe se ju kam pasur pedagog! Pra, do t'jua them, sido që ta prisni!

- Po, hë, mo Berti djali, se po më zihet fryma! Mos duhet hequr edhe tjetra? Fol, de, se po më ngrin zemra!

- Jo, jo! Përkundrazi! Në rastin tuaj s'kishim të bënim me kurrfarë elementi kanceroz, as meninj e as beninj! Pra, edhe testikulën e majtë jua hoqëm gabimisht. S'kishte asnjë arsye që t'jua hiqnim. Puçra do të kalonte me mjekim.

Sa dëgjova këto fjalë, u drodha i tëri. U rrënqetha. Mishi m'u bë kokrra - kokrra. Kërceva përpjetë mbi shtrat. Isha gati t'i hidhesha *Berti djalit* në fyt. Ç'kirurgë qenkëshin ata! Si i bënin ato punë pa gàle fare! Edhe me kafshët duhej më shumë maturi e jo më me njerëzit! Prita që profesori ta mbërthente *Berti djalin* për leshrash. Prita që ta pështynte, ta kafshonte, ta gricte me thonj... por... ah!

Ai... Zot, ku je! As u mërzit e as protestoi! Veç ngriti grushtet lart, si ata që triumfojnë në ring! Dhe thirri i qeshur:

- Fitore! Fitore!

Pastaj iu hodh kirurgut në qafë me mirëdashje. E puthi në ballë, siç e kishte puthur aty ca ditë më parë. E puthi edhe te faqet. Doli nga shtrati, u ngrit në këmbë e u sul drejt meje.

- Më lejoni t'ju përqafoj e t'ju puth edhe ju! - më tha. - Se, të thuash të vërtetën, kjo është fitorja më e madhe, që kam korrur në jetë!

Unë ngriva syhapur. Po edhe Berti ngriu syhapur. E pyeti i trembur dhe me një zë si të zvargur:

- Ndjeheni mirë, profesor? Për çfarë fitoreje flisni!? Ç'gëzoni kështu!?

- Si të mos gëzoj, Berti djali! Kam shpëtuar për një qime! Mund të m'i kishit hequr të dyja! Ashtu, gabimisht! Me ç'sy e faqe pastaj, do t'i dilja bashkëshortes përpara, të thuash të vërtetën!

KAVAFIS, POETI I SFIDAVE ESTETIKE

nga Ymer Çiraku

Poeti mjaft i njohur grek, K. P. Kavafis, i përcaktuar si ndjekës i parnasizmit dhe simbolizmit, ka lindur në Aleksandri të Egjiptit, ku jetoi tërë jetën e tij - me përjashtim të pak viteve, kur familja ishte vendosur në Angli. Nëpunës në një zyrë që merrej me problemet e ujitjes, natyrë mjaft e tërhequr, krijimet e veta nuk preferoi që t`i përfshinte në rrjetin e botimeve publike. Të përmbledhura, sigurisht në një numër relativisht të pakët krijimesh poetike, sikundër e kishte prirje të vet autori të shkruarit e kursyer, ato u botuan dy vjet pas vdekjes së tij (1935), duke u ndjekur nga një radhë botimesh e ribotimesh viteve më pas, në greqisht e në shumë gjuhë të tjera.

Në krye të përmbledhjes poetike të K. Kavafis-it (në variantin më të fundit të përkthyer në një shqipe të begatë nga Aristotel Spiro, krahas dhe mjaft përkthimeve të tjera të kryera nëpër vite nga: N. Kacalidha, R. Çollaku, Andrea Zarballa, P. Jorgoni...), është poezia me titull *Muret*. Në këtë poezi, përcillet në nivel metaforik situata e vështirë, absurde e tragjike e atij njeriu, rreth të cilit, papritur, nisin të ngrihen shkallë-shkallë mure asfiksues, e ai - poeti dhe njeriu në përgjithësi, që s`i vuri dot re, që s`e pati mendjen të dëgjonte zhurmën e muratorëve, kur ata i ngrinin lart e më lart ato mure rreth tij. Dhe së fundmi, e ngritur dilema provokuese: mos vallë njeriu për nga natyra e tij i ndjell (i ndërton) vet ato mure, për të realizuar/formatuar brenda vetes instinktin e vet të vetmbylljes, vetizolimit, e pastaj shkatërrimit!? Apo është i shtyrë nga alteregoja e tij mitike për t`i provuar forcat e veta se si mund që t`i rrëzojë e të ngrihet ngashnjyes mbi ato *mure*?

Pa drojë, pa mëshirë e pa kujdes
mure të larta rrotull meje ngrenë.

Tani këtu kam mbetur pa shpresë.
Tjetër s`mendoj: ky fat mendjen ma bren;

se jashtë plot gjëra kisha për të bërë.
O, si nuk i vura re kur muret lart i çuan.

Por zhurmën e ndërtimeve s`e ndjeva asnjëherë.
Dhe fare papandyer prej botës më larguan.

Shtrohet pyetja: ç`janë këto mure që e shigjetojnë trandshëm shpirtin e poetit? U rrethua, u pengua, por prej çfarë rrethanash nuk u mposht dot prej tyre e si mundi që t`i kapërxejë e të triumfojë mbi to, me famën e njerit prej poetëve të shquar të shek. XX?

Brenda kësaj atelieje krijuese, ku endej në vetminë e tij poeti, e ku nuk dukeshin aspak modele aq të ngjajshme, ai krijonte vargje të çuditshme e blasfemike për nga struktura ligjërimore dhe konceptuale, pothuaj të padëgjuara deri kësaj kohe, në gjendjen tëhuajtëse të atij njeriu të mënjanuar prej të tjerëve, si i *pakuptuari*, i *papranuari*, por njëherazi edhe si i *paarrituri* dot prej tyre. I pakuptuari - për tejkalimin elegant mes teknikave formale të prozës e poezisë, për rrezëllitjen poetike që buronte prej atyre toneve e mjediseve depresive, të derdhura dendur në poezinë e tij.

Në studime kritike, në përcjellje të përkthimeve, në manuale e në histori të ndryshme të letërsive, Kavafis është vlerësuar si poeti *zëpërveçëm* i shekullit, që konstruktoi *gjeometrinë e absurdit*, si *poeti dekadent i poetikës së demoralizimit njerëzor* dhe i funksionalizimit deri edhe të regjistrave - të ashtuquajtur më të ulët të gjuhës, duke u derdhur atyre një magji poetike mbresëlënëse.

Krijimtaria e këtij poeti, ka një shfaqje të veçantë, e klasifikuar në tre nivele. Janë 154 poezitë e pranuara sipas vullnetit të tij, të cilat, mund t`i vlerësonim si krijime që ngrihen e kalojnë përtej *mureve* dhe në anën tjetër, janë ato të *mohuarat* dhe pastaj vijojnë më tej, ato të *pabotuarat*. Tematikisht, ajo poezi është parë dhe ndarë specifikisht në: poezi filozofike, hedonike (ose mirëfilli estetike) dhe historike. Kjo poezi, u mbrujt konceptualisht si një endje në universin helen dhe atë bizantin, duke kombinuar në harmoni *artin e distancimit helen prej objektit* me *polifonizmin* (shumëzërësinë) e mistikës bizantine. Kësisoj, në të kemi të shkrira: refleksionet e dendura filozofike me gjendjet e trazimeve kundërthënëse e dramatike. Pra, nga pikëvështrimi i ngjyrave poetiko-semantike, në ato krijime, ndihen të bashkëshoqëruara në *harmoninë* e kundërshtive, ndriçimet solare helene me transhedencën e botës bizantine.

Dhe e gjithë kjo ngrehinë komplekse dhe e mirëmenduar (kalkuluar) poetike, i gjen referencat e veta ligjërimore tek një gjuhë e thjeshtë, e xhveshur nga shkëlqimi tradicional, e cila shfaqet pothuaj përmes kuptimeve fillestare të fjalëve, sikur të synojë që të shkojë tek rrënjët e tyre. Kjo tendencë, që në një vështrim të parë formal duket si *apoetike,* funksionon brenda strategjisë së një ligjërimi, që, siç e vren një kritik (K. Steriopulos), aq sa kufizon zgjedhjet, duke krijuar gjuhën e tij vetiake – aq më shumë ngjitet lart poetikisht me aplikimin e teknikave të gjuhës rrëfimtare të rrugës. Atë që konsiderohej deri atëhere si dobësi prej shijes tradicionale, poeti e ktheu në fuqi dhe burim suksesi, pikërisht duke arritur *rilindjen* e fjalës poetike. Përmes një leksiku bazik, me të atilla shenja gjuhësore - në nivel gati të thjeshtëzuar, të cilat kanë qarkulluar e qarkullojnë njëkohshëm tek të gjithë folësit dhe në të gjitha kohërat, ai krijon modelin e teksteve moderne, të cilat do të ndihet të zotërojnë si prirje edhe në poezinë europianë e më gjerë.

Por le t`u kthehemi *mureve,* përballë të cilave u end kjo poezi e përveçme për nga modeli që përcillte. Fryma helene dhe bizantine e saj, e ngopur me filozofi, ngjarje dhe personazhe të larmishëm të atyre epokave, do të projektonte *anacionalitetin*, një tipar ky, që prej kohësh, nuk dukej të ishte i pranishëm në letërsinë e re greke, madje në të, vrehej e kundërta. Kavafis ishte pra, ai i *ndryshmi*, ose i papranuari lehtë brenda shijeve letrare e mentaliteteve të kohës. Sigurisht, kjo situatë do të bëhej më evidente edhe prej gjuhës së poezisë së tij, e cila, e refuzonte prej vetes *kantilenën* e poezisë me paradigma të drejtpërdrejta nacionale, që sigurisht, kishte pasur kontekstet e veta në të cilat ishte krijuar dhe përcillej prej dekada vitesh te lexuesit. Arti poetik kavafian, i pati të huaja manierat romantike dhe etnocentriste, të shfaqura aq shpesh prej poezisë së kohës, duke guxuar që të përballej kësisoj estetikisht me prestigjin autoritar - që kjo *texturë poetike* kishte fituar. Ai nuk ndiqte rrugën, që, prej historisë e ngjarjeve të mëdha, të zbriste pastaj tek njeriu, por në kahje të kundërt, prej individit tentonte të eksploronte gjithë botën. Dhe prej *mikrobotës* së Kavafi-sit, në fakt, arrihet që të depërtohet ngultazi tek *makrobota*, duke krijuar kështu modelin e një komunikimi poetik maksimalisht të brendshëm, të intimizuar e për rrjedhojë, në trajtë mjaft përjetuese.

Për poetin, *mure* ishin tërë tabutë dhe mitet letrare, sociale, fetare, shtetërore e morale njerëzore, të cilat, kanë aftësinë e tyre, që të krijohen e të lartësohen rreth njeriut pa u ndjerë, tinëzisht, shpesh si muzikë këndellëse, për ta kufizuar e mbytur pastaj horizontin e tij. Bjerrja e njeriut, apo edhe tundimi i tij prej pushtetit, janë gjithashtu mure mbytëse. ...*Prej madhështive, ruaju, o shpirt*..., apelon me alarm drithëronjës poeti, duke renditur në përskaj edhe vargjet:

Dhe nëse s`mundesh ta bësh jetën si ta kënda,
veç për një gjë lufto të paktën
sa mund: të mos e bdarësh...

Aq sa muret i krijoheshin prej së jashtmi, për poetin kishte edhe nga ato mure, që ai paradoksalisht ia krijonte vetes në planin njerëzor. Mbase si baste me veten për të provuar se a do të ishte në gjendje për t`i kapërcyer ato. Me këtë lidhet fakti që p.sh. sa ishte gjallë, ai nuk i botoi asnjëherë si libra krijimet e veta, por ua çonte ato në fashikuj miqve, duke u përballur me sfidën e moskomunikimit përmes botimit. Po kështu, shndërroi në përvojë estetike devijancat tabu erotike, që kishin vetëm shanse refuzimi në receptimin e tyre. Por koha tregoi se këto e të tjera rrethana të disfavorshme, nuk e penguan dot njohjen dhe vlerësimin e lartë të kësaj poezie, edhe përtej kufijve të gjuhës, në të cilën ai e krijoi atë vepër poetike.

Kësisoj, vepra e Kavafis-it, jo vetëm i dëshmoi *muret* (pengues) realë e metaforikë të njerëzimit, të cilat ngrihen për ta rrethuar e asfiksuar shpirtin e individit, por dëshmoi poetikisht po aq - edhe vullnetin e njeriut për t`i dalluar, për t`i përballuar e pastaj për t`i rrëzuar ato mure, estetikisht e moralisht.

Kavafis mbetet poeti i madh i sfidave estetike.

(Shënim: tekstet e poezive të cituara në këtë shkrim, janë marrë nga përkthimet e A. Spiros prej greqishtes)



DRITË PËR ATË QË DRITËSOI BEKTASHIZMIN

Nga Bashkim Koçi

Suksesi është biri i guximit. E gjej të udhës të sjell këtë sentencë ndërsa jam njohur me tri veprat voluminoze të Baba Ali Tomorrit, përgatitur nga studjuesi serioz e punëshumë, i palodhuri Mehmet Gëzhilli me të cilin ka gati gjysëm shekulli që jemi lidhur dhe bashkëudhëtojmë në rrugën sa të bukur e të vështirë të gazetarisë. E kanë ditur shumë studjues e hulumtues të tjerë që Baba Ali Tomorri ka lënë të shkruara e të botuara një mal me dorëshkrime, por asnjë deri tani nuk guxoi t'i kërkonte nëpër arshiva e biblioteka, t'i mblidhte ku ishin e ku s'ishin, t'i sistemonte e t'i botonte në vëllime të veçantë sipas problematikave që trajtoi gjatë gjithë jetës krijuese ky bektashi i madh. Këtë informacion e ka ditur edhe ai, i cili, mesa kemi biseduar, kush e di se sa herë unë si bektashi Prishte dhe ai si bektashi Vrëpckë (Opar - Korçë), për jetën dhe veprën e Baba Ali Tomorit (Turabiu). E ka menduar shumë herët, madje e ka patur "ëndërr në sirtar" që të mundëte ta përmbyllte këtë detyrë paksa hyjnore, ashtu si ai e kishte "projektuar" në mendje e në zemër.

Sigurisht që pas çdo bëme të bujëshme, siç është përgatitja e veprës së plotë të Baba Ali Tomorrit, u gjend një njeri i letrave, u "çmend" dikush për t'ju futur "detit në këmbë" e për t'u përballur me një punë të lodhëshme e cfilitëse. Dhe ky njeri që mori këtë vendim të guximshëm e ka emrin Mehmet Gëzhilli. Por nëse e shohim nga afër, pra të mund të dëgjojmë edhe të rrahurat e zemrës të këtij studjuesi të staxhionuar me punë të mëdha, nuk kemi pse të çuditemi që ai e ka kthyer jeten e tij në sukses. Sepse është ai që nuk ia ndan sytë objektit të dëshiruar dhe e synon atë me vendosmëri, deri sa ta arrijë të materjalizuar në vepra. Të befason një gjë në tërë studimet e botimet e tij: ai gjithmonë ka synuar larg dhe lart.

Një jetë të tërë ia kushtoi studimit dhe botimeve për heronjtë dhe dëshmorët, duke patur parasysh amanetin e tyre: "Mbi hirin e dëshmorëve ngrihet atdheu".

Vite më parë botoi bibliografinë "Fan Noli - 120 vjet jetë dhe veprimtari", e vetmja në llojin e saj dhe që ka hyrë e zënë vend denjësisht në Bibliotekën e Universitetit të Harvardit, ku Noli ka qenë student.

Ky botim u pasua nga Bibliografia për Artistin e Popullit Aleksandër Moisi, botuar në Tiranë dhe në Shkup (Maqedonia e Veriut). Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Nënë Terezës botoi bibliografinë "Nënë Tereza në shtypin shqiptar" dhe përmbledhjen "Nënë Tereza në sytë e botës". Dhe vite të tëra i ka kushtuar veprës së Naim Frashërit si dhe vepra për të, duke botuar një çerek shekulli më parë "100 poetë për Naimin", pasuar me "155 poetë për Naimin", duke u përpjekur që gjatë këtyre viteve ta mbyllë me një korpus botimesh tërësore për poetin shenjtor, Naim Frashërin.

Kështu që krijimtaria e Baba Ali Tomorrit, e të gjitha gjinive, sikur qe një fat bekimi që ra në dorë, në mendje dhe në zemrën e këtij studiuesi dhe botuesi serioz dhe i kualifikuar.

Vepra e Baba Ali Tomorit ka fuqi mbresëlënëse te lexuesi sepse është "mish e gjak", absolutisht pa dogma e fjalë që nuk ngjisin te një njeri i formuar intelektualisht. Madje këtu qëndron edhe madhështia dhe lavdia e këtij bektashiu zemërzjarrtë, te botkuptimi i tij paksa i çuditshëm, nëse kemi parasysh që ai mban të veshur harkanë e dervishit bektashi. Në të gjithë krijimet e Baba Ali Tomorrit i mëshohet çështjes kombëtare, atdheut, bashkëjetësës fetare dhe vëllazërisë midis shqiptarëve. Diku në vëllimin e parë të veprës së tij, ku përfshihen poezi, këngë popullore dhe krijime letrare nga më të arrirat, lexuesi ndoshta çuditet kur i shfaqet titulli "Jo për fe, por për atdhe". Kam përshtypjen se studjuesi dhe botuesi i veprës së këtij kleriku të lartë bektashi është udhëhequr dhe e ka bërë për vete pikërisht këtë moto dhe që ai nuk e ka frikë errësirën, por ama vë në funksion mendjen e tij të ndritur që të mund të gjejë dritën.

Asgjë nuk është e shenjtë po nuk qe e tillë ndershmëria e mendjes të atij që mer përsipër të ngjizë diçka nga e para. Studjuesi në këtë ndërmarje të vështirë, por punë të nisur me shumë dashuri, ka qënë dëshirë e një lloi tjetër, nga ato që njeriu vendos për të bërë diçka për tjetrin, që në këtë rast bëhet fjalë për dikë që e vuri jetën e tij në shërbim të njerëzisë, madje edhe të sakrifikohej për të, siç ishte Baba Ali Tomorri. Nuk mund të themi e të pranojmë që ky studjues i nivelit të lartë, hulumtues e zbulues i personaliteteve më me emër, që intelektin e kishin kthyer në hyjni, siç ishte Baba Ali Tomorri, të harxhonte kohë e punë të kualifikuar, dhe në fund të na shërbente diçka bajate e me vlera neveritëse. Kjo nuk ka ndodhur dhe nuk do të imagjinohej nëse do të vinim në peshore studjuesin dhe krijuesin, të cilët për fat të mirë janë në barazpeshë të admirueshme. Pra vepra dhe e gjithë krijimtaria e Baba Ali Tomorrit gjeti të zotin e punës, atë që kishte zënë radhën prej kaq kohësh për t'i ngritur e bërë me shumë dashuri, as më pak e as më shumë, por një monument të argjendtë.

Përgatitjen dhe botimin e serisë së veprave të Baba Ali Tomorrit, botuesi e ka përjetuar si një kënaqësi të pritur gjatë, me vite e vite. Por kjo pritje e gjatë, siç ndodh shpesh, nuk se iu shit me çmim të lartë. Jo. Ai e "bleu" aq sa vlente edhe për faktin se në pjesmarrjen në "ankandin e shpallur" ishte i vetmi që konkuroi. Pastaj rrallë ndodh në kësi punësh që të të jepet mundësia të ngresh në këmbë "bustin" e një kleriku të lartë bektashi, të Baba Ali Tomorrit, dhe inteligjenca e aftësia për të realizuar si rrallëkush një përmbledhje të të gjithë krijimtarisë në tre vëllime voluminoze e mjaft cilësore.

Njeriu i drejtë e me vlera të çmuara intelektuale shpesh ndërgjegjen e tij e sundon mirësia, ndjenja e të qënit njerëzor dhe i përpjekur për t'ju përkushtuar asaj çka i dikton zemra. Ndaj jam i prirur të them se studjuesi dhe botuesi i kësaj vepre nuk mund të mos ketë marrë fuqi, në vendimin për të sjellë të plotë veprën e Baba Ali Tomorrit, nga amaneti i tij i fundit të shprehur me fjalë përgjëruese "Më ruani dorëshkrimet!". Këto janë fjalë të thëna disa çaste përpara se të ikte nga kjo botë, përpara se ta pushkatonin. Dhe ai, ndonëse nuk ishte njeriu i duhur për të mbajtur amanete të deklaruara e të mbetura të kyçura në vite, sa s'mbahej mend, por ama, duke u njohur me kërkesën-amanet, sa njerëzore po aq edhe hyjnore "Më ruani dorëshkrimet", fill pas 70 vjetësh nga dita e ekzekutimit, s'kish si të mos nxitej për t'ju futur me gjithë shpirt "aventurës", e cila në pamje të parë kërkonte guxim disi të tepruar, sepse do të thoshte t'i futeshe detit më këmbë.

Të bëheshe garant për të botuar veprën e plotë të Baba Ali Tomorrit, duhej të kishe një besim në vetvete, duhej ta ktheje atë në mision. E pra, në të gjithë këtë çka na ka sjellë, si dashamirës të letrave, por edhe si bektashi, ka kryer një mision, ka realizuar atë që rrallëkush mund ta merrte përsipër për ta çuar deri në fund. I kam bërë pyetje vetes: "Si ndodhi, ç'shtysë ka qënë ajo që e gjithë kjo punë e madhe voliminoze të përfundonte, duke na e sjellë Baba Ali Tomorrin të plotë, ashtu si ka qenë, por edhe të pastërt e të qelibartë si ai?" Sigurisht që studjuesi guxoi por, siç thotë një filozof, guximi nuk të hyn në punë, nëse inteligjenca nuk e nënshtron. Pra e thënë shkurt, ky punëmadh që ka shok vetë veten, arriti të na sjellë "universin" e klerikut mendjendritur Baba Ali Tomorri, falë formimit të tij të kompletuar.

Vepra e plotë e Baba Ali Tomorrit, e shumëpritur nga lexuesi shqiptar, por sidomos nga ai bektashi, është sistemuar bukur dhe me kompetencë profesionale në tre vëllime. Natyrisht që nuk ka vend për t'u marrë me hollësi rreth kësaj gjëje, pra të shtjellohet në detaj se si e qysh e ka projektuar e ngritur këtë ndërtesë tre-katëshe arkitekti i botimeve, sa serioze, edhe të rralla. Ajo që ka rëndësi të thuhet është se edhe në vendosjen e krijimeve; të poezive, të këngëve popullore, të problemeve për gjuhën, për forklorin, për letërsinë, publicistikën, aforizma bektshinjsh etj., çdo gjë është në vendin e vet, sipas një "protokolli" të pranuar nga ustallarë të këtyre punëve. Dhe në këtë zgjedhje studjuesi është prirë nga formimi i tij intelektual dhe jo nga frika e gabimeve që mund të bëhen nga një punë rutinore. Parë në këtë vështrim edhe këto detyra, në dukje të vogla, janë parë si të shenjta, që edhe ato duhet të trajtohen me shumë kujdes, por edhe me shumë dashuri, si të ishte aty pranë makinërisë të shtypshkrimit autori i tyre, i madhi Baba Ali Tomorri.

Botuesi i veprës së plotë të klerikut mendjendritur Baba Ali Tomorri meriton fjalë nga më lavdërueset sepse ai që u rezistoi pengesave, vështirësive, përplasjeve nga më të rëndomtat gjatë kërkimeve dhe zbulimit të kësaj drite të pashoqe në historinë e krijimtarisë dhe filozofisë bektashiane. Komplimenti në këtë rast është jo vetëm një dhuratë për studjuesin, por edhe një bekim për të, si i dërguari nga "ai lart" për të realizuar e për të na e sjellë në dorë këtë dhuratë të jashtëzakonëshme. "Zoti, - ka thënë politikani dhe filozofi Mahatma Gandi, - nganjëherë i vë në prova të mëdha njerëzit që dëshiron të bekojë". Studjuesi Mehmet Gëzhilli u vu dhe e kaloi këtë provë të madhe ndaj edhe s'ka përse të mos e meritojë këtë bekim.

Dhe së fundi, si përfundim, dua të evidentoj faktin: Kryegjyshata Botërore Bektashiane me në krye Kryegjyshin Botëror Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj, krahas shumë veprave madhore, që nga ngritja e Odeonit, Muzeut, Bibliotekës, Arkivës, rregullimi e zbukurimi i gjithë ambjentit të Kryegjyshatës, ringritja e shumë teqeve nga themelet, apo grumbulli i gërmadhave të mbetura nga rrënimi ateist i 1967, si dhe botimi i një sërë veprash të rëndësishme, me botimin e veprës së plotë të Baba Ali Tomorit plotësoi një boshllëk të madh dhe solli një xhevahir letrar e historik jo vetëm për Bibliotekën Bektashiane, por edhe për Bibliotekat Kombëtare në Tiranë, Prishtinë, Shkup. Tetovë, si dhe për çdo bibliotekë albanologjike nëpër botë.

Për realizimin e këtij projekti, sa madhor e dinjitoz, në Vitin e Naimit, si dhe projekte të tjerë më ambiciozë, Baba Mondi meriton urimet më të mira dhe bekimin e të gjithëfuqishmit Zot, që ka për të ardhmen.

MBI UDHËTIMIN EUROPIAN TË NJË ROMANI BASHKËKOHOR SHQIPTAR "SECILI PËRKTHEHET SIMBAS MËNYRËS SË VET"

nga Andreas Dushi

Cikli romanesk në tre vëllime, me titull "Secili çmendet simbas mënyrës së vet", vëllimi i parë i të cilit u botua në fund të vitit 2016, nga "Botime Fishta" dhe që vijoi me vëllimin e dytë më 2017 dhe të tretin më 2019, përvec një receptimi shumë të mirë publik në botën shqiptare nisi rrugën e vet të meritueshme nëpër Europë, duke u përkthyer deri më tani në shtatë gjuhë të huaja.

Vëllimi i parë i romanit madje u shqyrtua edhe nga juria e çmimeve kombëtare më 2017, të cilët nuk e përfshinë as në listën e dhjetë librave më të mirë të vitit.

Por letërsia është një garë maratone dhe jo njëqind metrash. Fiton kush reziston më shumë dhe jo ai që fugon më shpejt.

Duke marrë shkas nga ky roman, në "Historinë e letërsisë europiane" botuar vjet në Paris nga Qendra Kombëtare e Kërkimit Shkencor (CNRS) shkruhet se: ""Oraliteti, si dhe hibridizimi i zhanreve letrare e i arteve, qe ky kërkon dhe ia paraqet publikut, është gjithkund, absolutisht gjithkund, marka e krijimit të sotem. "Secili çmendet simbas mënyrës së vet", ky është titulli qe më 2016 i jep triptikut të vet romancieri shqiptar Stefan Çapaliku. Dhe çmenduria sot perhapet te shkrimtarët, të cilët ngjiten në skenë dhe rikthejnë traditën mijëravjeçare të bakanteve, të rapsodit, të bardit, të trubadurit, të DJ-t, nëpërmes slamit, repit apo hip-hopit. (Lettres europennes, CNRS Editions. Pg.1004. Paris, 2021)

Në vitin 2018 vëllimi i parë i këtij cikli njohu dy botimet e para në gjuhë të huaja: në frëngjisht: **"Chacun s'affole à sa manière"** përkthyer mjeshtërisht nga Ardian Marashi dhe botuar në versionin dygjuhësh nga shtëpia botuese "Meet", Paris, 2018. Po kështu kemi edhe botimin në serbisht **"Svako poludi na svoj nacin"** nga shtëpia botuese "Clio", përkthyer prej mjeshtrit Danillo Brajovic. Beograde, 2018.

Në vitin 2019 romani botohet në Itali dhe Maqedoninë e Veriut. Në italisht përkthehet prej shkrimtarit Durim Taci: **"Ognuno impazzisce a modo suo"**. Lubrina Bramani Editore, Milano. Kurse në maqedonisht vepra do përkthehet nga Jordana Shemko, **"Sekoj poluduva na svoj nacin",** Ars lamina, e cila për momentin është në procesin e përkthimit edhe të vëllimit të dytë.

Për sa i takon rastit të përkthimit në italisht, autori, gjatë një bisede eskluzive me të, shprehet se: "Kur më erdhën kopjet e librit nga Italia, përvecse në Bibliotekën Kombëtare, ku kam kujdes të vecantë që të mos mungojë asnjë titull i imi, vendosa t'i coj një kopje edhe Ministres së Kulturës, Italianofile mendova me vete, mandej këso ngjarjesh nuk ndodhin përditë, po ia çoj. Dhe hapa librin, i shkrova një autograf si një autor i lumtur, futa në mes një kartvizitë timen, dhe pastaj të gjithën në një zarf të mbyllur, makinës dhe menjëherë te selia e ministrisë. U bënë më shumë se dy vite dhe që prej asaj kohe nuk kam as edhe një sms me tre germa "flm"."

Dhe ndërkohë që ndodhte kjo ngjarje dy ministri kulture të vendeve fqinje, si ajo e Maqedonisë së Veriut dhe si ajo e Malit të Zi, financonin botimin e këtij libri në vendet përkatëse.

Në Malin e Zi libri botohet në gjuhën malaziase, sërish me përkthimin e Danillo Brajovic, (i cili tashmë ka përkthyer edhe dy vëllimet e tjera), nga shtëpia më e madhe botuese e vendit, "Nova Knjiga".

Këtë vit, më 2022, me përkthimin e profesoreshë Russana Beyleri, libri u botua nga shtëpia botuese "Ergo" në gjuhën bullgare në Sofie, **"Vseki poludjava po svoj nacin"** si dhe në gjuhën gjermane **"Jeder wird verruckt auf seine Art".**

Në gjermanisht libri u botua nga "Transit verlag" me qendër në Berlin, me përkthimin brilant të albanologes së shquar Zuzana Finger. Libri do prezantohet më së pari në Panairin e Lejpcigut, si dhe me datë 17 Mars në mjediset e shoqatës së librashitësve gjermanë (Buchhändlerkeller, carmerstr. 1 ne Berlin-charlottenburg), në prani të mediave të shumta.

Që tani kanë filluar komentet tëpër positive të shtypit gjerman, nga të cilët po përzgjedhim cfarë shkruan revista "LifePR": "Me ndihmën e figurave të vizatuara hollësisht dhe një stili shpesh ironiko sarkastik, autori jep gjithashtu një studim brilant të situatës politike dhe të një strukture familjare arkaike, e cila mbetet e paprekur nga kufizimet politike që vijnë nga jashtë". (LifePR, Bon, 03 shkurt 2022).

Për momentin libri po përkthehet edhe në gjuhën hungareze dhe atë greke.







Feride Papleka

DASHURIA DHE FILOZOFIA

"Unë nuk dashuroja,
isha i dashuruar me dashurinë".
St. Augustin

Nëse dashuria ka frymëzuar faqet më të bukura të letërsisë, ajo nuk pati hyrë në traditën filozofike perëndimore me refleksione të veçanta. Megjithatë disa filozofë si Platon apo Jean-Paul Sartre, duke përfshirë Montaigne, Baruch Spinoza, Jean-Jacques Rousseau, Arthur Schopenhauer, Søren Kierkegaard, Martin Heidegger e të tjerë, janë shprehur për konceptin filozofik të dashurisë dhe shpeshherë kanë shkruar edhe për vizionin e tyre. Në veprat e tyre dashuria jepet si një bashkim i fortë, pothuajse një shkrirje me tjetrin. Ky pasion mund të vazhdojë tërë jetën si angazhim i vullnetit e si një dhuratë e *Unit* ndaj besnikërisë, pavarësisht se në përsiatjet e disa të tjerëve dashuria trajtohet si një tjetërsim i personalitetit. Dashuria lind vërtet nga emocioni, thonë ata, por synon zotërimin e tjetrit, skllavërimin e tij.

Ideja e bashkimit nënkupton nocionin e dashurisë së fuqishme e të përjetshme. Për filozofinë e Platonit dashuria është një përvojë pozitive që na kthen drejt *Qiellit të Ideve,* botës së dijes dhe urtisë. Në dialogët e tij, sidomos te *Fedri dhe Banketi* shfaqen vizione të ndryshme për dashurinë nëpërmjet ligjërimit të një rrethi personazhesh historikë, nxënës të Sokratit. *Eros, filia dhe agape* janë tri fjalë që përdorin ata, duke shpjeguar dashurinë dhe format e ndryshme të saj. Fedri thotë se Erosi, zot i dashurisë është themelor për jetën e secilit, ai është lidhja mes të dashurit dhe të dashurës. Dashuria e vërtetë gjithçka e bën fisnike, të kulluar. Më poetikja dhe më metaforikja në dialogun *Banketi* është teoria e Aristofanit, komediograf grek. I mbështetur te miti për androgjininë, ai tregon historinë e dy gjysmësferave të hedhura në kozmos e që lëshojnë pareshtur muzikë. Në fakt, ato në fillim kishin qenë një sferë e vetme, forma e njeriut të parë dy gjinish, që Zeusi urdhëroi Apolonin ta ndante më dysh, për t'ia dobësuar forcën, e cila kërcënonte Zotat. Prandaj njerëzit e gjorë, të hutuar nga dobësia e tyre fizike, janë përherë në kërkim të gjysmës tjetër, që të bëhen sërish të fuqishëm dhe origjinalë. Aristofani e jep dashurinë si një aspiratë për origjinën. E shtrirë në përmasën e saj madhështore, dashuria merr pjesë në dinamikën kozmike. Në këtë dialog nuk lihet mënjanë as legjenda e dashurisë së Erosit (perëndia e dashurisë) dhe Afërditës (perëndesha e dashurisë), që janë protagonistë kryesorë të dashurisë mitologjike. Sokrati, që flet i fundit si zakonisht, në ligjëratën e tij përdor fjalët që ka dëgjuar nga Diotima (një priftëreshë e famshme e kohës) për Erosin si i biri i varfërisë dhe i pasurisë (Penia dhe Porosi). Dëshira për dashuri fsheh dëshirën për përjetësi. Si përfundim Sokrati e përshkruan Erosin si një qenie të ndërmjetme : edhe vdekëtare, edhe e pavdekshme. Në fund të fundit, dashuria fsheh dëshirën për pavdekësi dhe vetëm dialektika është metoda që shkallë-shkallë lejon ta mbërrish. Në dashuri vlerësohet bukuria shpirtërore, si pasuria më e madhe e personalitetit, e mbyll ligjërimin Sokrati.

Aristoteli arrin ta përgjithësojë ndryshimin midis Erosit dhe formave të tjera të dashurisë, duke i dhënë vlera filias (philia, gr.). Filia ideale, sipas tij, është ajo që bashkon si kërkim i së mirës për tjetrin pa lypur asnjë shpërblim. Brenda idesë së dashurisë, filozofi ndërfut idenë e kundërvënies që qëndron midis dashurisë për Unin dhe dashurisë për tjetrin. Ai e zgjidh këtë kundërvënie me idenë se dashuria e mirëmenduar për *Unin*, është e lidhur me shpirtin, madje me pjesën sipërane të tij, me zemrën. Sipas Aristotelit, *Uni* i dytë ose tjetri quhet « alter ego », dhe merr rëndësi të dorës së parë për të hedhur dritë mbi personalitetin.

Empedokli e imagjinonte dashurinë gjithnjë me të kundërtën e saj, me mërinë. Dashuria dhe mëria, shkruan ai, janë dy forca origjinale të qenies njerëzore. Për të, dashuria që bashkon e mposht të kundërtën e saj, mërinë që ndan.

Për t'iu përgjigjur pyetjes se « a është njeriu burim i dashurisë, apo dashuria është një koncept natyror që i imponohet njeriut ? », filozofi Baruch Spinoza, i cili e ka shqyrtuar këtë temë, sidomos te libri *Etika*, thotë se dashuria nuk është gjë tjetër, veçse një gëzim që shoqërohet me një shkak të jashtëm dhe se ai që dashuron përpiqet ta ruajë të pacenuar dashurinë e vet. Arthur Schopenhauer-i, i frymëzuar nga budizmi kalon në një pesimizëm metafizik kur mendon se meqë dashuria na ndihmon të hyjmë në një cikël kozmik që përsëritet pa pushim dhe në një cikël vuajtjesh që çojnë në një unitet pavetor, a nuk është më mirë të hiqet dorë prej dashurisë dhe dëshirave ? Për më tepër ai shkruan se dashuria është një iluzion i pushtetit, dhe vullneti për pushtet është esenca e çdo gjëje, e cila përkufizohet si një dëshirë e pakushtëzuar e një specieje për të mbijetuar dhe për të siguruar vazhdimësinë përmes riprodhimit.

*

Si koncept i përgjithshëm, dashuria është ndjenjë e thellë që paraqitet në shumë forma dhe vepron si një faktor kryesor i marrëdhënieve shoqërore duke zënë një vend qendror në psikologjinë njerëzore. Qysh nga Rilindja europiane filozofët filluan ta trajtojnë temën e dashurisë përmes veprave letrare të autorëve si: Dante, Petrarka, Ronsard, Goethe, Rousseau, Stendal e të tjerë. Jacques Derrida e ka trajtuar temën e dashurisë duke analizuar veprat antike. Edhe Emmanuel Levinas e ka shteruar këtë temë sidomos në librat e tij *Le Temps et l'autre* dhe *Totalité et Infini. A*i e vlerëson etikën e marrëdhënieve dashurore si "filozofia e parë e njerëzimit".

Simbolizmi i etikës në dashuri ishte si një tronditje e vërtetë në filozofinë racionaliste perëndimore. Nga fundi i gjysmës së dytë të shekullit XX shfaqet edhe një koncept kënaqësie (hedonist) i dashurisë përmes lëvizjes *hippie* (kundërshtim i shoqërisë së konsumit dhe vlerave tradicionaliste): « Të jetosh me dashuri dhe me ujë (mali) » ; « As luftë, as punë, por vetëm dashuri » ; « Peace and Love ». Në këto parulla përzihen së bashku kënaqësia e joshjes, e erotizmit dhe e argëtimit konkret erotik, të cilat lidhen me një moment ndryshimi të madh që solli revolucioni teknik.

Shën Agustini në kabinetin e punës, Botticelli
Afresk i vitit 1480 në kishën Ognissanti të Firences

Koncepti i pritjes në dashuri dhe filozofia

Aspekt i pritjes ka çuar që dashuria të vështrohet nga pikëpamja e « përfaqësimit » të lidhur me *Unin,* që nuk dëshiron gjë tjetër , veçse të kënaqë vetveten. Megjithatë, përvoja e dashurisë së vërtetë karakterizohet nga dhimbja e pritjes, theksojnë filozofët e rinj. Për sa i përket shkakut të pritjes, ata thonë se « ajo është vetëdija », natyra e jetës, parimi themelor i saj. Dashuria krijon vetëdijen për një « pritje të pakufizuar të tjetrit ». Domethënë që objekti i pritjes nuk do të ishte thjesht një person, por një vrull apo një dëshirë abstrakte. Së pari pritja, ajo që na shtyn drejt së ardhmes ngjall një « dëshirë për aventurë ». Kështu dashuria do të jetë një « shumëfishim i mundshëm i vetvetes », në mënyrë që nëpërmjet personit që dashurojmë, mund të shohim një farë premtimi për jetë të ndryshme. Në këtë kuptim flitet për « dashuri » përmes metonimisë, domethënë ne nuk do të donim një person më shumë për atë vetë, sesa për përvojën që ai do të na krijonte për të jetuar. Së dyti, çdo pritje përbën në vetvete një dëshirë për absoluten ; pra dashuria është gjithnjë një e fshehtë për pritjen e absolutes. E thënë ndryshe, dashuria është një zbulim në kuptimin që duke bashkuar ndjenjën e plotërisë me shpresën për të përjetësuar çastin, lejon synimin e absolutes. Së treti dashuria është një përgjigje ndaj pritjes së tjetrit. Kësisoj ne kemi më shumë kënaqësi kur japim, sesa kur marrim. Ky konfigurim i pritjes vendos në kontrast dy rregullat që e karakterizojnë ekzistencën tonë : përfaqësimin dhe jetën. Nga njëra anë është « përfaqësimi » që gjithë duke bërë me vetëdijen tonë dashurinë si qendra e botës, na bind « se ekzistenca jonë e vërtetë", varet nga perceptimi që të tjerët kanë për ne. Në këtë kuptim, ajo që do të donim te tjetri është dashuria që na sjell ai. Nga ana tjetër, është « jeta », ajo që « mbetet brenda një individi si një çelës për të komunikuar». Dhe, duke marrë pjesë në mundësitë dhe forcën e një jete, ne e ndiejmë edhe më tepër jetën tonë. Të dashurosh, do të thotë të gjesh edhe një qendër jete jashtë vetes. Dashuria në formën e saj më të përkryer vihet re kur « secili beson se ka marrë shumë nga tjetri dhe i vë si qëllim vetes ta ndriçojë këtë fakt».

*

Përveç dallimeve kulturore në praktikat e lidhura me dashurinë, idetë dhe përfaqësimet për dashurinë kanë ndryshuar sipas epokave. Dashuri platonike, dashuri Oborri, dashuri romantike janë kështu konceptime të dallueshme dhe janë shfaqur në periudha të datuara të Historisë. Dashuria platonike e ka marrë emrin nga filozofi grek, Platon. Nuk është fjala për ndonjë teori të formuluar nga Platoni, por për ide të shtruara te dialogët *Banketi, Republika, Fedri* që flasin për një dashuri ideale, për një dashuri idesh. Dashuria platonike karakterizohet edhe nga marrëdhëniet në largësi që vlerësojnë më tepër cilësitë e personit se sa personin vetë. Përgjithësisht ajo shoqërohet me një lloj ëndrre dhe fantazmash, në të cilat dëshira për të qenë me personin e dashur vjen me një ndjenjë trishtimi. Një nga të ftuarit e librit të famshëm *Banketi* të Platonit, flet për një dashuri të kulluar, fisnike, pothuajse qiellore e cila si objekt ka shpirtin dhe jo trupin.

Gjatë Rilindjes dashuria platonike u shndërrua në një konceptim filozofik kur

dijetari i madh fiorentin Marcile Ficin përdori i pari shprehjen *amor platonicus*, duke iu referuar dialogut *Banketi* të Platonit dhe pikërisht fragmentit kur Sokrati përshkruan lartësimin e ndjenjave nga dëshira e thjeshtë për një njeri deri në soditjen sublime.

Poetët romantikë e kanë vendosur dashurinë platonike në piedestal. Kjo formë romance do të ishte trajta më e kulluar dhe më e pafajshme e dashurisë. Ndjenjat aty zënë një vend shumë të rëndësishëm. Ndjenja e epërme e njeriut e zhveshur krejtësisht nga përmasa fizike, ka diçka të përjetshme. Ajo i afrohet përsosjes. Është një bashkim shpirtëror midis dy qenieve njerëzore.

Psikanaliza me studimet e çmuara të Freud-it për nënvetëdijen, transfertin (mbartje me ndryshime) dhe proceset e tjera psikike te njeriu në fillimet e shekullit XX, e me seminaret e Jacques Lacan-it në Collège de France në vitet '50 dhe '60, ka ndihmuar që të përpunohet në mënyrë më të gjerë koncepti filozofik i dashurisë. Por fillimisht ka qenë psikologjia evolucioniste që ka guxuar të hedhë dritë mbi një temë kaq delikate e të pashtershme.

Dashuria për filozofinë e shekullit XXI

Dashuria, subjekt qendror i jetës njerëzore, objekt i parë i letërsisë dhe arteve qysh prej Antikitetit, është bërë një objekt filozofik me shumë përgjigje në shekullin e ri. Megjithatë, edhe dashuria përballë çmagjepsjes së përgjithshme të botës, është reflektuar në zhvillimet e fundit të mendimit filozofik. Filozofët bashkëkohorë, në kërkim të ideve të reja të artit për të jetuar, kanë krijuar lidhje të panjohura më parë me traditën e hershme filozofike. Si mund të arrijmë në një « jetë të jetueshme » në një botë që transformohet vazhdimisht, duke filluar me ndarjet e mëdha të diktuara nga një « kundër-kulturë » ose *postkulturë*. Prej këndej vjen edhe pyetja tjetër: si shfaqet dashuria në skenën e historisë aktuale? Kërkimi i dashurisë nënkupton edhe kërkimin e lumturisë dhe urtisë: Ja përse në esetë dhe librat bashkëkohorë ka edhe krahasime të konceptimeve të dashurisë në epokën antike. Krahasimet fillojnë me Platonin, për të cilin dashuria ishte « një marrëzi hyjnore », apo me Lukrecin për të cilin dashuria ishte « e vetmja e vërtetë e trupit », pastaj ato vazhdojnë të vënë në dukje dallimin mes koncepteve idealiste të A. Comte-Sponville-it dhe materializmit ateist të Michel Onfray-it. L. Ferry mendon se ne kemi hyrë në një epokë të re të mendimit, në të cilën dashuria është bërë paradigmë qendrore. Në librin *La Révolution de l'amour (* 2010), ai hedh një vështrim panoramik mbi historinë e mendimit filozofik perëndimor për dashurinë, dhe ndër të tjera shkruan : « Sot dashuria si temë qendrore e të gjitha përsiatjeve dhe studimeve shoqërore, iu jep kuptim jetëve dhe angazhimeve tona ». Duke përshkruar sesi kanë ndryshuar mendësitë për të shenjtën dhe tabutë e shekujve të shkuar, ai nxjerr këtë përfundim : « Parimet e mëdha themelore në planin etik, *politik dhe metafizik që përbënin historinë e Perëndimit, si kozmosi i Grekëve, Zoti i hebrenjve e i të krishterëve dhe madje subjekt metafizik i humanizmit të parë, u goditën në shekullin XIX" (f. 98). Tronditjet shoqërore të shekullit XX me transformimet sociale dhe emancipimin e përgjithshëm, sollën një shoqëri individualiste që u ndihmua nga zhvillimi i shpejtë i kapitalizmit liberal dhe i shoqërisë së konsumit në shekullin XXI.*

Në ditët tona njeriu është i etur për dashuri, edhe pse bie shpesh në krahët e dyshimit dhe pasigurisë. Filozofët thonë se adhurimi për dashurinë nuk ka qenë kurrë më parë një « kredo kaq e fortë ». Me gjithë se jetojmë në epokën e mosbesimit dhe të ndarjeve në masë, magjia e dashurisë është e pavdekshme.

VALLET E NGRIRA

tregim nga Enver Kushi

Ajo ishte një vjeshtë me qiell gri të hapur, monoton e të përgjumur. Ishte qiell pa ulërima dhe i palëvizshëm, sikur kishte vite që qëndronte ashtu mbi qytezën e vogël në Jug të vendit.

Qyteza e vogël në Jug të vendit shtrihej në faqen e një kodre të lartë, ndërsa në këmbët e saj ishte fusha e kuajve, nga edhe e kishte marrë emrin qyteza.

Dimrat këtu ishin të butë. Ata kalonin shpejt, pa u ndjerë, me ca ditë shirash dhe erëra të ftohta, që dukeshin qesharake me ato të thellësive të vendit.

Dëbora apo ditët me ngrica jo vetëm ishin të rralla, por kishte breza që nuk i kishin parë asnjëherë ato.

Qyteza, që kishte marrë emrin nga fusha e kuajve, kishte valltarë të famshëm. Edhe po të kapërcejë vendin e quajtur Qafa e Botës apo malin pranë qytezës e të shkojë më në Jug, përtej lumenjve Kalama dhe Aheron, do njiheshe me valltarë të tjerë me emër...

Fisi i dëgjuar i Takajve kishte pesë valltarë. Fisi i Hodajve katër. Fiset e tjerë nga dy a më shumë...

Në dasma, por edhe në ditë të zakonshme, në oborret e rrethuara me avlli guri, rrugica apo sheshin e vogël në qendër, vallet shpërthenin papritur. Ishin ca valle herë të vrullshme, me ulje dhe ngritje të shpejta, me goditje të forta të këmbëve e duarve në tokë dhe herë- herë të qeta, me lëvizje të ngadalta, që të kujtonin qetësinë e muzgjeve dhe qiejt e kaltër të pranverës...

Kishte mbi dy javë që vazhdonte shtegtimi i zogjve. Herë-herë zogjtë shtegtarë të lodhur nga udha e gjatë e qiellit, uleshin mbi ullinjtë dhe drunjtë e pyllit pranë qytezës..

Pastaj nuk kaluan më zogj. Mbeti vetëm qielli gri dhe i palëvizshëm.

U volën ullinjtë dhe javën e fundit të vjeshtës së tretë, nisën punën lutërvitë. Vaji i ullint rridhte me përtim nëpër ulluqet prej druri. U mblodhën vargjet e thatë të fiqve dhe plakat vunë nëpër sënduqe ftonjtë dhe shegët.

Pastaj u bë edhe dasma e fundit. Sazexhinjtë erdhën në orët e vona të të hënës dhe dasma nisi të nesermen, në të dalë të ditës së martë.

Ditën e tretë të çeljes së dasmës, pritej të vinte valltari i famshëm Selman Taka, i njohur jo vetëm në qytetin e vogël, por edhe në qytetet dhe fshatrat përtej lumenjve Kalama e Aheron.

Valltari i famshëm nuk erdhi as atë natë dhe as natën tjetër. U fol se ai ishte i sëmurë rëndë..... Pati zëra që thanë se ai ishte ftuar në një dasëm tjetër përtej Qafës së Botës, në një fshat pranë lumit Kalama....

Lëvizën retë gri dhe qielli i çliruar prej tyre, u duk më i plotë, veçanërisht në netët me yje të mëdhenj.

Pastaj erdhi lajmi se Selman Taka ishte kallkanosur. Si kallkanosur? E mora vesh mirë. Ma tha djali i tij. Ka ngrirë nga mesi e poshtë Selmani. Nuk lëviz dot, më tha.

Nata e fundit e dasmës nisi me një kaba në të qarë. Sazexhinjtë e ardhur nga Janina, u ngritën në këmbë dhe klarinetisti i gjatë, pasi vështroi i bëri një shenjë violinistit e kur ai ju afrua pranë diç i tha në vesh. Pastaj klarinetisti preku me majën e buzëve klarinetën dhe shfryu bulçinë e majtë... Pastaj ngriu ajri i mbrëmjes. Edhe fusha e kuajve. Edhe ullinjtë. Edhe erërat. Edhe ndriçimi i largët i yjeve... Pastaj u dëgjua defi, që dukej sikur trokiste për të çelur dyert e dhimbjes. Erdhi violina që i çeli menjëhere dyert e dhimbjes.... Dhe kur defi pushoi dhe mbetën në ajër tingujt e violinës, u dëgjuan tingujt e vetmuar të klarinetës.

Dhimbja ishte atje. Mund të zgjasje duart për ta prekur atë. Atje ishte edhe valltari Selman Taka, zhytur në botën e dhimbjes. I ngrirë. Me duar që i lëvistë nëpër ajrin e natës dhe me këmbët e ngrira. Ishte një kaba në të qarë për Selman Takën dhe vallet e ngrira.

Muaji i ri nisi me drapërin e hollë të hënës. Ai u shfaq në perëndim të diellit, rrethuar me një lëm të madh.

Pastaj nisën të frynin erërat e forta. Ato sollën një qiell me ulërima, re të trazuara dhe ëndrra. Ishin ca ëndrra me të vdekur, valltare të ngrirë, ujëra të turbullta që përmbytnin fushën e kuajve, peshq të ngordhur nëpër shtretërit e tharë të lumenjve Kalama e Aheron....

Pushuan erërat. Edhe ulërimat e qiellit pushuan.

Kaluan Qafën e Botës tufat e dhënëve të kolonjarëve dhe vllehët e Gramozit, për të dimëruar fushave të Frarit, brigjeve pranë Gumenicës apo Pargës e Prevezës.

Ajo erdhi e beftë, duke zbritur në të gdhirë prej një qielli të ulët... Bora mbuloi jo vetëm qytezën, por edhe fushën e kuajve si dhe Qafën e Botës.

Në mesditë, nga Qafa e Botës nisi të fryjë erë e ftohtë, që e kallkanosi menjëherë dëborën. Dhe kur era pushoi, në qendër të qytezës erdhën dy kalorës. Ata kërkuan ujë për kuajt e pasi u dhanë ujë kuajve, u larguan.

Ndoshta lajmin për ardhjen e tyre në qytezë e sollën kalorësit... Ndoshta ndonjë udhëtar tjetër, ardhur nga larg. Lajmi u përhap menjëherë...

Të huajt pritej të vinin pas dy ditësh. Ata vinin nga Evropa dhe do të merreshin me vendosjen e sinoreve të kufirit.

Ndërroi prap qielli. Vdiq plaka Hazbo. Ishte 106 vjeç.

U mblodh pleqësia e qytezës ku u vendos që të nxireshin nga sunduket veshjet e vjetra. Të vishen edhe gratë, edhe nuset e reja, edhe fëmijët me to.

Asnjë lajm për Komision e Kufirit. U fol për djegie nuri në të dalë të qytezës. Një flakë si në të gjelbërt ngrihej në vendin e quajtur kroi i Pirros... Flaka e gjelbër u shfaq edhe në bokërrimat pranë Qafës së Botës.

Ata mbrritën në qytezë orët e para të mengjesit. U zbritën karrocave në qendër dhe zunë vend në hanin e madh.

Takime me banorë të ndryshëm. Shënime. Mbajtur në jug të Shqipërisë. Ata na shohin me vëmendje dhe fëmijët e tyre, si dhe gratë janë veshur me kostume popullore. Duken të nervozuar, veçanërisht të moshuarit. E pyes për moshën. Tha se nuk e mbante mend... Pastaj me një nervozizëm të dukshëm tha se atje edhe gurët flisnin shqip. Edhe era këndon shqip. Edhe kalldrëmet dhe ullinjtë vallëzojnë shqip. Edhe tutje, matanë atyre maleve, flasin si ne.

Fjalët e dy fëmijëve të vegjël: gluha, nana, klumusht... Babai dhe gjishi...

Në ç'muaj jemi? Përgjigjmu të thom. Në ç'muaj jemi? Tri herë ka ndërruar qielli. Tri herë është shfaqur nuri te Kroi i Pirros. Në ç'muaj jemi?

Ra borë dhe qielli ndërroi prap.

Në mëngjes ajo pushoi, por qielli mbeti po ai: gri dhe i ulur.

Mbaruan hetimet për caktimin e sinorëve të kufirit. Anëtarët e komisionit dolën në qendër të qytezës. Në qendër të qytezës dolën edhe shumë banorë dhe fëmijë. Fëmijët ishin veshur me kostume popullore, ndërsa shumë pleq kishin vënë në kokë festet me bisht.

Valltari Selman Taka i foli djalit të vogël. Djali i vogël hyri menjëherë në dhomën ku lëngonte valltari. Ai shtangu kur vuri re të atin ngritur përgjysmë. Valltari i tha të birit të afrohej. Pastaj duke i zgjatur krahët i tha se donte të ngrihej. Imzot, tha i biri. Ç'bën imzot? Ngremë. Ndihmomë të ngrihem. Imzot... Ndihmomë të thashë, foli me zë të lartë Selman Taka. Do vete atje ku vendosen sinoret....

Folu edhe vellezërve. Folu shpejt. Do u thom atyre se këtu e matanë është Shqipëri.

Më lëshoni, u tha djemve Selman Taka. Eci vetë tani. Ai nisi të ecë ngadalë. Tokën e prekën në fillim majat e gishtërinjve e pastaj u bë njësh me tokën. Një drithërimë e lehtë u ndje që nga poshtë shputave të këmbëve. Toka ishte e ftohtë, e lagësht e vende – vende e bardhë Dum-dum. Dum-dum. Tingujt e violinës dhe defi. Pastaj tingujt e klarinetës. Edhe zëra. Zërat nuk vinin nga turma e njerëzve, që shihnin gati si të ngrirë valltarin Selman Taka. Ishin zëra dheu. Vinin nga thellësitë e jo nga qielli, sepse qielli ishte i verbër dhe i pagojë.

Ata që ishin atje panë se si valltari, pasi ngriti kokën lart, zgjati këmbën e djathtë përpara dhe duke lëvizur me një shkathtësi të çuditshme krahun në ajër, përkuli trupin përpara dhe befas u ngrit i tëri në ajër... Ai po kërcente. Trupi i tij sikur nuk ekzistonte më. Ai ulej në tokë, përplaste në të me forcë duart e ngrihej vërtik lart. U jam këtu. Këtu në dheun tënë. Mos vini sinore këtu. Mos na e ndani shpirtin....

Ajo ishte një vjeshtë me qiell gri të hapur, monoton e të përgjumur. Dhe kur ajo shkoi, ndërruan qiejt dhe erdhën stinë të tjera me ca gurë sinoresh që ndanë shpirtëra njerëzish.

Paolo Fabbri (1939-2020)

ZADIG DHE UJKU OSE SEMIOTIZIMI I GJURMËVE

Përktheu nga italishtja: Brikena Smajli

1. Metoda Zadig

Çdo zoosemiologu për identifikimin e gjurmëve të kafshëve i kërkohet të njohë metodën Zadig. Umberto Eco-ja e ekspozon atë teorikisht në paragrafin e titulluar "*Nallane*" të librit të tij "*Kufijtë e interpretimit*" (1990). Këtu Eco-ja sjell fjalë për fjalë kapitullin e tretë të librit të Volterit, Zadig, që ripërpunonte tregimin e parë të shkurtër të "*Pelegrinazhit të tre djemve të vegjël të mbretit të Serendippo*", përkthyer në mesin e shekullit të gjashtëmbëdhjetë në Venedik. Një tekst i ringjallur në 1754-ën nga Horace Walpole-i, i cili shpiku termin *"serendipity"* për "*zbulime të papritura, të bëra falë rastësisë dhe inteligjencës*".

Përralla filozofike e Volterit rrëfen për zgjuarsinë e këtij personazhi, Zadig-ut, që deshifron pa i parë kurrë më parë gjurmët e lëna prej një qenusheje dhe një kali, duke i përshkruar ato me saktësi të përpiktë. Një aftësi gjuetie kjo që në vitin 1979 e kishte shtyrë Carlo Ginzburg-un, të shihte origjinën e një paradigme treguese të përdorur më pas nga romani detektiv (Poe, Gaboriau, Conan Doyle) dhe zbatuar për gjuetinë, parashikimin dhe gjurmët e gishtërinjve, por mbi të gjitha në historinë e artit dhe të shkencave natyrore. Ashtu si Cuvier, i cili ishte në gjendje të rindërtonte të gjithë kafshën nga gjurma që lë shputa e këmbës "*me më shumë besim se Zadig-u*", dhe Thomas Huxley që, duke popullarizuar teorinë darviniane në 1880-ën, iu drejtua metodës Zadig, për të formuluar në retrospektivë profeci të rrepta.

Eco-ja, i cili e vendosi kërkimin e tij nën stemën e ornitorinco/ sqepori-t, i shoqëroi tipologjitë e tij semiotike me vepra narrative të fiksionit, testimit dhe eksplorimit si *Eksperimenti i Gedanken*. Paragrafi me Zadigun në fakt merret në ditën e parë të *Emrit të Trëndafilit* (1980), ku deveja e përrallës së lashtë orientale bëhet Brunello, kali i abatit të manastirit. Është Gulielmi i Baskavillës ai që me "*mendjemprehtësi të madhe*" merr rolin e Zadigut, i cili "*kishte studiuar vetitë e kafshëve dhe të bimëve dhe kishte fituar një mendjemprehtësi që e bënte të zbulonte një mijë dallime aty ku njerëzit e tjerë shihnin vetëm uniformitetin*" (Volteri).

Në njohjen e gjurmëve të kafshëve, ka dallime domethënëse midis rrëfimeve të Volterit dhe të Eco-s. Zadig-u i përgjigjet mjeshtrit të gjuetisë që ndjek kalin duke zbuluar me "aftësi dalluese të thella dhe delikate" gjurmët dhe shenjat në rërë që e çojnë të njohë karakteristikat dhe drejtimin e kafshës që nuk e ka takuar kurrë. Edhe detektivi francezkan i *Emrit të trëndafilit* njeh fizionominë e kalit të ikur në dëborë, duke u nisur nga gjurmët natyrore "*me të cilat bota na flet si një libër i madh*", këtyre u shton gjurmët tekstuale, për të zbuluar, p.sh., se emri Brunello vjen nga përshkrimi i shkruar nga filozofi Buridan. Versioni ekian e orienton semiotikisht rrëfimin: ai bëhet kali i tij i betejës. Ndërsa Zadig-u volterian sheh, shënon, kupton, njeh, mëson, dhe më në fund gjykon, At Guglielmo "përkap" nga ajo që "thonë shenjat", duke e orientuar rrëfimin drejt teorisë përfundimtare të Rrëmbimit. Për Eco-n dhe mentorin e tij në atë kohë, Thomas A. Sebeok, Zadigu, "*i interesuar për natyrën si një sistem i kodifikuar shenjash*", "*kërkon marrëdhënie të përgjithshme të kuptimit*" në një mënyrë logjike, përmes konkluzioneve-deduktive sinekdotike dhe hipotetike të zbatuara në gjurmët e lëna nga kafshët.

Duke u nisur nga një gjurmë tipike, e lexuar si një seri udhëzimesh, Zadig-u dhe Guglielmo-ja do të njihnin dukurinë (*token*) që është *gjurma* e kalit, duke e interpretuar atë në dritën e shkakut fizik që e shkaktoi. Për Eco-n (1990), Volteri do të na e kishte paraqitur këtë në rastin më të parë të prodhimit shenjor, por edhe me "*shprehjen treguese*" vizuale të simptomave të thjeshta dhe/ose të ndërlikuara, domethënë, të dhëna të së shkuarës, pranisë aktuale ose të mundshme të agjentit "*gjurmues*". Këto do të ishin rrëmbime të hipokoduara të cilat, të gdhendura në një seri të lidhur, lejojnë "*identifikimin e një teme tekstuale (e cila) është një rast i përpjekjeve rrëmbyese të hipokoduara*". Synimi është të gjesh kodet e konvencioneve të përgjithshme ndërtekstuale, pra *kornizat* që të lejojnë të ushtrosh një «*instinkt hyjnor*", për të arritur rezultate të besueshme tekstualisht përmes një gjykimi teleologjik. Me dhuntinë e Sherlock Holmes-it, dy *detektivët* e të drejtave të kafshëve, Guglielmo dhe Zadig-u, hamendësojnë, domethënë hipotezojnë dhe krijojnë botë reale të mobiluara siç duhet, nga të cilat mund të zgjedhin më të mundshmen: ata janë në pragun e rrëmbimit krijues dhe meta-rrëmbimit për të vënë bast për rezultatin përfundimtar, pa pritur për kontrolle të ndërmjetme.

Personazhet romaneske kanë dhunti aftësi të qendrueshme dhe të vlerësueshme rrëmbyese; ata nuk gabojnë kurrë në zbulimin dhe interpretimin e gjurmëve të kafshëve, përkundër "*gabueshmërisë*" së Charles S. Peirce-it, për të cilin njohja nuk është kurrë përfundimtare dhe "*noton, si të thuash, në një vazhdimësi pasigurish dhe papërcaktueshmërish*". Megjithatë, ky nuk është rasti i *Emrit të trëndafilit*: ushtrimi i sigurt i detektorit të gjurmëve të kafshëve - që te Zadig-u ka rezultate negative shoqërore - sfidohet nga natyra konfliktuale e *historisë detektive*, në të cilën fajtori ka strategjinë e tij të kundërlëvizjeve mbuluese. Përfshirë këtu vazhdimin e krimit, të kryer për të kënaqur një rrëmbim të parë të gabuar nga *detektivi* francezkan. Për rrëfimtarin Eco, vrasësi i ndjekur lë gjurmë të llogaritura dhe mashtruese, ndërsa kali shpërndan gjurmë të paqëllimshme, të përdorshme për procedurat njohëse të zbulimit dhe ushtrimit hermeneutik të ndjekësit të gjurmës.

2. Gjurma: ekskursus semiofilozofik

Përpara se të nisim një reflektim mbi sistemet dhe proceset e njohjes së shenjave të kafshëve, është me vend që të zhvendoset kërkimi semiotik mbi gjurmët e kontekstit filozofik, të dashur për Eco-n dhe për disa përfaqësues të semiotikës interpretuese. Filozofia e gjuhës ka një raport të përafërt me shkencat semiotike, të cilat shpesh i zgjidh me liponimi, duke shmangur sistematikisht çdo referencë apo citim. Nga ana tjetër, duke u përballur me nocionin e dokumentimit, të cilin ai e konsideron "*të pandryshueshëm*", Maurizio Ferraris (2009) ka trajtuar emrin e Iknologjisë në një doktrinë të përgjithshme të gjurmëve, me ontologjinë, strukturën dhe kuptimin e tyre. Një plan ky teorik që hamendësohet si rregullator në lidhje me semiologjinë dhe skematizmin, pra doktrinën e shenjës dhe teknikën e zbatimit praktik të koncepteve. Psikologjia do të varej gjithashtu nga kjo teori e përgjithshme e gjurmëve: funksionimi i brendshëm i mendjes në lidhje me funksionin e shenjës dhe me atë realitet shoqëror në të cilin do të qëndronte rëndësia socio-politike e semiologjisë. Me gjurmë Ferraris (*vep. Cit.*) - që shmang me përpikëri çdo referencë për kërkimin semiotik - nënkupton çdo "*formë modifikimi të një sipërfaqeje që shërben si shenjë ose si kujtesë për një mendje të aftë për ta mësuar atë si të tillë*".

Fig. 1. Dolone. Detaj i një Lekythosi të Atikës me pamje të kuqe, 460 a.C., Paris, Luvër

Prandaj nuk do të kishte "*gjurmë në vetvete, por vetëm mendje (ose kafshë) të afta për t'i njohur ato*"; të qenit gjurmë është karakteristikë relacionale e një entiteti natyror në funksion të referimit në diçka tjetër. Cilësia i tij ontologjikisht e rëndësishme do të qëndronte në një vlerë dhanore të shenjës (për dikë) dhe jo në atë kallëzore (diçka). Një gjurmë natyrore ose artificiale, kur është unike dhe e pazëvendësueshme, do të kishte vlerën e një "*gjurme*" me më shumë autonomi ontologjike, ndërsa do të ishte një "*regjistrim*" më i theksuar epistemologjik kur "*mësohet nga pikëpamja e kuptimit, pra ka një vlerë të qëllimshme për mendjen që e sodit*".

Iknologjia e Ferraris-it është e lexueshme si një semiotikë që udhëton nën një flamur tjetër, pra është një teori e përgjithshme e semiozës në të cilën përkufizimi i shenjës varet nga modeli peircian dhe ekian i referencës *aliquid stat pro aliquo*, i cili përmbledh traditën logjike klasike nga Thomas Aquinas te Eco.

Ndërpërkufizimet interpretuese të propozuara nga Eco - emri i të cilit shfaqet vetëm në disa shënime të shpërndara në fund të *Dokumentacionit* - nuk merren parasysh.

Kështu ndodh edhe me *trendin* shekullor sausurian mbi sistemet e shenjave. Megjithatë, për Ferraris, ky model hierarkik përmbledhës - iknologji, semiologji, gjurmë, regjistrim - i bazuar në njohje dhe jo në emërtim (*hamendësim*), do të përbënte një alternativë neorealiste ndaj kthesës gjuhësore dhe semiotike, duke gjurmuar gjithashtu "*shoqëritë e kafshëve, të cilat nuk kanë gjuhë të artikuluara, por janë të pajisura me përpikëri me rituale dhe sisteme të shënjimit të territorit*".

2.1 Zoematika: gjurmimi dhe drejtimi i gabuar

Pistage au large c'est lire tout les signes (=*Gjurmimi është leximi i të gjitha shenjave*) (Morizot). Empirizmi i ri shkencor, i cili parashikon një kthim jo në tokë, por nga toka, propozon një kontratë të ndryshme natyrore midis bio- dhe semiosferës: përjashtimit njerëzor i kundërvë atë shtazor dhe synon të natyralizojë njeriun dhe të shoqërizojë natyrën. Kështu, shfaqen orientime të reja epistemike dhe praktika të reja për hetimin e semiozës së kafshëve nga një kërkim më i interesuar për kuptimin sesa për shkaqet dhe propozimet e një kontrate të re «natyrore» (Serres) dhe të një parlamenti të kujdesshëm njerëzor dhe jo njerëzor (Latour).

Meqenëse Lévi-Strauss-i i përcaktoi zoemat si «*specie kafshësh të pajisura me një funksion semantik*», mund të sugjerohej neologjizma Zoematike për studimin e mekanizmave nënkuptues të ndërveprimit komunikues. Për von Uexküll-in, në fakt, "*nuk ka objekte në natyrën e gjallë në kuptimin e ngushtë, por vetëm subjekte bartës të domethënies që vendosin marrëdhënie kuptimore ndërmjet tyre*".

Me këtë pikëpamje, studimet primatologjike kanë ripërcaktuar në mënyrë të konsiderueshme objektivitetin adamik të identifikimit dhe emërtimit të specieve. Në veprimtarinë e fundit etologjike, për t'u njohur, kafshët duhet jo vetëm të identifikohen, por edhe të njihen dhe të kuptohen. Ky nuk është një universalizëm i nxituar dhe tolerant - shtrirja e të drejtave të njeriut tek kafshët më të larta! - por i një antropologjie reciproke që na bën të ndjeshëm ndaj asaj që ata janë të ndjeshëm dhe të mendojmë me ta edhe nëse jo si ata. Pra, të bëjë dhe të bëjnë pyetje të cilave ata mund t'u përgjigjen në mënyrë aktive. Nëse njohja e inteligjencës do të thotë t'i kushtosh vëmendje tjetrit dhe ta lësh veten

të ndikohet nga ajo, edhe laboratori nuk është domosdoshmërisht një vend pastrimi dhe sakrifice, por një pikë kontrolli e afërsisë kritike, një hapësirë negociuese e kuptimit.

Reflektimi semiotik për gjetjen e gjurmëve të kafshëve vendoset në këtë kontekst epistemik dhe kozmopolit; ai përdor njohuritë e kulturës antike të gjuetisë si një praktikë hermeneutike dhe gjeopolitike të shkëputur nga dimensioni grabitqar. Ai merr, nëse jo distancohet, të paktën njëfarë lehtësie nga kërkimet pioniere të Bateson (për delfinët) dhe Sebeok (për kalin, *Hansin e zgjuar*), për karakterin e ndërtuar të gjurmës dhe përbërjen e aktorëve të gjurmuar dhe gjurmues, pra nga ata që vazhdojnë të lënë shenja për ata që i ndjekin. Për ata që udhëtojnë përgjatë një piste, gjurmët janë të panjohura, ato lipset të përcaktohen në mënyrë të ndryshme për pozicionet e tyre paradigmatike dhe sintagmatike. Ndërsa metoda Zadig ka të bëjë me përfundimin që nis me gjurmët e marra si të mirëqena, semiologu gjenerativist beson se, për t'u hamendësuar, ato duhet të përcaktohen. Shenjat sausuriane - binarizmi i pandashëm i shenjuesit dhe të shenjuarit - mund të zbulohen, identifikohen dhe njihen vetëm duke modeluar interpretimin e tyre.

Ky është veprim i njohur si *Pistare* (ang. *Tracking*, nga fr. *Trace*) - dhe *depistare*; nënkupton *n*djekjen e kafshës duke zbuluar qenien dhe veprimin e saj, identitetin dhe zhvillimin e saj, duke e shndërruar padukshmërinë e saj në një prani, virtuale ose reale. Të gjurmosh, të hetosh (*vestigium* është gjurmë), të gjurmosh kafshën do të thotë ta takosh atë me ndërmjetësimin e shenjave, siç nuk reshtin së na kujtuari autorët e shumtë që janë marrë me të.

Duke u nisur, në radhë të parë, nga vetitë thelbësore që shfaqin shprehjen e tij. Dëbora, për shembull, në romanin e Eco-s, mban gjurmën e kalit më shumë se rëra dhe pluhuri i Volterit, sepse ngjeshja e putrës ngjesh sipërfaqen e shkelur dhe vonon shkrirjen e saj. Më pas, në përfundim të procesit të njohjes, nga një analizë krahasuese me shenja të tjera që i përkasin të njëjtit sistem apo grupeve të tjera shenjash, mund të caktohen me dëshirë emra për pasurimin e aftësive tona analitike dhe të njohurive reciproke.

Një vëmendje ndaj shenjave karakterizon edhe librin origjinal të Louis Liebenberg-ut (1990), i cili i kushton një kapitull njohjes së shenjave dhe një tjetër klasifikimit të bazuar në modalitetet perceptuese (erë, pamje, prekje, etj.) , dhe atë të Morizot-it (2017), që nis me "*Shenjat e ujkut*". Sidoqoftë, informacioni i përshtatshëm për disiplinën që studion sistemet e shenjave, semiologjinë, nuk përkon me këtë thirrje të fortë dhe hipertrofike. Liebenberg-u, i cili gjahtarin primitiv e bën mendimtarin e parë spekulativ dhe sheh në ushtrimin heuristik të gjuetisë së gjahut origjinën e shkencave, përgjithësisht i referohet konkluzioneve peirciane të Sebeok-ut (*rrëmbim i veprimit*), ndërsa Morizot-i, plangprishës i formulave të dukshme (*ensauvagement sémantique*), dyshon vetëm në një shënim se paradigma rrethanore e Ginzburgut vjen nga procedurat e ndjekjes së gjahtarit dhe është në origjinë të së njëjtës semiotikë!

Një mundësi e humbur për projektin e një disipline që kërkon një *organon* - jo një kanun! - për shkencat humane në përballje me ciklet e konvertimit midis natyrës dhe kulturës; një *lingua franca* e pajisur metodologjikisht për studimin e njohurive hulumtuese të shenjave zoematike.

2.2 Në gjurmët e një ujku dhe një njeriu-ujk

Reflektimi mbi statusin dhe rolin filozofik të kafshës shumëfishohet (Despret 2014). Nga

Fig. 2. Indianë të maskuar si ujq.

nishani i vjetër marksist te macja indiskrete e Jacques Derrida-së (2006) deri te sqepori i përbërë i Eco-s, duke kaluar përmes ujkut Wittgensteinian të grurit, te lakuriqët e papërkthyeshëm të Thomas Nagel-it. Në vend të kësaj, kërkimi shkencor ka favorizuar qentë dhe patat, majmunët dhe papagajtë, elefantët, delfinët dhe balenat që këndojnë. Ai ka rehabilituar sorrat e padurueshme, ka zbuluar babunët e sociologëve me gëzof dhe inteligjencën e deshve të tufës. Nga ana tjetër, sa i përket ndjekjes së shenjave, kërkimet e fundit duket se janë përqendruar në një kafshë të egër e karizmatike që është pjesë e panaireve të tjera beluine - macet dhe arinjtë – e përbën 5% të biomasës shtazore: Ujkun.

Arsyet praktike janë të dukshme: kthimi i ujkut vjen pasojë e mbrojtjes ligjore nga therja në masë rrjedhojë mbrojtje e tufës së deleve nga *teprimi i tij* i pamëshirshëm *vrasës*. Kthimi i të egërve paraqet probleme të qytetërimit.

Ujku për tri gjëra është i njohur: udhëtar, vrasës dhe anëtar, "shumë social" (Safina 2015). Megjithatë, është marrëdhënia e domethënies dhe vlerës (likofilia ose libofobia e "bishës"!) që e lidh këtë "primat nderi" me njeriun me të cilin bashkëjeton në krye të grabitqarit, domethënë që nuk ka asnjë grabitqar prej të cilit ai është pre. Ujku gjithashtu i përket një specieje "të shpërndarë" që i shpëton dilemës midis shenjtërimit - nuk jeton në rezervë - dhe zbutjes. Ndryshe nga qeni, ujku i robëruar nuk e ndjek shikimin tonë.

Një agjent, qeni, i shpikur shoqërisht si një protoarmik - *homo homini lupus* - i cili është pjesë e historisë dhe historive tona dhe e ka shoqëruar njeriun, si rival dhe partner në gjueti, peshkim dhe luftë që nga kohërat më të lashta. Në veçanti për ekspertizën e tij të njohur në shenjimin e territoreve të tij, gjetjen e gjurmëve të gjahut dhe fshehjen e gjurmëve nga gjuetari, për shembull duke urinuar në ujë. Në fakt, semiotika konotative e *gjurmimit* risjell vëmendjen në njohuritë klasike për *metisin*, inteligjencën e mprehtë, "makiaveliste" të kafshëve "sofiste" - dhelprës dhe oktapodit - të kulturës klasike, me aftësinë e tyre polimorfike për të shndërruar shenjat e pranisë dhe drejtimit të tyre. (Detienne, Vernant 1974)

Ashtu si Hermesi mitik, i cili vjedh tufën e Diellit duke tërhequr kafshët nga bishti, duke ndryshuar kështu drejtimin e gjurmëve, dhe si ekuivalenti i tij folklorik Gishtoja, ujku ka gjithashtu heroin e tij eponim dhe negativ: Dolone (Fig. 1). Aleat i trojanëve kundër akejve, ai fshihet, me keqdashje, nën lëkurën e ujkut - si gjuetarët indianë të buallit në kullotat amerikane (Fig. 2) - dhe i gjithë *metis-i* i Uliksit dhe ndihma e Athinës nevojiten për ta zbuluar dhe vrarë.

Gjetja, identifikimi, njohja e shenjave të vlerësuara nga semiologu *detektiv*, si një premisë e lehtë për veprimin e rrëmbyer të dikujt, nuk është fare e lehtë: për vështirësinë e gjurmimit të vetë gjurmëve, për morfologjitë e veçanta të specieve të ngjashme, për pasiguritë e caktimit të identitetit dhe mbi të gjitha për *metisin* 'makiavelist' të ujkut. Karakteristikat e



Fig. 3. Gjurmë të qenit dhe të ujkut

sipërfaqeve të mbishkrimit, qëndrueshmëria e substancave të manifestimit, ndotin sigurinë e gjurmëve. Ashtu siç është e vështirë të dallosh gjurmët e ariut të murrmë nga ai *i thinjuri* amerikan, po ashtu është e vështirë të ndash gjurmët e këmbëve të ujkut nga ato të qenit apo hibridit tjetër. Tiparet dalluese pasqyrohen, më shumë se në shenjën e izoluar, në sekuencën e gjurmëve (Fig. 3): ujku vazhdon në fakt të vendosë këmbët e tij të pasme në shtypjen e këmbëve të përparme dhe rruga e tij është më drejtvizore se ajo, më e valëzuara dhe e parregullta e një qeni.

Në njohjen narrative të shtigjeve, ndjekësi duhet të turbullohet për të parë (Liebenberg 1990) dhe të praktikojë vëzhgime të ndërprera; ai gjendet edhe në nevojën imagjinative për të katalizuar pjesë të pashfaqura, për shkak të terrenit të papërshtatshëm për mbishkrimin e gjurmës, por mbi të gjitha për shkak të taktikës ujkore *të maskimit*, fshehjes të gjurmëve të dikujt mbi qëllimin e atyre që e ndjekin.[1] Ujku, ndryshe nga majmuni, nuk është një specie politike, por ka një qëndrim "aristokratik" brenda hierarkive të ndërrueshme të tufës. Siç ka vënë në dukje Bateson (1972), «ligjërimi i tij përqendrohet kryesisht në rregullat dhe rastësitë e marrëdhënies", dhe ai është i pajisur me një njohuri taktike legjendare në ndjekjen e gjahut dhe në mashtrimin e atyre që e ndjekin ose e përgjojnë. Ai është një agonist i vetëm ose i shumëfishtë, i fshehtë dhe proteinik, i vështirë për t'u vizualizuar dhe njohur dhe i vështirë për t'u kuptuar si (*token*) shenjë e paramenduar e një *lloji* të caktuar. Ujku i ndjekur mund të rrethojë ndjekësin, duke u fshehur pas tij; nëse mashtrohet, ai nuk bie kurrë në të njëjtën kurth. Mënyra e tij e ekzistencës është ajo mutante dhe evolucionare, një "blloku rizomatik të bërjes» (Deleuze, Guattari 1980). Ishte René Thom ai që vuri në dukje katastrofën perceptuese për të cilën mund të ndodhë, që gjatë rrugës, grabitqari, me zhvendosje empatike dhe i verbuar nga shtatzënia e dëshirës, të tregojë dhe të veprojë, sikur të ishte pre. Makina kinegetike, për shkak të nevojës strategjike për të kapur këndvështrimin e tjetrit, e bën atë të ndihet një kafshë, "ujqërorja" e saj, së bashku me një mutacion antropik. Në ngjarjet njerëzore dhe shtazore të zbulimit të ndërsjellë të gjurmëve dhe në cilësinë e tyre të kuptimit, në fakt njihet një bashkë-evolucion që nuk është i trashëguar, por komunikues, ngjitës dhe simbiotik midis qenieve heterogjene. Një evolucion joparalel, pasojë e kthyeshmërisë së instancave kumtuese, maskimeve të lëkurës dhe kundërmasave, që shkojnë në drejtim të një antropomorfizimi të ujkut (siç dëshmohet, ndër të tjera, nga varjet e shpeshta publike dhe ekspozitat e ujqërve të vrarë) dhe ujkëzimi i njeriut. *Homo homini lupus* dhe *lupus, lupo, homo*. Njeriu - ujk, rezultat utopik i evolucionit të etogrameve të ndryshme, është semiofori i një takimi të ndërsjellë që ndodh me anë të një shenje ndërhyrëse. Fjala *mutuo* vjen nga *mutare*!

Prandaj, lexuesi i shenjave të ujkut, duke përfshirë edhe gjurmët e lëna nga fshehja e gjurmëve, praktikon një animizëm të matur dhe jo viktimist. Për shprehjet idiomatike dhe proverbiale, për tropet dhe tregimet, ai e di se, pavarësisht ndryshimit fizik, është homologjia e brendshme ajo që e shtyn të sillet sikur ujku ndante të njëjtat vlera të subjektivitetit, vetë-ndërgjegjësimi, kujtesa, qëllimshmëria, njohuria, komunikimi, vdekshmëria (Descola 2005). Një qëndrim që nuk ka asgjë shamanike në të, por që kërkon që aktori njerëzor të

1 Gjuetarët si Franklin D. Roosevelt, presidenti i SHBA-së, dhe piktorë, si Abbott Thayer, morën pjesë në polemikat mbi lindjen e kamuflazhit si një disiplinë shkencore dhe prezantuan menjëherë përdorimin e tij në taktikat ushtarake. (Fabbri, 2011).

(Vijon në faqen 23)

Pasojat e luftës

PASOJAT E LUFTËS e Rubens, artistit diplomat dhe agjent

Dr. Bledar Kurti

Peter Paul Rubens (1577-1640), është një ndër artistët më të dashur nga piktorët, por ndër më të sulmuarit nga kritikët e artit dhe historianët. "Oh, ai piktori, me ato gra tmerrësisht të shëndosha!» komentojnë për Rubens të gjithë ata të cilët duk dallojnë dot artin dhe natyrën, e që nuk mund të ndajnë dot meditimin e bukurisë prej dëshpërimit kafshëror ose dëshirës së posedimit.

Në çdo tablo të tij, brenda kaosit, dinamikës, lëvizjeve të gjalla të figurave, ka një elegancë të pashoqë. Trupat njerëzorë, sidomos të femrave janë të fryrë, të egër, të shëndoshë, me shtresa dhjami dhe një banalitet fizik, por trajtimi i mishit dhe i lëkurës ka një bardhësi të mrekullueshme, e një të kaltër të lehtë në damarët e të gjithë trupit. Dhe, përtej virtuozitetit të tablove të tij, dhe kompozimeve marramendëse ka një stimulim mendor, një tregim apo ilustrim të epokës në të cilën ai jetonte, shoqëruar me simbolika dhe alegori të marra nga mitologjia dhe historitë biblike.

Në tablonë *Pasojat e Luftës* (1638), një pikturë me përmasa të mëdha, Rubens, piktori flamand i stilit barok, përdori stilin e tij delikat dhe të ndjeshëm për të hedhur dritë mbi një temë të errët si lufta, dhe fatkeqësia që ajo sjell për shoqërinë.

Rubens e pikturoi *Pasojat e Luftës*, të njohur ndryshe edhe si *Tmerret e Luftës,* rreth vitit 1638, periudhë në të cilën kishin kaluar njëzetë vjet nga Lufta Tridhjetëvjeçare (1618-1648), një konflikt shkatërrimtar që përfshiu pothuajse çdo fuqi të madhe në Evropë, dhe la disa rajone të Gjermanisë pothuajse të shpopulluara. Rubens përdori mjete të artit barok për të theksuar diagonalet, lëvizjen dhe kontrastet e dritës në mënyrë që të shpaloste koston njerëzore të luftës pa e portretizuar atë në mënyrë të drejtpërdrejt.

E gjithë vepra është alegorike dhe e mbushur me simbole. Përpara se të njihemi me figurat dhe simbolet, vërejmë se si e gjithë piktura lëviz nga e majta në të djathtë. Ajo lëviz me një dinamizëm dramatik, porsi një stuhi që shpërthen papritmazi. Hidheni vështrimin tek këndi i poshtëm në të majtë, imagjinoni një gozhdë nga e cila dalin fije spangoje për nga çdo figurë e tablosë. Të gjitha figurat duket se janë të lidhura me atë kënd. Nga ajo pikë fokale duket se rrezaton çdo lëvizje e çdo figure, porsi një pikë zero prej nga ku buron e gjithë jeta, në këtë rast e gjithë skena.

Në qendër të pikturës, shihet Marsi, perëndia e luftës, me armaturën, helmetën, mantelin e kuq, mburojën e ngritur lart dhe shpatën e përgjakshme. Marsi ka hedhur përpara këmbën e tij të majtë mbi një libër dhe një vizatim për të simbolizuar se lufta dhunon letërsinë dhe artet. Në të majtë të tij, shihet Venusi, perëndesha e dashurisë, e cila mundohet ta frenojë, dhe tërheq krahun e tij. Ajo përpiqet ta joshë atë dhe ta bëjë të tërhiqet nga lufta. Ajo duket provokuese por edhe lutëse. Venusi është e zhveshur dhe ka një rrobë të kuqe midis këmbëve të saj. Ajo rrobë e bashkon atë dhe Marsin, si një simbol që bashkon dashurinë dhe luftën, të dyja të shtyra e nxitura nga pasioni njerëzor.

Poshtë këmbës së djathtë të Venusit gjenden dy kubidë të vegjël me krahë që përpiqen ta ndihmojnë atë. Poshtë këmbëve të tyre shihen të shtrira në tokë disa shigjeta, një skeptër dhe një degë ulliri, të gjitha simbole të paqes, të cilat nën vërshimin e luftës janë rrëzuar përtokë.

Në të majtë të tablosë shihet një grua e dëshpëruar e veshur me të zezë, me krahët e saj që vërtiten në ajër. Kjo grua përfaqëson Evropën, kontinentin e shkatërruar dhe të përgjakur nga lufta. Sytë e saj janë të lotuar, dhe ajo i lutet qiellit që të ndalohet kjo marrëzi njerëzore. Në të majtë të kësaj gruaje është një engjëll i cili mban një glob me një kryq të vogël mbi të. Mbi engjëllin shihet *Tempulli i Janusit* që gjendet në Forumin Romak në Romë. Rubens apelon përmes simboleve se lufta e ka shkatërruar kontinentin e krishterë që nga koha romake, dhe se prej qytetërimit romak duhej mësuar për të ndërtuar një qytetërim të zhvilluar e jo një epokë vrastare e vdekatare.

Në të majtë të Marsit, pranë mburojës së tij gjendet Alekto, një nga erinitë, puna e së cilës është të ndëshkojë krimet morale të njerëzve. Alekto është një shpirt dënimi, i përfaqësuar shpesh si një nga tri perëndeshat që ekzekutonin mallkimet e hedhura mbi kriminelët, torturonin fajtorët me pickime të ndërgjegjes dhe shkaktonin zi buke dhe murtajë. Alekto ka një pishtar në njërën anë, për t'i treguar rrugën, dhe po tërheq krahun e majtë të Marsit për ta angazhuar atë në luftë.

Poshtë Alektos gjendet perëndesha Harmonia, e cila mban në dorë një mandolinë të thyer dhe është e shtyrë në tokë. Në të djathtë të saj shihet një arkitekt i hedhur përdhe i cili mban një kompas dhe disa nga mjetet e tij të tjera të punës të flakura në dhe. Mbi to janë një nënë dhe një fëmijë të frikësuar dhe të tmerruar nga dhuna e luftës.

Lufta Tridhjetëvjeçare kishte një ndikim të tmerrshëm në jetën e njerëzve të zakonshëm, të ngjashëm me atë të luftërave të mëvonshme botërore, duke shkaktuar uri, sëmundje dhe shkatërrimin ekonomik në të gjitha rajonet. Alegoria e pikturuar nga Rubens shërben si një memorial lufte totale që evropianët e përjetuan si diçka të re dhe të frikshme. Kjo tablo e pasionit të luftës simbolizon vdekjen e vetë artit. E gjitha tabloja shpalos shkatërrimin e jetës, shpirtit, dashurisë, harmonisë, shteteve, arteve, godinave, letërsisë dhe muzikës. Një pllakosje e plotë e tmerrit.

Në këtë tablo bie në sy trupi i zhveshur i Venusit. Trupi i saj është i mbushur dhe i shëndoshë, ndryshe nga koncepti i bukurisë së femrës që kemi sot. Të gjitha femrat në tablotë e Rubens janë të shëndosha, ndaj edhe ngjallin kritika nga shikuesit e sotëm, por shëndeti shprehte klas dhe përdorej për të hyjnizuar figurat femërore, pasi me format e mëdha të trupit ato nuk jepnin mesazhin e joshjes dhe tundimit seksual por të hyjnisë. Figurat e shëndetshme tregonin begati dhe jepnin mesazhin se nuk u mungonte as ushqimi, as bollëku e asgjë tjetër. Gjithashtu shëndeti simbolizonte paqen, dhe ishte i lidhur me lindjen e fëmijëve, dhe lindja ishte mrekulli paqësore e jo simbol lufte. Shëndeti ishte edhe simbol pushteti.

Por, të gjitha figurat në veprat e tij nuk janë thjesht numra dhe simbole, ato përmbajnë një vitalitet të spikatur dhe lëvizja dramatike krijon një ngutje dramatike. Rubens pëlqente kompozimin e ekzagjeruar, veprimin dramatik dhe format e forta; por pamja e tërbimit dhe shpejtësisë, sidomos në pikturat e tij më të hershme, nuk ishte efekti i nxitimit apo rrëmbimi i mendjes dhe i dorës. Ky efekt planifikohej qëllimisht dhe duheshin vite të tëra për Rubens të arrinte një harmoni të plotë midis trajtimit të pikturës dhe kompozimit të veprave. Kompozimet e tij shprehin një trajtim piktoresk plot dhimbje dhe drojë.

Rubens konsiderohet si mjeshtri i stilit "piktoresk", një stil që përmban penelata të hapura e të lirshme dhe një theksim të ngjyrës. Ndryshe nga stili "linear", i cili përdorte linja të forta dhe të mprehta konturesh për të përcaktuar qartë skajet e objekteve, stili i Rubens varet më shumë nga sugjerimi dhe nënkuptimi për të kuptuar format. Me stilin e tij duket se ai pati ndikim edhe tek Rembrandt, Velasquez, etj.

Te vepra *Pasojat e Luftës* ne shohim dorën e një mjeshtri të madh të pikturës, por në fakt ajo buroi nga mendja e një njeriu tejet inteligjent e të formuar, në të vërtetë, nga imagjinata e një diplomati. Rubens ishte një diplomat profesionist, ndaj edhe shumë prej artdashësve të sotëm duhet të kërkojnë nëpër libra apo internet për të mësuar mbi kontekstin historik në të cilin ai jetoi, si edhe për emrat mitologjik, simbolet dhe historitë antike që shpalosen në veprat e tij.

Edhe nëse ai nuk do kishte prekur kurrë penel me dorë, ne sot ende do e dëgjonim emrin e tij. Ai punoi si një diplomat i rangut të lartë nën autoritetin e mbretëreshës Isabella, monarke e Holandës jugore. Si një katolik i devotshëm, ai punonte nën urdhrat e Spanjës për ta kthyer Holandën protestante nën besimin katolik. Në vitin 1629 ai shkoi në Londër, i ngarkuar për promovimin e paqes. Detyra e tij ishte të mundësonte një takim ambasadorësh midis Britanisë dhe Spanjës, të cilën e arriti, duke çuar në traktatin e paqes të nënshkruar më 15 nëntor 1630. Por Rubens bëri më shumë se sa thjesht të fliste me fjalë. Ai e dha mesazhin e tij edhe me figurë. Ai bëri një pikturë në Angli si dhuratë për mbretin Charles I, një tablo alegorike mbi luftën dhe paqen. Arti i Rubens vihej gjithmonë në shërbim të diplomacisë. Ndaj artisti brenda tij ishte nën kontrollin e mendjes diplomate që ai kishte. Ndaj diplomacia, me mesazhin e saj, vihej në shërbim të artit, dhe arti vihej në shërbim të diplomacisë për të arritur paqen midis dy apo më shumë kombeve.

Sot, një artdashës me të drejtë mund të shtrojë pyetjen se përse Rubens nuk pikturoi një panoramë më të drejtpërdrejtë të luftës? Përse nuk veproi si artistë të tjerë që përshkruan njerëz të vrarë apo fshatra të djegur? Përse me simbole dhe alegori? Rubens na ka lënë shumë letra të shkruara nga dora e tij, dhe disa prej tyre përmbajnë komente të gjalla mbi refugjatë që vërshonin drejt kufirit holandez, si edhe mbi shpërthime të murtajës dhe dizenterisë, por Rubens ishte një artist kozmopolitan dhe arti i tij qarkullonte në mbarë botën. Mesazhet që ai jepte duheshin kuptuar

si në Londrën protestante ashtu edhe në Madridin katolik, dhe ashtu siç ekzistonte një gjuhë e veçantë në diplomaci kështu ekzistonte edhe një stil diplomatik në pikturë. Rubens e pikturoi Evropën si një grua me të zeza që vajton, pavarësisht se me fjalë ai e komentoi edhe më shumë në letrat personale. "Gruaja me të zeza është Evropa e plaçkitur nga lufta dhe e zbrazur nga pasuria," shkroi ai në një letër drejtuar një artisti flamand. Nëse do përshkruante me fjalë se cili ishte fajtori, se kush ishte zhvatësi e kush viktima, nuk do arrinte kurrë paqen e dëshiruar në përpjekjet e tij diplomatike, ndaj ai zgjodhi simbolikën dhe alegorinë për të ndërgjegjësuar mbretërit për tmerret e luftës.

Si artist dhe diplomat Rubens vërtetë besonte tek paqja. Ai madje u bë një diplomat i zellshëm pasi besonte plot sinqeritet në mundësinë e arritjes së paqes midis vendeve evropiane. Por ashtu siç ndërmerrte nisma pothuajse të pamundura diplomatike, ai bënte të njëjtën gjë edhe në art. I suksesshëm, i njohur dhe i begatë, mbi të gjitha Rubens ishte i vetëdijshëm për aftësitë e tij. Në një letër të vitit 1621 ai shkroi plot krenari e vetëbesim: "Unë jam aq i talentuar sa që nuk më ka munguar kurrë guximi të ndërmarr çdo kompozim, sado me përmasa të mëdha e sado e shumëllojtë në përmbajtje."

Shumë historianë e kritikojnë Rubens për shkak të diplomacisë që shpalosi edhe në art, e madje edhe spiunazhit në karrierën e tij. Rubens punonte si artisti i oborrit të dukeshës Isabella por ishte edhe një ndër agjentët e saj sekret. Ai njihet në histori edhe si artisti që i bënte elozhe pafund Marie de Medici, mbretëreshës së Francës, për të cilën krijoi njëzetë e katër tablo me përmasa tejet të mëdha duke e portretizuar atë më shumë sesa një mbretëreshë, por si perëndeshë, dhe nënën e kombeve. Ndaj arti si propagandë, politikë dhe pushtet, e kategorizonte Rubens si një oportunist që kërkonte të bëhej i rëndësishëm dhe i pasur. E në fakt u bë.

Ndaj kritikët e artit e sulmojnë Rubens, se veprat e tij nuk ishin të sinqerta, por ishin në shërbim të monarkëve e madje në shërbim të urdhrave fetarë si Jezuitët. Por në rangun e kritikave ai akuzohet edhe për imitime të stilit Italian të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Rubens studioi veprat e mjeshtërve italianë, por ai nuk ishte aspak imitues, por një piktor jashtëzakonisht personal; ekuilibri i personalitetit të tij e shtynte atë të gëzonte gjuhën e bojës përpara personalitetit të natyrës. Kur përballej me një model njerëzor apo një tablo të një artisti të njohur, ai e interpretonte atë lirshëm në vend që të kopjonte me saktësi. Ajo çfarë shikonin sytë e tij nënkuptonte diçka tjetër në mendjen e artistit, dhe ai merrte një lloj drejtimi sipas shijes së tij. Ai ra në dashuri me stilin e vet, dhe kërkoi të promovonte bukurinë e ndjenjave që kishte përbrenda sesa të theksonte karakterin e bukurisë që supozohej të shprehte.

Arti epik i Rubens përfaqësonte vetëm një aspekt të gjenialitetit të tij të shumëfishtë. Një artist i shquar, i dashur dhe i vlerësuar nga të gjithë monarkët e Evropës, një diplomat i njohur në kohën e tij, ai ishte gjithashtu edhe një studiues dhe humanist, një klasicist i edukuar dhe studiues i antikitetit, një zotërues i disa gjuhëve, dhe madje edhe një arkitekt amator. Studimet e thella e bënë të tërhiqej nga tregimet biblike, teologjia katolike, hagiografia, historia dhe mitologjia greke dhe romake, të cilat i përdori vazhdimisht për tematikat dhe ikonografinë e artit të tij. Një katolik i devotshëm, një burrë i përkushtuar dhe babai i tetë fëmijëve, ky artist i begatë, energjik dhe plotësisht i balancuar paraqet antitezën e nocionit modern të artistit të vuajtur. Vepra si *Pasojat e Luftës*, por edhe *Masakra e të Pafajshmëve, Tri Hijeshitë, Ujku dhe Gjuetia e Dhelprave, Katër Kontinentet, Gjuetia e Luanëve, Danieli në Strofkën e Luanëve, Venusi dhe Adonisi,* e të tjera, janë tablo madhështore të cilat xhelozojnë edhe piktorët e sotëm me këndet unike të pamjes së figurave, lëvizjeve të pa imagjinuara të trupave njerëzorë por edhe kuajve e luanëve, me trupat femërore të cilat edhe pse të fryra e të mbushura, të ndryshme nga standardet e sotme, bëjnë çdo shikues të përjetojë emocione të pa përshkruara që ofron vetëm arti i vërtetë.

Rubens i trazon kritikët jo vetëm prej tablove të tij, pasi kompozimet e Rubens e shtangin vështrimin e shikuesit dhe mbeten si një jehonë e gjatë në mendje, e as vetëm me talentin e tij me të cilin shpalos fytyrën magjike të artit, por ai i turbullon ata edhe me vetë figurën dhe personalitetin e tij.

Rubens e jetoi jetën e tij me begati e sukses në të gjitha aspektet. Por pavarësisht famës dhe pasurisë ai ishte i moderuar në çdo gjë. Ai nuk dehej kurrë, dhe nuk kreu kurrë tradhti bashkëshortore. Ishte fetar, shkonte gjithmonë në meshë, dhe frenohej nga çdo gjë e tepruar. "Një mendje e shëndoshë dhe një trup i shëndoshë" ishte gdhendur në portikun e kopshtit të tij në Antwerp. Ai caktonte dikë t'i lexonte veprat klasike teksa vetë pikturonte. E përveçse ishte artisti më i kërkuar ishte edhe ambasador i shumë mbretërve të Evropës. Brenda vetes ai dukej sikur kishte shumë persona, dhe nuk arrihej të kuptohej se nga kishte mbirë ai njeri. Ai dukej sikur vinte nga një botë imagjinare e jo nga ndonjë vend real i kësaj bote. Dhe siç u shpreh vetë Rubens në një nga letrat e tij: "E gjithë bota është atdheu im." Dhe kishte më se të drejtë, pasi e gjithë bota sot studion dhe admiron artin e tij.

Danieli në strofullën e luanëve

(Vijon nga faqja 21)

performojë diplomatikisht si ndërmjetës - përkthyes dhe *sinjalizues* - midis rasteve kontradiktore të shqiptimit (Latour). Një diplomat "ujk" - domethënë *hominarius* - joreduktues në lidhje me kuptimin njerëzor dhe natyralizmin radikal për të cilin njeriu është një kafshë ndër të tjera. Një ndërmjetës që nuk beson në epokën e artë në të cilën «ujku do të jetojë së bashku me qengjin (Isaia XI: 6-8), por dëshiron të përforcojë dallimet e ngjashme. Midis qengjit, ujkut dhe njeriut - shokët e ardhshëm në parlamentin Laturian - marrëdhëniet do të jenë gjithmonë «të matura». Prandaj është e nevojshme të merren me kufijtë e bashkëjetesës, incidentet diplomatike, rregullimet e mundshme deri te keqkuptimet e mira. Për të lëvizur në këtë «rizosferë» (Deleuze, Guattari, *op. Cit.*) Diplomati ndërmjetës duhet të ketë, sipas mendimit tonë, një gjuhë përcjellëse të përshtatshme: gjuhën e semiotikës, duke shmangur heshtjen e kafshëve pa kërkuar prej tyre të mësojnë gjuhët njerëzore.

Pikëmbërritja

Elias Canetti dhe Jean Baudrillard (1981), pas tij, thanë se nuk mendonin për konceptet, por për kafshët. Një ftesë për të dalë nga shpella platonike e një ekologjie sentimentale, mbi të cilën projektohen hijet e kafshëve shtëpiake prej pellushi.

Rezistenca e ashpër e tufës së ujqërve ndaj kësaj taksidermie tregon se inteligjenca e kafshëve është çështje territori dhe metamorfoze të ndërsjellë. Na detyron të mendojmë se kriza ekologjike dhe nxjerrja e verbër e burimeve natyrore i përkasin vizionit të një bote të ardhurash objekte, ku ne e konsiderojmë veten si subjektet e vetme, duke privuar çdo gjallesë nga kompleksiteti i saj domethënës dhe me vlerë. Gjuetia dhe madje edhe lufta me dema ruajnë ende një marrëdhënie simbolike në lidhje me përndarjen eksperimentale dhe therjen e verbër të fermave industriale.

Pas hulumtimit të maskimit, taktikat epistemike të gjurmimit i ofrojnë jetë të re një semiotike të theksuar, krahasuar me vulgatën Peirciane, e cila, si monarkia angleze, teorikisht mbretëron, por nuk rregullon kuptimin e formave të jetës. Semiologu, i cili ka hequr dorë nga gjuetia dhe gjurmimi i ujkut, është gjuetari më i mirë i shenjave të tij. A mund të na bëjë ai të buzëqeshim sërish me kafshën që është në ne dhe me njeriun që është në të?

Fatmirësisht mes shenjave të pikësimit mungon Pika e Mbërritjes.

Fabbri, P. (2019). Zadig e il Lupo, ovvero semiotizzare le tracce. Në D. Bertrand, & G. Marrone, La sfera umanimale. Valori, racconti, rivendicazioni (Vëll. i Biblioteca/semiotica, f. 276). Milano: Meltemi.

Referenca:

Bateson, G.,1972 *Steps to an Ecology of Mind: Collected Essays in Anthropology, Psychiatry, Evolution, and Epistemology*, The University of Chicago Press, trad. it., *Verso una ecologia della mente,* Adelphi, Milano 1976, spec. *"Problemi relativi alla comunicazione dei cetacei e di altri mammiferi".*

Baudrillard, J. 1981 *Simulacres et simulation,* Galilée, Paris, trad. it., *Simulacri e impostura. Bestie, beaubourg, apparenze e altri oggetti,* Pgreco, Roma, 2008, cap. "Bestie, territorio, metamorfosi".

Cimatti, F.2013 *Filosofia dell'animalità*, Laterza, Roma.

Deleuze, G., Guattari, F.1980 *Mille plateaux. Capitalisme et schizophrénie*, Minuit, Paris, trad. it., Mille piani, Castelvecchi, Milano 2000, cap. 10, *"Divenire intenso, divenire animale, divenire impercettibile"*.

Derrida, J. 2006 *L'animal que donc je suis*, Galilée, Paris, trad. it., *L'animale che dunque sono*, Jacabook, Milano 2014.

Descola, P.2005 *Par-delà nature et culture*, Gallimard, Paris, trad. it. *Oltre natura e cultura*, SEID, Firenze 2014.

Despret, V.2014 *Que diraient les animaux, si... on leur posait les bonnes questions*?, La Découverte, Paris, trad. it., *Che cosa rispondono gli animali... se facciamo le domande giuste?* Sonda Edizioni, Milano 2017.

2002 *Quand le loup habitera avec l'agneau, Les Empêcheurs de Penser en Ronde,* Paris, trad. it. *Quando il lupo vivrà con l'agnello. Sguardo umano e comportamenti animali*, Elèuthera, Milano 2004.

Détienne, M., Vernant, J.-P.1974 *Les ruses de l'intelligence. La métis chez les Grecs,* Flammarion, Paris, trad. it *Le astuzie dell'intelligenza nell'antica Grecia*, Laterza, Roma 1978.

Dumas, A.1856 *Le Meneur des Loups*, trad. it., *Il signore dei lupi*, Del Bosco, Milano 1973.

Eco, U.1990 *I limiti della interpretazione*, Bompiani, Milano, cap. "*Corna, zoccoli, scarpe: tre tipi di abduzione*".

1980 Il *Nome della rosa*, Bompiani, Milano.

Fabbri, P.2011 *Semiotica e camouflage, in L. Scalabroni, a cura di, Falso e falsi. Prospettive teoriche e proposte di analisi*, Ed. ETS, Pisa, 2011, pp. 11-25.

Ferraris, M.2009 *Documentalità. Perché è necessario lasciar tracce*, Laterza, Roma.

Fontenay, E. de2013 *Le Silence des bêtes. La Philosophie à l'épreuve de l'animalité*, Seuil, Paris.

Ginzburg, C.1979 *Clues: Roots of an Evidential Paradigm, in Theory and Society*, 7, pp. 273-288, trad. it., Spie. *Radici di un paradigma indiziario, in A.G. Gargani*, a cura di, Crisi della ragione, Einaudi, Torino, pp. 57-106.

Guidi, S., Romele, A. (a cura di)2016 *Human and digital traces*, in Azimuth, n. 7.

Latour, B.2005 *Un monde commun mais pluriel*, Éditions de l'Aube, Paris, trad. it., *Disinventare la modernità*, Eleuthera, Milano 2008.

Lévi-Strauss, C.1985, *La potière jalouse*, Plon, Paris, trad. it. *La vasaia gelosa*, Einaudi, Torino 1987, cap. VIII, "*Alla ricerca di Zoemi*".

1962 *La Pensée sauvage*, Plon, Paris, trad. it., *Il pensiero selvaggio*, il Saggiatore Milano 1964, cap. "L'individuo come specie".

Liebenberg, L.1990 *The art of tracking. The origin of science*, David Philip publisher, Claremont 1990.

Marrone, G. (a cura di)2017 *Zoosemiotica 2.0. Forme e Politiche dell'animalità*, Museo Pasqualino, Palermo.

Marrone, G., Mangano, D. (a cura di)2018 *Semiotics of Animals in Culture. Zoosemiotics* 2.0, vol 17. Springer, Cham.

Morizot, B.2017 *Sur la piste animale*, Actes Sud, Arles, prefazione di V. Despret.

2016 *Les diplomates, cohabiter avec les loups, sur une autre carte du vivant*, Marseille, Wildproject.

Parret, H. 2016 *Une sémiotique des traces, Trois leçons sur la memoire e l'oubli*, Lambert-Lucas, Limoges.

Pastoureau, M.2018 *Le loup, une histoire culturelle,* Seuil, Paris, trad. it. Il lupo. Una storia culturale. Ponte alle Grazie, Firenze 2018.

Rastier, F.2015 *Saussure au futur*, Belles Lettres, Paris.

Rong, J.2015 *Il totem del lupo*, Oscar Mondadori, Milano.

Safina, C.2016 *Beyond Words: what animals think and feel,* Picador Usa.

Serres, M.1990 *Le contrat naturel*, Editions François Bourin, Paris, trad. it. Il contratto naturale, Feltrinelli, Milano 1991.

Sebeok, T. A.1990 *Essays in Zoosemiotics*. The Toronto Semiotic Circle, Toronto.

Sebeok, T.A. (a cura di)1973 *Zoosemiotica, Studi sulla comunicazione animale*, Bompiani, Milano.

Thom, R.1972 *Stabilité structurelle et morphogenèse*, InterÉditions, Paris, trad. it. Stabilità strutturale e morfogenesi.

Saggio di una teoria generale dei modelli, Einaudi, Torino 1980.

MARIE AUBERT

A MUND TË VIJ TEK TI

OnufriTregime